

Mars 2016
Numri: 96
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro

ETIKA



VËLLAZËRIA
OSMAN NURI TOPBASH



ZGJEDHJA E MIQËSISË
PROF. DR. JASHAR KANDEMIR



EJA NË SHPËTIM!
AS. DOC. DR. MUSTAFA KHANLE




TË BESOSH
AHMET ZULAN



HIJA E SHPRESËS
EDISON ÇERAJ



SHKAQET
E MOSSUKSESIT
SHKOLLOR
NUREDIN NAZARKO



Njeriu është
në besimin
e shokut të tij...

ISSN 2227-3611



03

9 772227 361004

Besimtari ka tre miq: Allahun, Pejgamberin dhe besimtarët.

Edhe Pejgamberi ka tre miq: Allahun, Xhebrailin dhe besimtarët.

Miqtë e Allahut janë ata që e duan Allahun dhe njëri-tjetrin për hir të Allahut.

Në Ditën e Kiametit, disa pejgamberë dhe dëshmorë, do t'i shohin me zili disa persona. Këta, nuk janë as pejgamberë, as dëshmorë. Por e kanë arritur atë gradë në sajë të mirësisë së Allahut. Këta fatlumë, janë ata që e kanë dashur njëri-tjetrin për hir të Allahut, pa pasur midis tyre asnjë lidhje farefisnore apo tregtie.

Atë ditë, ata do të jenë mbi një dritë;

Fytyrat e tyre do të shndrisin;

Ata do të jenë të qetë, kur të tjerët të jenë të frikësuar;

Ata do të jenë të gëzuar, kur të tjerët të hidhërohen.

Muslimani nuk mund të jetë mik i mohuesve të Allahut, të dyfytirëshve, të ngatërrestarëve dhe të keqbërësve. Ai nuk duhet të bëhet mik i atyre që ushqejnë armiqësi ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij, edhe sikur ata të jenë babai, fëmija, vëllai apo të afërmit e tij.

Një nga arsyet që Allahu i Madhëruar i dënoi Bijtë e Izraelit, ishte se shumica e tyre bëheshin miq me mohuesit e Allahut.

Përse nuk duhet të miqësohemi me mohuesit? Edhe këtë, Allahu i Madhëruar na e shpjegon kështu:

“Nëse ju mposhtin, ata do të jenë armiqtë tuaj e do t’i zgjasin duart dhe gjuhët e tyre për t’ju lënduar ju, sepse dëshirojnë që ju të bëheni jobesimtarë.” (Mumtehine, 2)

“...Kur ata ju takojnë, thonë: “Edhe ne besojmë” e, kur mbeten vetëm, nga mllëfi ndaj jush, ata i kafshojnë majat e gishtave me dhëmbë...” (Al-i Imran, 119)

A duhet t’i shohim të gjithë mohuesit me këtë sy? Allahu i Madhëruar, edhe për këtë ka vendosur kriteret e duhura:

“Allahu, nuk ju ndalon të silleni mirë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre që nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe që nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Me të vërtetë, Allahu i do të drejtët.”

Allahu ju ndalon t’i bëni miq ata që luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe ju dëbojnë nga vatrat tuaja, si dhe mbështesin të tjerët që t’ju dëbojnë. Kushdo që i bën miq ata, është punëmbropshtë.”

Siç është shprehur edhe Pejgamberi ynë (a.s.):

“Njeriu ndikohet nga mënyra e jetesës së shokut të tij. Prandaj, besimtari duhet të bëjë kujdes në zgjedhjen e miqve!” (shih. Ebu Daud, Edeb 16.)

Ai duhet të zërë miqësi vetëm me besimtarët. Gjithashtu, ai duhet të qëndrojë me njerëzit e devotshëm, të hajë dhe të pijë vetëm me ta.

“Shoku i mirë është si shitësi i parfumit, ndërsa shoku i keq është si farkëtar. Ai që shet parfum, është i dobishëm në çdo rast. Ose do të blesh parfum prej tij, ose do të parfumosë ai ty, ose më e pakta, do të mbash erë të këndshme për sa kohët të jesh me të. Kurse shoku i keq, që i ngjan farkëtarit, ose do të djegë rrobën me ndonjë shkëndijë zjarri, ose të paktën do të shqetësojë era e keqe e farkës.” (shih. Muslim, Birr, 146.)

Mars 2016

VITI: X

NUMRI: 96

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Artur Tagani

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 607 8484

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 4411 9848

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7042 8245

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t’i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Përmbajtja



12

Islami është çlirimi i zemrave
M. Ali Eshmeli



Vëllazëria
Osman Nuri Topbash

34



18

44



Çfarë nevoje ka për ta fshehur Islam, ndërkohë që të privuarit e presin atë!
H. Kybra Ergin

5 A bëhesh ortak me shejtanin?

Ahmet Tashgetiren

9 Zgjedhja e miqësisë

Prof. dr. Jashar Kandemir

18 Marrëdhëniet

religjion-shkencë

në procesin e iluminizmit të shekullit të 18-të

Ahmet Meral

24 Të falënderojmë

për çdo mirësi


Xhafer Durmush

26 Të besosh

Ahmet Zijlan

30 Mrekullitë e Kuranit

32 Një Ajet - Një Hadith



50

Dhuratat dhe përgëzimet 41
që erdhën nga miraxhi i Pejgamberit (a.s.)

Irfan Ezytyrk

Ummu Halid 47

Mustafa Erish

Shkaqet e mosesit shkollor 50

Nuredin Nazarko

Parime jetike nga Pejgamberi (a.s.) 53

M. Sami Ramazanollu

Jeta e Profetit Ibrahim (a.s.) 56

Ibrahim Iljazi

Gjërat me të cilat arrihet 58

ëmbëlsia e besimit

Naim Drijaj



Hija e shpresës
Edison Çeraj

48

Para se botës t'i japim ndonjë gjë
Doç. dr. Harun Emysh

54



A bëhesh ortak ME SHEJTANIN?

— Ahmet Tashgetiren —

- Nëse shejtani do të ishte një njeri, a do themelonit ndonjë ortakëri me të për çfarëdo lloj arsyeje qoftë, duke ia besuar atij një pjesë të pasurisë suaj? A do të dëshironit, që ai të mbillte, të korrote, të shpenzonte, të kursente, të shtonte apo të pakësonte për ju? A do të pranoni sikur shejtani të lodhte mendjen për ju, të përpiqej për të shtuar pasurinë tuaj, t'ju sillte diçka duke e mbajtur mbi shpinë dhe ta vendoste në kasafortën tuaj?

- A do të dëshironit që shejtani të marrë një nga fëmijët tuaj ose të zërë rrënjë në ndonjë gjymtyrë apo organ të fëmijës suaj dhe ta përdorë atë sipas dëshirës së tij? Si do të reagonit ju, nëse shejtani do të sundonte dorën, syrin, veshin, këmbët,

zembrën ose trurin e fëmijës suaj, pra në një farë kuptimi, të ishte ortak në fëmijën tuaj?

- Nëse shejtani do t'ju kërkonte të sundonte dorën, këmbën, syrin, veshin, zembrën apo mendjen tuaj, a do ta lejonit? Nëse do t'jua merrte me forcë, a do të nënshtroheshit?

- Nëse shejtani merr formën e një njeriu dhe troket në derën tuaj, duke ju thënë **“unë jam shejtani”** dhe kërkon të hyjë si mysafir në shtëpinë tuaj, a do e mirëprisnit? Si do të ishte për ju, të bënit muhabet së bashku me shejtanin që është ulur këmbë mbi këmbë në dhomën e miqve? Po sikur shejtani të dëshironte të flinte në shtëpinë tuaj, si do të reagonit? Sikur të ulej në sofrën tuaj,

të hante së bashku me ju apo të porosiste disa ushqime që i pëlqejnë, a do të pranoni? A do ta ndani një dhomë për shejtanin?

- A do ta merrnit shejtanin për udhëzues? Sikur t'ju dilte përpara dhe të kërkonte t'ju tregonte rrugën, a do ta ndiqnit atë? Po sikur shejtani të mishërohet në një njeri dhe të zbukuronte një "veprim" me veshjet më të bukura vetëm për ju, a do ta përvetësonit atë veprim me shpirt të qetë?

- Si thoni, sikur të lidhnit shoqëri me shejtanin? A do të dëshironit të ishit miq të tij? Si thua, sikur t'ia jepnit shejtanin kujdestarinë tuaj, pra ta bënit atë drejtuesin tuaj, a do të ishte një veprim i pranueshëm?

Jam i sigurt, se përgjigja që do t'u jepnit këtyre pyetjeve, do të ishte **"jo!"**

Në do të alarmoheshim dhe do të bënim kujdes ndaj një qenieje që është mishëruar në formën e njeriut dhe shëtit lart e poshtë duke thënë, **"unë jam shejtani"**. Do të mendohehim që veten tonë, fëmijët tanë, shtëpinë dhe punën tonë, ta mbronim prej ndikimit të tij.

Shejtani, nuk i bën të gjitha këto punë i mishëruar në identitetin e ndonjë qenieje, por në fakt i bën. I bën, e ata njerëz, të cilët do të alarmoheshin nëse ai do t'i bënte hapur këto punë, mbyllin sytë kur shejtani bëhet ortak në pasurinë dhe fëmijët e tyre, e mirëpresin atë si mysafir në shtëpitë e tyre dhe nuk e kanë për gjë ta ndjekin atë hap pas hapi... Madje, jo vetëm që e lejojnë t'u bëhet ortak në pasuri e fëmijë, por nuk e pengojnë dot edhe nëse ai zë rrënjë në zemrën e vetë atyre, i pushton mendjen dhe i komandon gjymtyrët. Në disa raste ata ndihen edhe të kënaqur prej kësaj.

Kurani, është i mbushur me paralajmërime për njeriun, ndaj shejtanit të mallkuar.

Nga ana e Krijuesit të Madhërishtëm, shejtani cilësohet si, **"armiku i njeriut"**.

Ai do t'i zërë pritë njeriut në rrugë dhe do ta pengojë atë të shkojë drejt Allahut...

Mbi të gjitha, ai është arrogant dhe inatçi përballë Zotit të Madhëruar:

"...do të shohësh se shumica prej tyre nuk do të jenë falënderues!"

Ai është dëbuar prej Allahut, por atij i është dhënë leje të qëndrojë në botën e sprovave të njeriut.

Njeriu është paralajmëruar:

- Shejtani ekziston. Ai është në armiqësi me njeriun që prej krijimit tënd o njeri! Ashtu sikur ti që je në sprovë për të qenë apo jo rob i devotshëm i Allahut e të ndërtosh apo jo një jetë, e cila tek Allahu është cilësuar si e bukur, ashtu edhe atij, pikërisht në lidhje me këtë sprovë, i është njohur e drejta për të të zënë pritë në rrugë (me qëllim që të humbasësh sprovën). Prandaj ruaje veten prej të keqes së tij!

Në bazë të të dhënave të Kuranit, shejtani, është një armik **"i vetëdijshëm"** dhe **"hapur"**. Për këtë arsye, edhe luftën e tij me njeriun do ta zhvillojë në mënyrë të vetëdijshme.

Ai nuk është një qenie pa mend.

Ai është një qenie që thur hile për ta nxjerrë njeriun nga rruga e drejtë.

Ai është një qenie, të cilit i është dhënë cilësia për ta parë njeriun prej andej nga njeriun nuk mund ta shohë.²

Ai nuk është një qenie e vetme; përballë njeriut ndodhet realiteti i "shejtanëve".

Njeriut, nuk i është treguar, se "ky është shejtani" dhe është dikush që ka jetuar në këtë kohë apo në atë kohë. Shejtani ekziston dhe përsëri sipas të dhënave të Kuranit, ai do të ekzistojë së bashku me njeriun. Madje, bëhet e ditur se ai do të marrë pjesë edhe në vendin e mahsherit, në llogarinë e madhe.

"Shejtanët", mund të personifikohen edhe si "njerëz", por edhe si "xhindë"...

Ekzistencën e shejtanit, e kuptojmë prej punëve (sjelljeve), të cilave ai u prin dhe nxit në to. Ndërsa punët, të cilave u prin shejtani dhe që

*Ai është një qenie,
të cilit i është dhënë
cilësia për ta parë
njeriun prej andej nga
njeriun nuk mund ta
shohë.*

1. Shih. Kuran: el-A'raf, 17.

2. Shih. Kuran: el-A'raf, 27.

nxit në to, përsëri sipas të dhënave të Kuranit, janë, **“ato punë që bëhen për të larguar nga rru- ga e drejtë e Allahut”**. Atëherë, nëse bëhet pyetja për të gjetur përgjigjen se, **“Ku është shejtani në këtë punë ose kush është ai që ka marrë rolin e shejtanit?”**, duhet parë, nëse ajo punë gjendet apo jo në rrugën e drejtë të Allahut ose nëse nje- riu që i prin kësaj pune, ndjek apo jo rrugën e drejtë të Allahut.

Ajetet 16-17 të sures el-A’raf, sjellin para nesh **“qëndrimin e shejtanit”** përballë Krijuesit të Ma- dhërishëm:

“Ai (shejtani) tha: “Për shkak se Ti më flake tej, unë do t’u zë pritë njerëzve në rrugën Tënde të drejtë e do t’u qasem atyre nga përpara dhe nga mbrapa, nga e djathta dhe nga e majta, e kështu Ti do të vësh se shumica prej tyre nuk do të jenë falënderues!”

Kjo është një sfidë.

Është e sigurt se shejtani nuk mund të bëjë dot gjë kundër Krijuesit të tij. Mirëpo, këtu bë- het fjalë për sprovën e njeriut dhe, Allahu Teala, në një farë mënyre i ka dhënë shejtanit një mundësi në luftën me njeriun.

Sprova e njeriut është shumë e vështirë, sepse përballë tij, pra përballë qenies që Zoti e ngriti në krijim (që është njeriu), qëndron vull- neti dhe dëshira për ta devijuar, e qenies që ndjen një zemërim shumë të madh (që është shejtani) ndaj tij.

Fusha e veprimit të shejtanit, është me të vër- tetë shumë e gjerë dhe shkatërruese.

- P.sh., atij, i jepet mundësia që të mashtrojë ata, ndaj të cilëve ka fuqi dhe t’i orientojë në rru- gë të këqija.³

- Po ashtu, atyre u njihet edhe mundësia që të bëhen ortakë në pasurinë dhe fëmijët e njeriut.⁴

- Njeriu nuk mund ta shohë shejtanin, por shejtani mund ta shohë njeriun. Shejtani i afro- het njeriut nga e djathta, nga e majta, nga para e nga mbrapa dhe mundohet ta tërheqë atë në një

vend të caktuar. Këtu, bëhet fjalë për pëshpëritjet e një qenieje që nuk shihet me sy dhe që mbase njeriu pandeh se ato janë mendime që vijnë nga brendësia e tij...

- Sipas asaj që mësojmë nga Kurani, shejtani ka mundësi të mbledhë fuqi ushtarake me këm- bësorë dhe kalorës për të sulmuar njerëzit. Pra, pasuesit e shejtanit mund të bëhen një forcë e frikshme... Kjo është një forcë, e cila ndonjëherë përdor edhe fëmijët dhe pasurinë e njeriut si ush- tarë në ushtrinë e vet...

- Shejtani ka palën (grupin, partinë, pasuesit) e vet, ka britmën, thirrjen (mbase ka edhe median) e vet. Ai formon ushtri (xhundu iblis), të posaç- me për veten. Po ashtu, ai ka edhe vëllezër.

- Shejtani është një qenie ngatërrestare dhe provokatore.

- Shejtani mund t’i nxisë miqtë e tij, të luftojnë me ata që nuk devijojnë nga rruga e Allahut.⁵

- Shejtani ka fuqinë që ta zbu- kurojë e të bëjë të duket e bu- kur një sjellje apo një punë të keqe, duke e bërë atë të pra- nueshme për njeriun.⁶ Pra, i mbështjell punët me një pamje të përshtatshme me prirjet dhe shpresat e njeriut, duke i bërë një lloj makijazhi... Ndonjëherë, nxit frikën prej varfë- risë⁷ dhe e bën njeriun të bëjë punë të frikshme, si vrasja e fëmijës në barkun e nënës për shkak të varfërisë. Kjo, tregon se shejtani e kupton mirë psikologjinë njerëzore dhe zhvillon metoda sipas llojit të njerëzve.

- Ndonjëherë, shejtani i vjen njeriut si shok⁸...

- Ndonjëherë, e drejton njeriun në shpre- sa të kota, i jep fjalën, i premtos dhe e bën të shpresojë.⁹

- Shejtani e fillon punën e tij me qëllimin që ta shtyjë njeriun në gjëra të palogjikshme e të kota, aq sa thotë: **“...do t’i urdhëroj që të ndryshojnë krijesën e Allahut...”**¹⁰

5. Shih. Kuran: el-En’am, 121.

6. Shih. Kuran: el-Hixhr, 39.

7. Shih. Kuran: el-Bekare, 268.

8. Shih. Kuran: ez-Zuhruf, 36.

9. Shih. Kuran: en-Nisa, 119-120.

10. Shih. Kuran: en-Nisa, 119.

“(Shejtani), kërkon t’ju shmangë nga përmendja e Allahut dhe kryerja e namazit...”

3. Shih. Kuran: el-Isra, 64.

4. Shih. Kuran: el-Isra, 64.

E megjithatë, Allahu Teala i bën të ditur njeriut se e gjithë kjo fushatë e shejtanit kundër njeriut, nuk do të përfundojë me fitoren e tij (shejtanit):

Ajeti, **“Në të vërtetë, ti nuk ke kurrfarë pushteti ndaj robërve të Mi!...”**¹¹, vjen pas ajetit, **“...do t’u gasem atyre nga përpara dhe nga mbrapa, nga e djathta dhe nga e majta, e kështu Ti do të vëresh se shumica prej tyre nuk të jenë falënderues!”**¹² Përsëri sipas fjalës së Allahut Teala, **“devotshmëria e vërtetë, bëhet shkak i mbrojtjes së Zotit.”**¹³

Pas gjithë këtyre, tani të ndalim pak e të mendojmë:

Çfarë duhet të bëjmë, që të luftojmë kundër këtij armiku të vetëdijshëm?

Rrugën e kësaj, na e tregon përsëri Zoti ynë:

- Pikësëpari, njeriu duhet të njohë armiqësinë e tij dhe t’i japë atij përgjigjen e merituar.

- E rëndësishme është të mos bëhesh mik apo shok me të.

- Përpjekja për t’u bërë rob i vërtetë i Allahut, është mburoja më e rëndësishme me të cilën mund të pajisesh kundër shejtanit.

- Në Kuran, urdhërohet: **“...(Shejtani), kërkon t’ju shmangë nga përmendja e Allahut dhe kryerja e namazit...”**¹⁴ Ndërsa në një ajet tjetër, theksohet se: **“Kush i shmanget përmendjes së Allahut, do t’i caktojme si shok një shejtan që nuk do t’i ndahet”**.¹⁵ Pra, mbrojtja duhet të bëhet me namaz dhe përmendje të Allahut.

- Për t’u mbrojtur nga shejtani, njeriu duhet të shikojë mirë se nga i vijnë ndjenjat, nga e djathta, e majta, nga para, nga mbrapa apo nga brenda. Në bazë të kësaj, duhet t’i filtrojë mirë “frymëzimet e shejtanit”.

- Për të mbrojtur shtëpinë prej shejtanit, kërkohet një kujdes shumë i veçantë. Për të mos pasur fatin e keq që të kemi shejtanin si mysafir në shtëpitë tona, duhet të bëjmë atë që është e nevojshme. Dezinfektimi i shtëpive prej gjurmëve të shejtanit, është një punë shumë e domosdoshme.

- Shejtanit, nuk duhet t’i japim mundësi të bëhet ortak as në gjymtyrët tona dhe as në fëmijët tanë.

- Kur shejtanët të mbledhin të gjitha fuqitë e tyre për të na sulmuar, duhet t’i mbajmë hapur rrugët për t’u strehuar tek Zoti ynë. Pra, në ato momente, nuk duhet ta kemi humbur rrugën për tek Allahu.

- Nuk duhet ta humbasim kurrë vullnetin për të genë prej njerëzve, të cilët nuk largohen nga rruga kundër armiqësisë së pashoqe të shejtanit.

- Kurani, duke numëruar disa vepra të “injorancës”, si pijet alkoolike, bixhozi, idhujt dhe shigjetat e fallit, i cilëson ato, si **“punë të shejtanit”** dhe **“të ndyta”**.¹⁶ Prandaj, nuk duhet t’i ngjyemë duart tona, sytë, veshët, zemrën dhe mendjen tonë në punët e shejtanit dhe nuk duhet të lejojmë që ato të ndyhen me to.

- Duhet të tregojmë një kujdes të jashtëzakonshëm, që asnjë prej punëve tona, të mos përfshihet në **“një prej luftërave në rrugë të shejtanit”**¹⁷

- Ata që na prijnë, duhet t’i japin rëndësi marrëdhënive me Allahun, ndërsa ne, kurrë nuk duhet të përvetësojmë një mënyrë jetese e cila ka cilësinë e “ndjekjes së hapave të shejtanit”.¹⁸

- Nxitja më e spikatur e shejtanit, është **“paturpësia”** dhe të gjitha të këqijat.¹⁹ Për ne, paturpësia dhe të gjitha të këqijat e tjera, duhet të jenë si të mbajmë shejtanin përdore në cilësinë e një zjarri përcëllues.

- Ecja e shejtanit si shejtan, filloi me diskutimin dhe kundërshtimin e urdhrit të Allahut. Prandaj, ajo që duhet të ketë më tepër kujdes besimtari, është nënshtrimi dhe bindja me një dorëzim të përzemërt ndaj urdhrave të Allahut.

- Dhe e fundit: Të strehohesh tek Allahu, ndaj çdo lloj hileje të shejtanit...

“Nëse djalli përpiqet të të shtyjë drejt së keqes, kërko strehim tek Allahu, se vërtet, Ai dëgjon dhe di gjithçka. Ata që i frikësohen Allahut, kur u vjen ndonjë mendim i lig nga djalli, i kujtojnë (urdhrat e Tij), e atëherë e shohin rrugën e drejtë. Ndërsa vëllezërit e vet (prej njerëzve), ata i shpien edhe më tej në humbje pa pushuar.” (A’raf, 200-202)

Atëherë...

Eudhu bil-lahi mine’sh-shejtani’rr-rraxhim.

11. Shih. Kuran: el-Isra, 65.

12. Shih. Kuran: el-A’raf, 16-17.

13. Shih. Kuran: el-Isra, 65.

14. Shih. Kuran: el-Maide, 91.

15. Shih. Kuran: ez-Zuhuf, 36.

16. Shih. Kuran: el-Maide 90.

17. Shih. Kuran: en-Nisa, 76.

18. Shih. Kuran: el-Bekare, 168, 208.

19. Shih. Kuran: en-Nur, 21.

ZGJEDHJA E MIQËSISË

Prof. dr. Jashar Kandemir

Mik do të thotë ndihmës, mbrojtës, dashamir.

KUSH DHE MIK I KUJT ËSHTË?

Allahu i Madhëruar, në lidhje me këtë, na ka njoftuar se:

Besimtari ka tre miq: Allahun, Pejgamberin dhe besimtarët.

Edhe Pejgamberi ka tre miq: Allahun, Xhebrailin dhe besimtarët.


Kur Pejgamberi ynë (a.s.), po fliste rreth të afërmeve të tij, të cilët nuk ishin bërë ende myslimanë, tha se ata

nuk janë miqtë e tij; miqtë e tij, janë Allahu i madhëruar dhe besimtarët e mirë. E megjithatë, ai theksoi se nuk do t'i shkëpuste plotësisht lidhjet me farefisën e tij.

KUSH JANË MIQTË E ALLAHUT?

Miqtë e Allahut janë ata që e duan Allahun dhe njëritjetrin për hir të Allahut.

Në Ditën e Kiametit, disa pejgamberë dhe dëshmorë, do t'i shohin



Muslimani nuk mund të jetë mik i mohuesve të Allahut, të dyfytyrëshve, të ngatërrestarëve dhe të keqbërësve. Ai nuk duhet të bëhet mik i atyre që ushqejnë armiqësi ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij, edhe sikur ata të jenë babai, fëmija, vëllai apo të afërmit e tij.

me zili disa persona. Këta, nuk janë as pejgamberrë, as dëshmorë. Por e kanë arritur atë gradë në sajë të mirësisë së Allahut. Këta fatlumë, janë ata që e kanë dashur njëri-tjetrin për hir të Allahut, pa pasur midis tyre asnjë lidhje farefisnore apo tregtie.

Atë ditë, ata do të jenë mbi një dritë;

Fytyrat e tyre do të shndrisin;

Ata do të jenë të qetë, kur të tjerët të jenë të frikësuar;

Ata do të jenë të gëzuar, kur të tjerët të hidhërohen.

NUK DUHET ZËNË MIQËSI ME ATA QË E MOHOJNË ALLAHUN!

Le ta mësojmë këtë çështje prej Zotit tonë të Madhëruar:

Muslimani nuk mund të jetë mik i mohuesve të Allahut, të dyfytyrëshve, të ngatërrestarëve dhe të keqbërësve. Ai nuk duhet të bëhet mik i atyre që ushqejnë armiqësi ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij, edhe sikur ata të jenë babai, fëmija, vëllai apo të afërmit e tij. (shih. Teube, 9/23.)

Allahu i Madhëruar urdhëron që të luftohet pa u lodhur, me forcë dhe vendosmëri kundër dyfytyrëshve; Ai e ka ndaluar braktisjen e besimtarëve, duke bërë miqësi me armiqtë e Allahut dhe myslimanëve. (shih. Al-i Imran, 3/28.)

Megjithatë, kur janë të detyruar, myslimanët mund të tregohen si miq të armiqve të tyre të fuqishëm, me qëllim që t'i ruhen të keqes së tyre.

Një nga arsyet që Allahu i Madhëruar i dënoi Bijtë e Izraelit, ishte se shumica e tyre bëheshin miq me mohuesit e Allahut.

Përse nuk duhet të miqësohemi me mohuesit? Edhe këtë, Allahu i Madhëruar na e shpjegon kështu:

“Nëse ju mposhtin, ata do të jenë armiqtë tuaj e do t’i zgjasin duart dhe gjuhët e tyre për t’ju lënduar ju, sepse dëshirojnë që ju të bëheni jobesimtarë.” (Mumtehine, 2)

“...Kur ata ju takojnë, thonë: “Edhe ne besojmë” e, kur mbeten vetëm, nga mllëfti ndaj jush, ata i kafshojnë majat e gishtave me dhëmbë...” (Al-i Imran, 119)

A duhet t'i shohim të gjithë mohuesit me këtë sy? Allahu i Madhëruar, edhe për këtë ka vendosur kriteret e duhura:

“Allahu, nuk ju ndalon të silleni mirë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre që nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe që nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Me të vërtetë, Allahu i do të drejtët.

Allahu ju ndalon t’i bëni miq ata që luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe ju dëbojnë nga vatrat tuaja, si dhe mbështesin të tjerët që t’ju dëbojnë. Kushdo që i bën miq ata, është punëmbrapshtë.” (Mumtehine, 8-9)

ME KEQBËRËSIT NUK KRIJOHET AFRIMITET

Resulullahu (a.s.), na ka njoftuar ardhjen e priësve tiranë e të padrejtë dhe është shprehur se:

“Kush u afrohet atyre, kush i aprovon gënjeshtat e tyre dhe kush i ndihmon ata në tiranitë e tyre, nuk do të ketë asnjë lidhje me të (pejgamberin) dhe në botën tjetër, ata nuk do të mund t’i afrohen atij në krye të burimit (keutherit). Ndërsa kush nuk u afrohet atyre (tiranëve), nuk i aprovon gënjeshtat e tyre dhe nuk i ndihmon ata në tiranitë e tyre, do të jetë prej tij (të dashurve të pejgamberit) dhe do të takohen me të në krye të burimit.” (Hajatu’s-Sahabe, 2: 196; Isabe, 3: 297; Mustedrek, 3: 479; Tirmidhi, Fiten: 72; Musned, 4: 243.)

ME KË DUHET TË KRIJOSH MIQËSI?

Siç është shprehur edhe Pejgamberi ynë (a.s.):

“Njeriu ndikohet nga mënyra e jetesës së shokut të tij. Prandaj, besimtari duhet të bëjë kujdes në zgjedhjen e miqve!” (shih. Ebu Daud, Edeb 16.)

Ai duhet të zërë miqësi vetëm me besimtarët. Gjithashtu, ai duhet të qëndrojë me njerëzit e devotshëm, të hajë dhe të pijë vetëm me ta.

“Shoku i mirë është si shitësi i parfumit, ndërsa shoku i keq është si farkëtar. Ai që shet parfum, është i dobishëm në çdo rast. Ose do të blesh parfum prej tij, ose do të parfumosë ai ty, ose më e pakta, do të mbash erë të këndshme për sa kohët të jesh me të. Kurse shoku i keq, që i ngjan farkëtarit, ose do të djegë rrobën me ndonjë shkëndijë zjarri, ose të paktën do të shqetësojë era e keqe e farkës.” (shih. Muslim, Birr, 146.)

Tani t’i vëmë veshin fjalës së Allahut (xh.sh.):

Kur Allahu i Madhëruar flet në lidhje me pendimin në Ditën e Kiametit të atyre që ishin bërë miq me njerëzit e këqij, shprehet:

“Atë Ditë keqbërësi do të hajë gishtat e duarve të veta, duke thënë: «Ah sikur ta kisha marrë rrugën (e drejtë) me të Dërguarin! Ah sikur të mos

e kisha bërë filanin mik! Ai më ka larguar nga Këshilla (Kurani) që më kishte ardhur!»...” (Furkan, 27-29)

Shkurtimisht, atë ditë, përveç njerëzve të devotshëm, miqtë e vjetër do të bëhen armiq të njëri-tjetrit.

NJË SHEMBULL MIQËSIE

Le të shohim një shembull miqësie nga jeta e Pejgamberit tonë (a.s.):

Ebu Derda (r.a.), tregon:

Isha ulur pranë Resulullahut (a.s.), kur në atë moment u duk Ebu Bekri (r.a.). Ai e kishte mbledhur rrobën aq sa i dukeshin gjunjët dhe po vinte i shqetësuar. Pejgamberi ynë (a.s.), tha:

“Mesa duket, është grindur mendonjë ngashokët!”

Pasi dha salam, Ebu Bekri (r.a.), tha:

“O Resulullah! Ndodhi një mosmarrëveshje midis meje dhe Omer ibn Hattabit. Unë e teprava disi. Pastaj u bëra pishman për atë që veprava. Prandaj i kërkova të më falte. Mirëpo ai nuk pranoi. Kështu që erdha direkt tek ti.”

Pasi e dëgjoi, Pejgamberi ynë i nderuar (a.s.), tha tri herë:

“Allahu të faltë, o Ebu Bekir!”

Pas njëfarë kohe, edhe Omeri (r.a.), u bë pishman për veprimin e tij. Prandaj shkoi drejt e në shtëpinë e Ebu Bekrit (r.a.) dhe pyeti:

“A është Ebu Bekri në shtëpi?”

“Jo, nuk është në shtëpi!” i thanë. Për këtë arsye, ai shkoi drejt e tek Pejgamberi (a.s.) dhe dha salam.

Në atë moment, fytyra e bekuar e Resulullahut (a.s.), filloi të tregonte shenja të zemërimit. Ebu Bekri (r.a.), i cili u frikësua se mos Pejgamberi (a.s.), i thoshte gjë Omerit (r.a.), u ul mbi gjunjë dhe tha dy herë:

“O i Dërguar i Allahut! Vallahi grindjen e fillova unë!”

Atëherë, Resulullahu (a.s.), tha:

“Kur Allahu i Madhëruar më dërgoi si Pejgamber, ju më përgënjeshtuat. Mua më besoi vetëm Ebu Bekri. Dhe ai më mbështeti me pasurinë dhe jetën e tij. Shokun tim do të ma lini mua, apo jo?.. Shokun tim do të ma lini mua, apo jo?..”

Që prej asaj dite, askush nuk bëri ndonjë veprim që do ta mërzhiste Ebu Bekrin (r.a.).



Islami është çlirimi i Zemrave

— M. Ali Eshmeli —

Në esencën e të gjitha çlirimeve që kemi bërë përgjatë historisë ka një mesazh: Përgëzimi i Pejgamberit (a.s.). Të mos harrojmë se çdo përgëzim ka edhe një kusht: Personaliteti i Pejgamberit (a.s.). E fshehta e atij personaliteti është feja e qartë, Islami. Ndërsa e gjithë shfaqja e Islamit është çlirimi i zemrave. Ja, zemrat që u përsosën duke e kuptuar këtë të fshehtë dhe që iu drejtuan çlirimeve të mëdha me këtë pjekuri sublime, u bënë çliruese në kuptimin e vërtetë, sepse ato e morën mesazhin e çlirimit nga i Dërguari i Allahut (a.s.). Atë e bënë qëllim dhe dashuri. Këtij qëllimi dhe kësaj dashurie nuk i shtuan asnjë pikë tjetër të ndryshme dhe flijuan jetët e çdo gjë të tyre për t'i realizuar ata me pastërti shpirtërore, sepse ata e perceptuan se çlirimi i zemrave është specifika më e rëndësishme

në mesazhin e çlirimit. Për këtë arsye, qëllimi i atyre asnjëherë nuk ka qenë një luftë e thatë. Ata nuk kanë hyrë në beteja të përgjakshme. Gjithashtu nuk u bënë kurbane të dëshirës së zjarrtë për të mos lënë gurë mbi gurë dhe kokë mbi supë.

Ata gjithmonë e kuptuan saktë mesazhin e çlirimit. Në sajë të kësaj, shkruan legjenda të mëdha me perceptimin se çlirimi nuk është vrasje por gjallërim. Shtetet dhe kontinentet që i panë ata, nxituan për t'u futur në Islam. Kështu është bërë myslimane Afrika, kështu është bërë myslimane Andaluzia, kështu është bërë mysliman Turkistani, kështu është bërë mysliman Anadulli, kështu është bërë mysliman Ballkani dhe kështu është bërë Stamboll / qyteti i Islamit Kostandinopoja. Kështu kanë arritur të zgjerohen kufijtë e gjeografisë

sonë deri në njëzet e katër milion kilometra. Ndërsa kufijtë tanë shpirtërorë kështu e morën në vete të gjithë botën, sepse qëllimi gjithmonë ishte zemra, gjithmonë ishte në zemër dhe gjithmonë ishte prej zemrës. Sepse kjo ishte edhe e fshehta e çlirimit në përgëzimin e të Dërguarit të Allahut (a.s.) edhe e vërteta. Për këtë arsye, shumë herë në historinë e Islamit, faqet e vetme që duhet të shihen për ta parë dhe kuptuar qartë esencën e të gjitha çlirimeve, në të cilat është arritur edhe e pamundura, janë fletë të arta e të pashoqe të mbushura plot me çlirimet shpirtërore të të Dërguarit të Allahut, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, që nuk mund të fshihen nga historia, sepse edhe luftërat e atij (a.s.), në të vërtetë ishin të stolitura nga fillimi e gjer në fund me çlirimin e zemrave.

Kur të shtjellohen me kujdes kujtimet e shenjta të atij (a.s.), në çdo luftë, do të shihet qartë se edhe fitorja në Bedër ishte çlirim i zemrave. Edhe përvoja në Uhud ishte çlirim i zemrave. Edhe suksesi në Hendek ishte çlirim i zemrave. Edhe legjenda në Hajber ishte çlirim i zemrave. Edhe durimi dhe vendosmëria madhështore në Tebuk ishte çlirim i zemrave. Ndërsa marrja e Mekës realizoi një çlirim plotësisht tjetër të zemrave. Për sa i përket Medines, ajo në të vërtetë, krejtësisht ishte çlirim i zemrave. Sahabi i ri, Mus'abi (r.a.), i cili shkoi në Medine me urdhrin e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), për t'ua predikuar dhe mësuar Islamit banorëve të saj, arriti begati të mëdha dhe u bë shkak për përhapjen e Islamit. Një ditë shkoi në bahçen e Beni Zaferëve bashkë me Es'ad ibn Zuraren, në shtëpinë e të cilit rrinte. Ndërkohë që ata po bisedonin në krye të pusit, Sa'd ibn Muadhi, i cili ishte prej Beni Abdulleshhelëve, i tha Usejd ibn Hudajrit: "O Usejd! Ti je një njeri që nuk ke nevojë për ndihmën e të tjerëve. Edhe punën tënde di ta bësh mjaft mirë. Andaj, shko te ata burra që kanë ardhur në lagjen tonë për t'u ndryshuar besimin të dobëtëve tanë dhe largoji nga aty! Këtë mund ta bëja edhe vetë, por siç e di, Es'adi është i afërmi im."

Usejdi u nxit nga fjalët që dëgjo. Andaj, menjëherë e mori heshtën, u hodh në këmbë, shkoi te ata dhe u foli më shumë zemërim dhe kërcënim: "Çfarë pune keni ju këtu? O Es'ad! A na e ke sjellë këtë të huaj që të prishë besimin e të dobëtëve ndërmjet nesh? Bëj kujdes dhe asnjëherë mos tento ta bësh edhe një herë diçka të tillë! Nëse nuk doni të vdisni, largohuni menjëherë nga ky vend!" Mus'abi (r.a.), i cili ishte i urtë dhe i zgjuar, iu përgjig me qetësi: "A nuk dëshiron të ulesh dhe të dëgjosh ato që do të të them? Me sa shoh, keni një personalitet me mendje të shëndoshë. Dëgjo! Nëse nuk i pëlqen ato që do të të them, mos i prano! Ti mund t'i pranosh ato vetëm nëse i pëlqen!" Usejdi u qetësua dhe i tha: "Kjo që më the është një qasje e logjikshme dhe e drejtë."

Pastaj e nguli në tokë heshtën që kishte në dorë, u ul dhe filloi ta dëgjonte. Mus'abi, radijallahu anh, ia shpjegoi Islamit duke i lexuar Kuran. Usejdi u zbut prej atyre që dëgjo. Kurani Fisnik filloi t'i hynte në zemër. Drita e udhëzimit i reflektoi edhe në shpirt, edhe në fytyrë. Andaj tha me një entuziazëm dhe admirim të madh: "Sa fjalë e bukur dhe sublime që qenka kjo! Çfarë duhet të bëj për të hyrë në Islam?" Pastaj mori gusul ashtu siç e mësoi Mus'abi dhe Es'adi. Po ashtu veshi edhe rroba të pastra. Pastaj tha plot sinqeritet edhe shehadetin. Pastaj filloi namazin dhe fali dy rekatë. Pastaj tha:

"Atje pas gjendet një njeri që nëse lidhet me ju, asnjë prej fisit të tij nuk do të kundërshtojë. Ai është Sa'd ibn Muadhi. Menjëherë po shkoj te ai dhe po e dërgoj te ju." Edhe Sa'd ibn Muadhi ishte mjaft i zemëruar kur shkoi atje. Por pasi e dëgjo në të njëjtën mënyrë Mus'abin, edhe ai besoi duke e pranuar Islamit me gjithë zemër. Menjëherë pasi e pranoi Islamit, e mblodhi fisin e tij dhe i pyeti të gjithë pjesëtarët e fisit: "Si më njihni mua, o Beni Abdulleshhelë?" Të gjithë iu përgjigjën: "Ti je i nderuari ynë. Edhe nga aspekti i mendimit je prijësi ynë dhe më i zgjuari prej nesh." Atëherë Sa'di u bëri këtë deklaratë: "Unë nuk do të flas as me gratë dhe as me burrat tuaj derisa ju t'i

*Shumë herë
në historinë e Islamit,
faqet e vetme që duhet
të shihen për ta parë dhe
kuptuar qartë esencën e
të gjitha çlirimeve, në të
cilat është arritur edhe e
pamundura, janë fletë të arta
e të pashoqe të mbushura
plot me çlirimet shpirtërore
të të Dërguarit
të Allahut.*

besoni Allahut dhe të Dërguarit të Tij duke thënë shehadetin.” Në këtë mënyrë, deri në mbrëmje të gjithë pjesëtarët e këtij fisi hynë në Islam atë ditë. (Ibn Hisham, II, 43-46; Ibn Sa’d, III, 604-605; Ibn Esir, Usdu’l-Gabe, I, 112-113.)

Për shkak të këtyre çlirimeve shpirtërore, i Dërguari i Allahut, (a.s.), tha: “*Medina është çliruar me Kuran.*” (Bezzar, Musned, nr: 1180; Rudani, nr: 3774.)

Ja edhe një shembull tjetër i çlirimeve shpirtërore të veçanta po nga epoka e lumturisë: Umejri ibn Vehbi... Umejri ibn Vehbi ishte i njohur me torturat dhe vuajtjet që ua shkaktoi të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe sahabëve të tij në periudhën e Mekës. Ai ishte një politeist djallëzor prej të parëve të kurejshëve. Biri i tij Vehbi pati rënë rob në luftën e Bedrit. Kur një herë po bisedonin për ato që kishin ndodhur në Bedr, miku i tij, Safuan ibn Umejje i tha Umejrit: “Betohem se është e kotë të jetojmë pas kësaj gjendjeje!” Umejri u acarua dhe tha: “Betohem se kjo që the është e drejtë. Po të mos kisha borxhet dhe familjen për të cilën kam frikë se vdesin nga uria pas meje, patjetër do të ngrihesha menjëherë dhe do të shkoja për ta vvarë Muhamedin. Mbi të gjitha, kam edhe një pretekst që ata e vlerësojnë. Atyre mund t’u them se kam ardhur për birin tim që e kanë zënë rob. Përveç të tjerash, kam dëgjuar se biri im mund të dalë jashtë.” Safuanit i qeshi fytyra prej këtyre fjalëve të Umejrit. Andaj i tha: “Mos u shqetëso! Borxhi yt tashmë është borxhi im. Do ta paguaj të gjithin. Edhe jetesa e familjes tënde më përket mua.”

Pasi Umejri e mori këtë besë, e mprehu shpatën e tij dhe e leu me helm. Mori ushqimin që ia përgatiti Safuani, i hipi kafshës së tij dhe shkoi drejt e te Xhamia e Pejgamberit. E mori shpatën dhe e lidhi devenë. Sapo Umeri e pa atë, mendoi: “Ky është armiku i Allahut, Umejri! Ardhja e atij këtu për Zotin është vetëm për ndonjë të keqe. A nuk ishte ai që na ngatërronte me kurejshit? A nuk ishte ai që e llogariti numrin tonë ditën e Bedrit dhe u tregoi kurejshëve politeistë?” Pastaj menjëherë shkoi te i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe e njoftoi duke i thënë: “O i Dërguari i Allahut! Armiku i Allahut, Umejri është këtu. Mbi të gjitha, ka edhe shpatën të varur për qafe.” I Dërguari i Allahut (a.s.), i tha: “*Sille pranë meje!*” Umeri (r.a.), e kapi atë për këllëfi të shpatës dhe e solli. Edhe ensarëve që gjendeshin aty u tha që të bënin kujdes duke u shprehur: “Rrini pranë të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe mbrojeni atë nga ky njeri i keq! Padyshim se këtij pisi nuk i besohet!” Por i Dërguari i Allahut (a.s.), ishte i qetë dhe i tha:

“*O Umejri! Mos e pengo atë! O Umejri! Eja pranë meje!*” Pastaj e pyeti Umejrin për shkakun e ardhjes së tij. Umejri i dha përgjigjen që kishte planifikuar: “Biri im është rob te ju. Unë kam ardhur për atë. Shpresoj që të shfaqni mirësi ndaj tij.” I Dërguari i Allahut (a.s.), e pyeti përsëri: “*Nëse është ashtu, përse e ke këtë shpatë në qafë?*” Umejri përsëri iu përgjigj siç e pati planifikuar: “Allahu i mallkoftë shpatat! Çfarë dobie kemi pasur prej tyre?!” I Dërguari i Allahut (a.s.), e pyeti përsëri: “*Më thuaj të vërtetën! Cili është shkakun që ke ardhur këtu?*” Umejri këmbënguli në pretekstin e tij: “Nuk kam ndonjë shkak tjetër. Biri im është rob te ju. Unë kam ardhur vetëm për atë.” Këtë herë i Dërguari i Allahut (a.s.), e pyeti kështu: “*Atëherë më thuaj! Çfarë kushti i ke vënë Safuanit në Hixhr?*” Umejri u zu në befasi dhe tha: “Çfarë kushti i paskam vënë unë atij?” Së fundi i Dërguari i Allahut (a.s.), ia tregoi të gjitha fjalët një për një që ata të dy i patën bërë bashkë dhe i tha: “*Allahu i Lartësuar ndërhyri ndërmjet teje dhe asaj që deshe të bëje dhe të ndaloj.*”

Zemra e Umejrit u mbush plot me dritën e besimit kundrejt kësaj shfaqjeje. Umejri tha: “Unë dëshmoj se me të vërtetë je i Dërguari i Allahut! O i Dërguari i Allahut! Ne gjithmonë e kemi mohuar se ty të zbret shpallje dhe të vijnë lajme nga qielli, por ja që ato paskan qenë të vërteta, sepse këtë çështje nuk e ka ditur askush përveç meje dhe Safuanit. Betohem se vetëm Allahu të ka njoftuar për këtë çështje. Falënderimi i përket Allahut që më solli këtu dhe më nderoi me Islamin në audiencën tënde.” Nisur nga ky rezultat i mrekullueshëm, i Dërguari i Allahut (a.s.), tha: “*Mësojani mirë Islamin vëllait tuaj të ri! Këtë bëjeni duke i lexuar Kuran! Ndërkohë, lirojani edhe birin e tij që gjendet rob tek ne!*” Ky urdhër i të Dërguarit të Allahut (a.s.), u zbatua menjëherë dhe me përpikëri. Pastaj Umejri (r.a.), kërkoi leje duke u shprehur: “O i Dërguari i Allahut! Deri më tani u kam bërë shumë tortura të rënda besimtarëve dhe jam përpjekur për ta shuar dritën hyjnore. Tani më jep leje që të shkoj në Mekë dhe këtë herë të derdh djersë për t’i ftuar politeistët e atjeshëm te Allahu dhe i Dërguari i Tij, domethënë në Islam. Ndosh-ta Allahu i udhëzon edhe ata.” I Dërguari i Allahut (a.s.), i dha leje kësaj dashurie që sapo gjelbëronte në rrugën e Allahut Teala.

Ndërkohë Safuan ibn Umejje, i cili nuk dinte asgjë nga ato që kishin ndodhur, u jepte përgëzime politeistëve të Mekës duke u thënë: “Edhe pak ka nge-lur, edhe disa ditë. Ka për të ardhur një lajm që do të gëzoheni të gjithë. Ai do të jetë një lajm aq i madh, saqë do t’ju bëjë ta harroni dhimbjen e Bedrit!” Ai

pyeste çdo karvan që shikonte. Më së fundi, nga një kalorës erdhi lajmi se Umejri ishte bërë mysliman. Ndërkohë edhe Umejri u kthye në Mekë dhe filloi të predikonte Islamin. Ata që deshën ta ndalonin, nuk ia dolën dot mbanë. Në sajë të përpjekjeve të tij largpamëse dhe guximtare, shumë zemra u udhëzuan. Një ditë kur ishte në Qabe, u takua me Safuanin. Atij i thirri menjëherë: “O Safuan! Ti je prej të parëve tanë. A nuk e shikon se këto gjëra që i adhurojmë dhe për të cilat therim kurbane nuk janë tjetër veçse gurë të thatë?! A bën një fe e tillë? Dëshmoj me plot bindje se nuk ka zot tjetër përveç Allahut! Gjithashtu, dëshmoj me plot bindje se Muhamedi është robi dhe i dërguari i tij!” Safuani heshti. Nuk tha dot asnjë fjalë. (Ibn Hisham, II, 306-309; Vakidi, I, 125-128; Ibn Sa’d, IV, 199-201.)

Ja, kështu u ngjall te i Dërguari i Allahut (a.s.), Umejri (r.a.), i cili shkoi për ta vrarë atë, sepse Pejgamberi (a.s.), i çliroi zemrën. Edhe Umeri (r.a.), u ngjall kur pati shkuar për ta vrarë të Dërguarin e Allahut (a.s.). Edhe mekasi i quajtur Fedale ishte njëri prej atyre që shkoi për ta vrarë të Dërguarin e Allahut (a.s.), por që u ngjall te ai...

Përgjatë çlirimit të Mekës Fedale iu afrua shumë të Dërguarit të Allahut (a.s.), me qëllimin për ta vrarë. I Dërguari i Allahut (a.s.), e dinte nijetin e keq të tij, por nuk shfaqti asnjë shqetësim apo zemërim. Vetëm hapi fletët e dhembshurisë e mëshirës dhe e pyeti: “*Ti je Fedale, apo jo?*” Fedale iu përgjigj: “Po.” I Dërguari i Allahut (a.s.), i tha: “*O Fedale! Pendohu dhe kërkoji falje Zotit për ligësinë që ke planifikuar brenda teje!*” Pastaj i Dërguari i Allahut (a.s.), ia le dhatoi kraharorin Fedales me duart e tij të bekuara. Menjëherë Fedales i iku nga mendja ai mendimi i keq që kishte më parë, zemra iu ngroh dhe shpirti iu mbush me dritën e udhëzimit. Në këtë mënyrë, Pejgamberi u bë njeriu më i dashur për të. (Ibn Hisham, IV, 37; Ibn Kethir, es-Sire, III, 583.)

Ja çlirimi shpirtëror! Ja Islami! Ja udhëzimi!

Përsëri ishte dita e çlirimit të Mekës. Politeistët mekas që i patën bërë të Dërguarit të Allahut (a.s.), çdo lloj torture e padrejtësie dhe që i patën shkakuar atij shumë vuajtje e probleme, atë ditë çlirimi gjendeshin përpara tij të turpëruar. Të gjithë i kishin kokat të ulura, sepse meritonin ndëshkimet më të rënda. Ndërsa disa prej tyre meritonin vetëm dënimin me vdekje. Ata që e patën përzënë të Dërguarin e Allahut (a.s.), nga ky qytet, tashmë kishin ardhur për të kërkuar mëshirë nga ai po në këtë qytet. Të gjithë ishin të turpëruar përpara jetimit që dikur e patën nënçmuar dhe torturuar. Tashmë

po kërkonin dhembshuri nga jetimi që dikur nuk patën mëshirë për të. Tashmë po kërkonin mirësi dhe falje nga i varfri i mjerë që dikur e patën lënë të uritur pa i vrarë aspak ndërgjegjja. Fati i të gjithëve ishte i lidhur me vendimin që do të jepte ai. Andaj po prisnin me zemra të shqetësuara, me sy të brenzosur dhe me fjalë shprese. Vallë çfarë do të bëhej me ta? Të gjithë po heshtnin. Madje, mezi po merrnin frymë. I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, filloi të fliste:

“O Mekas! Edhe unë po ju them siç iu tha Jusufi (a.s.), vëllezërve të tij: “...Sot s’ka qortim për ju; Allahu ju faltë. Ai është më i mëshirshmi i mëshiruesve!” (Jusuf, 92) Hajt shkoni të sigurt! Tashmë të gjithë jeni të lirë... Sot është dita që Allahu i Lartësuar i ka forcuar kurejshët dhe i ka lartësuar me Islam...” Ja çlirimi shpirtëror! Ja Islami! Ja udhëzimi! Atë ditë zemrat vrapuan në besim dhe Islam grupe-grupe, karvanë-karvanë prej këtij çlirimi shpirtëror. (Shik. Ibn Hisham, IV, 32; Vakidi, II, 835; Ibn Sa’d, II, 142-143.) Ja, ky është çlirimi shpirtëror!

Përsëri ishte dita e çlirimit të Mekës. Ebu Sufjani ishte ulur në Qabe dhe ishte zhytur në mendime të thella. Hodhi një vështrim. Përpara ishte i Dërguari i Allahut (a.s.). Ndërsa myslimanët ecnin pas tij. Nga brenda e nxiste diçka: “Vallë, a të formoj përsëri ndonjë ushtri tjetër kundër Muhamedit? A thua të luftoj përsëri me atë?” Pikërisht në ato momente i Dërguari i Allahut (a.s.), shkoi drejt tij, iu afrua, e preku me dorën e tij të bekuar ndërmjet dy shpatullave dhe i tha: “*Atëherë edhe Allahu do të të bëjë ty një të mjerë të poshtëruar.*” Ebu Sufjani u tremb dhe e ngriti kokën. Kur e pa të Dërguarin e Allahut (a.s.), pohoi: “Deri më tani nuk isha i bindur plotësisht se je pejgamber. Ndërsa tani pendohem sinqerisht te Allahu për mendimet e këqija që kam pasur në mendje. Atij i kërkoj falje dhe mëshirë.” (Ibn Kethir, el-Bidaje, IV, 296.)

Ja Islami! Ja çlirimi shpirtëror! Ja çlirimi i një zemre të fituar duke duruar ndaj të gjitha armiqësive dhe sulmeve për një kohë të gjatë njëzet e një vjeçare. Padyshim se madhështia e këtij çlirimi buronte nga një pjekuri shpirtërore që mund ta realizojë atë. Kjo është një pjekuri shpirtërore që nuk e humb veten dhe durimin as në kohëra të vështira dhe as në betejat më të përgjakshme. Gjithashtu, kjo pjekuri shpirtërore gjithmonë bëhet shkak për udhëzimin e njerëzve. Kjo është një pjekuri shpirtërore që i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, ua ka mësuar shokëve të tij. Shembujt janë të shumtë:

Në çlirimin e Hajberit i Dërguari i Allahut (a.s.), ia dha flamurin Aliut (r.a.) dhe i tha: *“Ec Ali, përpara! Mos shiko djathtas e majtas derisa Allahu të të japë fitoren!”* Aliu (r.a.), u hodh përpara, por një moment ndaloi dhe e pyeti Pejgamberin pa e kthyer kokën pas: *“O i Dërguari i Allahut! Për çfarë të jetë lufta ime kundër atyre?”* I Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha: *“Lufto me ata derisa të thonë: ‘Nuk ka zot tjetër përveç Allahut! Muhamedi është i Dërguari i Allahut!’ Kur ta thonë shehadetin, përderisa nuk i shkelin ndalesat e fesë, i kanë të mbrojtura jetën dhe pasurinë e tyre nga ti. Atëherë i takon Allahut që ta bëjë llogarinë e tyre. (Në këtë çështje) mos nxito! Shko te ata plotësisht i qetë! Së pari ftoji në Islam! Nëse me këtë ftesën tënde një njeri bëhet mysliman, kjo është më e mirë për ty se sa të të jepen deve të kuqe!..”* (Buhari, As’habu’n-Nebi, 9; Muslim, Fedailu’s-Sahabe, 32-34; Hejsemi, VI, 151.)

Ja çlirimi shpirtëror! Ja udhëzimi i Islamit!

Ja kështu çliruan ata! Ata fituan zemra pa e përzier kurrë nefsin në këtë çështje, sado që të ishte i shtrenjtë çmimi që paguan. Ata asnjëherë nuk harruan se zemra është zemër vetëm nëse nuk përzihet nefsi. Sahabët e nderuar u edukuan me mësimin e përvojën e kësaj dhe arritën pikat më kulmore. Kur Aliu (r.a.), po e vriste kundërshtarin e tij në një betejë të përgjakshme, menjëherë hoqi dorë nga vrasja e tij kur e pështyu në fytyrë. Këtë e bëri në sajë të urtësisë që kishte marrë nga i Dërguari i Allahut (a.s.). Ndërsa tani, lëri mënjandë armiqët, por ka disa prej myslimanëve injorantë që i bëhen përbindësh vëllait të tyre me pretekstin dhe zemërimin se ka bërë një vepër që nuk u pëlqen atyre. Për shkak të këtyre po shkatërrohen shumë gjëra në botë dhe veçanërisht në gjeografinë islame. Shumë prej vendeve myslimane po shkatërrohen në duart e armiqve që kanë hyrë nëpërmjet zbrazëtirave që kanë formuar disa prej organizatave viktimë nga aspekti shpirtëror. Le ta shtjellojmë edhe një herë Aliun (r.a.) dhe ngjarjen e famshme duke e hapur pak edhe më shumë:


Aliu (r.a.), e pati shtrirë për tokë kundërshtarin e tij politeist. Pikërisht në momentin kur do t’i ngulte shpatën, armiku e pështyu atë në fytyrë. Sa ofendim i rëndë ishte ajo pështymë për një fytyrë kaq të pastër! Veçanërisht në një betejë për jetë e vdekje. Kjo pështymë ishte si një shigjetë me helm që e plaste damarin e zemërimin dhe të urrejtjes pështymë ishte një shuplakë aq shumë e pistë, sa që mund ta çmendte edhe durimin. Por çudi! Aliu (r.a.), papritur e hodhi shpatën në tokë dhe nuk ia nguli armikut. Çudi! Një sjellje kaq e keqe që ia nxit



edhe më shumë zemërimin të gjithëve, atij ia shoi. Çudi! Çfarë ndodhi vallë që poseduesi i Dhulfikarit, i cili ishte rrufe në çdo luftë, këtë herë papritur u shndërrua në një re mëshire? Çudi! Një sjellje përçmuese që i ngushton kraharorët, ia zgjeroi kraharorin Aliut (r.a.). Në këtë mënyrë, ai hoqi dorë nga vrasja e armikut që e pati vënë nën këmbë. Edhe ai i mjeri, i cili u kthye përsëri në jetë pasi e pati humbur shpresën për të jetuar, u habit pa masë. Ai e pyeti Aliun (r.a.): *“O Ali! Përse hoqe dorë pikërisht në momentin kur do të më vrisje? Mos ke për qëllim të ma marrësh jetën pa shpatë?”*

Luani i Allahut, Aliu (r.a.), iu përgjigj: *“O ti që u ktheve përsëri në jetë! Dije se këtë Dhulfikar që e kam në dorë, e përdor vetëm me urdhrin e Allahut Teala. Ndërsa me urdhrin e idhullit që quhet nefsi nuk mund të lëviz as edhe një qime. Duart e mia e shkulën dhe e copëtuan derën madhështore në kalanë e Hajberit vetëm me urdhrin e Allahut. Ndërsa me urdhrin e idhullit nefsi, nuk mund të këpus qoftë edhe një gjethe. Fryma ime i copëton gurët dhe mallet e larta duke gjëmuar vetëm me urdhrin e Allahut të Madhëruar. Ndërsa me urdhrin e idhullit nefsi nuk mund të nxjerrë zë as sa fletët e mizës.”*

Domethënë, o njeri! Ty të pata shtrirë për tokë vetëm për Allahun dhe do të të vrisja vetëm për Allahun. Por ti më pështyve në fytyrë. Nefsin tim e vure ballë për ballë me nefsin tënd. Atëherë puna ndryshoi. Tashmë lufta u shndërrua në luftë për fitoren e nefsit. Ndërsa unë menjëherë ia ngula shejtanit heshtën *“eudhu”* dhe shpatën që do të të godisja ty, ia ngula idhullit nefsi. Siç kam bërë gjithmonë, edhe këtë herë veprova sipas urdhrin të Allahut Teala. Kështu që u përpoqa të merrja vetëm pëlqimin e Tij. Domethënë u përpoqa të bëhesha prej atyre fatlumëve që gjithmonë çlirojnë zemra me një pjekuri të cilën Allahu i Lartësuar e lavdëron kështu në Kuran: ***“Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe Xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e Toka dhe që është përgatitur për të devotshmit, të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit.”*** (Al Im-



Ti më hodhe ferra, ndërsa unë të dhashë trëndafila. Ti zgjodhe për mua zemërimin dhe ofendimin. Ndërsa unë preferova për ty faljen dhe mëshirën.

ran, 133-134) Për këtë arsye, ti e pe ligësinë të përshtatshme për mua, ndërsa unë pashë mirësinë të përshtatshme për ty. Ti më hodhe ferra, ndërsa unë të dhashë trëndafila. Ti zgjodhe për mua zemërimin dhe ofendimin. Ndërsa unë preferova për ty faljen dhe mëshirën.

Ti tentove të më përçmosh për të më zhytur në humbje, ndërsa unë u solla me një moral të lartë kundrejt teje. Ti dëshirove të më rrokullisje në zjarr, ndërsa unë dëshirova të të tërhiqja drejt xhenetit të Allahut Teala. Ti dëshirove të më njollosje për të më dhunuar, ndërsa unë e shtova dashurinë time ndaj mëshirës së pafundme për të të pastruar ty. Tani, o zemër e plagosur! Çfarë mendon nëse të them që të vish bashkë me mua te ajo dashuri, udhëzim dhe mëshirë? Zemra e burrit armik shpërtheu si lumenjtë prej këtyre fjalëve si perla që i dëgjoj nga morali i pashoq që e përjetoi dhe rrodhi drejt derës së dritës së udhëzimit. Dera e shenjtë u hap. Edhe ai hyri brenda pa u vonuar aspak. Ai nuk dinte çfarë të thoshte:

“O Ali! Nefsi im të paska njohur shumë gabim ngaqë të krahasoi ty me njerëzit e këqij. Diellin tënd nuk arrita ta shikoja për shkak të verbërisë sime. Ti më tregove diçka aq sublime, saqë m’u hapën edhe sytë, edhe zemra. Tashmë e shoh edhe diellin, edhe hënën. Ti u bërë dera e shpëtimit për mua. Në derën tënde hyra me dashuri. Sapo hyra, menjëherë arrita te qyteti fisnik i dijes së vërtetë dhe të pafundme. Pastaj e kuptova se qyteti i asaj dijeje të pashoqe është Muhamed Mustafai (a.s.). Tashmë edhe unë, pikërisht si ti, jam një i dashuruar që e kam lidhur zemrën me atë. Tashmë e kuptova se sulltani i pejgamberëve është një dritë e atillë, saqë yjet e pashoqe e të pafundme në qiell shkëlqejnë prej saj. Këtej e tutje, pjesa e jetës që më ka mbetur le të jetë kurban për atë! Ja çlirimi i zemrave! Ja Islami! Ja udhëzimi!

Për ta arritur një çlirim të tillë shpirtëror, është e qartë se duhet të jemi besimtarë të devotshëm, sepse zemrat nuk çlirohen me asnjë urrejtje, zemërim apo padrejtësi. Nisur nga ky këndvështrim, çdo zemër nuk e ka aftësinë për t’i çliruar zemrat, sepse

kjo aftësi është mirësi jo e një jete të devijuar, por e një jete mjaft të pastër. Domethënë, një zemër nuk arrin dot ta realizojë çlirimin shpirtëror në kuptim të vërtetë pa u bërë një pasqyrë e pastër muhamedane në të cilën shikon Zoti (xh.xh.). Ndoshta mund të mbledhë njerëz si ndonjë skuadër apo mund të formojë klientë si ndonjë qendër tregtare, por në kuptimin e vërtetë nuk mund të fitojë zemra, sepse të çlirosh zemra do të thotë që t’i bësh edhe ato pasqyra muhamedane dhe t’i çosh në një pjekuri të atillë, saqë mund t’ia shfaqësh Zotit (xh.xh.). Do të thotë që zemrat me gjemba t’i shndërrosh në trëndafila dhe zemra të xhenetit. Do të thotë që të këqijtë t’i bësh të mirë. Do të thotë që ligësinë ta shndërrosh në mirësi. Do të thotë që ta bësh qafirin besimtar, ta bësh hipokritin të sinqertë dhe ta bësh vrasësin gjallërues. Nisur nga kjo, çlirimi i zemrave kurrë nuk është mbledhje simpatizantësh me një qasje joshëse mashtruese e të përkohshme që bëhet duke i mbyllur sytë kundrejt gabimeve fatale të njerëzve, duke i lënë ligësitë e tyre ashtu siç janë pa tentuar për t’i rregulluar dhe duke mos nxjerrë zë ndaj devijimeve të tyre që mund t’u shkaktojnë tragjedi. Edhe formimi i masave të gjera nga metoda për t’i shtirë në dorë zemrat e tyre me të njëjtën qasje të ligë, nuk është çlirim shpirtëror. Kjo nuk është gjë tjetër përveçse pushtim i njerëzimit me aftësi djallëzore dhe një lloj tjetër i padrejtësisë.

Andaj, asnjëherë nuk duhet të harrojmë se një i pavendosur që nuk e mposht dot shejtanin asnjëherë nuk mund të fitojë ndonjë zemër. Një i shkujdesur që nuk mund ta mposhtë nefsin e tij asnjëherë nuk mund të çlirojë asnjë zemër. Një mjek apo një i sëmurë që nuk mund ta mposhtë mikrobin, asnjëherë nuk mund ta arrijë fitoren që quhet shërim. Për këtë arsye, çliruesit e vërtetë shpirtërorë para së gjithash e zbatuan Islamit vetë dhe ua mundësuan edhe të tjerëve zbatimin e tij. Ata u lidhën me gjithë shpirt ndaj Allahut Teala dhe të Dërguarit të Allahut (a.s.). Nisur nga kjo, i falën zemrat e tyre dhe çliruan zemrat e të tjerëve. Ja, ky ishte një çlirim i vërtetë. Ja, nga kjo e vërtetë lindën çlirime të mëdha e të qarta. Lindi Stambolli. Përgëzimet u shfaqën njëra pas tjetrës. Për këtë arsye, ata që kërkojnë përgëzim nga i Dërguari i Allahut (a.s.), në këtë botë dhe në botën tjetër, së pari duhet të dinë mirë se si t’ia japin zemrën atij. Edhe Islamit duhet ta zbatojnë në formën më të mirë duke çliruar zemra përgjate gjithë jetës. Lum për ata që arrijnë ta realizojnë këtë! Të bekuara qofshin përgëzimet për çlirime të reja të tyre!..

Marrëdhëniet religjion-shkencë në procesin e iluminizmit të shekullit të 18-të

Ahmet Meral

HISTORIA E SHKURTËR E BOTËS

As në të kaluarën dhe as në ditët e sotshme, religjioni dhe shkencë asnjëherë nuk kanë pasur kontradikta me njëra-tjetrën.

“Të pohosh se ecuria e historisë në të ardhme është e lidhur me vendimin që brezi i sotshëm do të japë në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet shkencës dhe religjionit, nuk konsiderohet ekzagjerim.” (A. N. Whitehead)

Mendimi i iluminizmit në shekullin e 18-të doli në pah si vazhdimi i një procesi që rrënjët i zgjaten deri te antikiteti Grek dhe më së shumti pati influencë në Francë. Bashkë me iluminizmin u plotësuan themelet teorike të zhvillimeve që u shfaqën në fushat e mendimit dhe shkencës. Në Greqinë e lashtë, katër-pesë shekuj para ardhjes së Isait (Jezu Krishtit), u hodhën themelet e mendimit dhe shkencave racionale, por ndërkohë që kishin filluar të harroheshin, shpëtuan nga zhdukja nëpërmjet dorës së civilizimit Islam. Arritjet e mendimit antik formuan kontakt me botën perëndimore në krahinat e Andaluzisë dhe Siçilisë me komentet dhe ndihmën e vyer të dijetarëve myslimanë dhe kështu lindi periudha e Rilindjes. Në këtë mënyrë, u hodhën hapa të rëndësishëm për të njohur botën dhe për të kuptuar ligjet funksionale të gjithësisë. Nga ana tjetër, Lëvizjet Reformatore caktuan pozitën e re të Kishës dhe u bënë lajmëtare të një civilizimi me fytyrë të kthyer nga kjo botë. Në këtë periudhë e cila mund të pranohet si “Iluminizmi i Hershëm”, shkencëtarët i hapën rrugën iluminizmit të madh duke marrë mbështetje pjesërisht edhe nga Kisha.

Koperniku (1473-1543), i cili ishte njëri prej shkencëtarëve influencues në formimin e shekullit të iluminizmit, argumentoi se “në gjithësi ka një sistem me në qendër Diellin dhe se Dielli nuk rrotullohet rreth Tokës, por se Toka rrotullohet rreth Diellit”. Në këtë mënyrë, e ndryshoi mendimin rreth astronomisë së vjetër e cila pranohej që nga Greqia e lashtë.

Galileo Galilei (1564-1642), i cili përparoi në rrugën që hapi Koperniku, vuri në pah gabimin e teorisë së vjetër që pranonte Kisha duke e vërtetuar se “Toka ishte e rrumbullakët” dhe doli kundër mendimit se toka ishte e sheshtë, gjë që bëri të gjykohej në gjykatën e inkuizicionit. Veçanërisht realizoi studime të ndryshme në fushën e fizikës dhe i shërbeu shkencës.

Duke nisur që nga fillimi i shekullit të 18-të, shumë filozofë të natyrës dolën për ta zbuluar natyrën,

në mënyrë që njerëzit të përfitonin prej saj. Natyra të cilën e ka krijuar Allahu Teala ishte një sistem i përsosur. Në lidhje me informimin rreth ligjeve të funksionimit të gjithësisë, studimet e shkencëtarëve erdhën duke u shtuar. Shkencëtari me origjinë angleze Isaac Newton (1643-1727), i cili ishte një njeri fetar dhe i cili konsiderohej si shkencëtari më i madh i historisë së botës nga disa njerëz, në pjesën më të madhe të jetës e ka lodhur kokën për teologjinë si një njeri që përpiquej me mistikën dhe numrat. Veçanërisht studimet e tij në fushën e matematikës dhe fizikës ishin prej atyre që hapën një periudhë të re. Shpjegimet e tij në lidhje me sistemin e gjithësisë, për shembull, formula e famshme që shpjegon teorinë e forcës tërheqëse të tokës, pati një fuqi integruese madhështore. Kjo teori, e cila hyri në një periudhë shumë prodhuese përgjatë dy shekujsh, u hapi rrugën kërkimeve të fizikës. Newtoni, si një njeri që nxori në pah ligjet e përgjithshme – në një masë të paarritshme për dikë tjetër – zhvilloi një model veprimi shkencor që edhe sot është i vlefshëm. Me veprën e titulluar «Philosophiae Naturalis Principia Mathematica» dhe e cila u botua më 1687, hodhi themelin e mekanikës klasike. Kjo veprë pranohet si njëra prej veprave shkencore më të rëndësishme brenda këtij procesi historik. Përveç të tjerash, Newtoni i dha shkencës llogaritjet diferenciale dhe integrale. Ky shkencëtar që njihet me fetarinë e tij, kujtohet si njëri prej tre matematicientëve më të mëdhenj që janë njohur.

Mendimi se “dija e vërtetë mund të arrihet me përdorimin e mendjes” dhe i cili quhet racionalizëm në Periudhën e Iluminizmit, është pranuar si bazë.

Filozofi gjerman Immanuel Kanti (1724-1804), i cili ishte emri më i rëndësishëm i rrymës racionaliste, e shpreh kështu këndvështrimin e shkencëtarëve të asaj periudhe ndaj Iluminizmit:

“Iluminizmi është shpëtimi i njeriut nga tutela shkaktar i së cilës është vetë ai. Tutelë do të thotë që njeriu nuk mund ta përdorë mendjen e tij pa e udhëhequr të tjerët. Nëse shkaku i kësaj tutele nuk është në mungesën e racionale, por në mungesën

e vendosmërisë dhe guximit të njeriut për përdorimin e menaxhimit të të tjerëve, atëherë, shkaku i kësaj tutele është te vetë njeriu.”

Në këtë periudhë eksperimentet dhe vëzhgimet fituan rëndësi dhe në shkencat e natyrës u arritën zhvillime të mëdha.

Francezi Rene Descartes (1596-1650), pohoi se shkencat mund ta arrijnë të dhënë bazë vetëm nëpërmjet matematikës. Në sajë të kësaj zhvilloi analitikën dhe gjeometrinë.

Influenca e iluminizmit reflektoi edhe te shkencat sociale, përvetësoi një mendim racional dhe në librat e letërsisë u shtjelluan çështje të shumta në lidhje me shoqërinë. Në këtë fushë, veçanërisht mendimtarët si Jean-Jacques Rousseau (1712-1778),

në shkrimet e tyre u dolën kundër mendimeve shtypëse dhe ndihmuan në lindjen dhe zhvillimin e demokracisë. Kjo situatë nxiti kryengritjen ndaj autoriteteve dhe themeloi bazën e lëvizjeve popullore kundër udhëheqjeve shtypëse. Koncepti i të drejtave të njeriut që intelektualët dhe iluministët sollën në rend, formoi dinamikën kryesore të lëvizjeve politike.

Në shekullin e iluminizmit, siç kishte zhvillime në fushën e shkencës dhe të letërsisë, u përjetuan zhvillime edhe në fushën e arteve të bukura.

Veçanërisht në fushën e muzikës dolën kompozitorë të famshëm si Mozarti (1756-1791) dhe Johann Sebastian Bach (1685-1750) të cilët ishin kompozitorët më influencues të muzikës klasike perëndimore.

Edhe njëra prej zhvillimeve në cilësinë e vazhdimt të Lëvizjeve Reformatore është mendimi dhe këndvështrimi i përhapur se Kisha do të bënte ndërhyrje te shoqëria në një mënyrë më njerëzore.

MARRËDHËNIET RELIGJION-SHKENCË

“Religjioni dhe shkencat janë dy lumenj që e gjallërojnë jetën e njeriut.” Nëse vendosen kundër njëra-tjetrës, jo vetëm që nuk kanë kuptim, por është një mendim i rrezikshëm që e zvarrit njerëzimin drejt humbjes së sigurt. Shkencat janë një disiplinë e cila synon të gjejë të vërtetat në lidhje me gjithë-

*“Religjioni
dhe shkencat janë dy lumenj
që e gjallërojnë jetën e njeriut.”
Nëse vendosen kundër njëra-
tjetrës, jo vetëm që nuk kanë
kuptim, por është një mendim
i rrezikshëm që e zvarrit
njerëzimin drejt humbjes
së sigurt.*

sinë në të cilën jetojmë duke i studiuar në mënyrë sistematike rezultatet e eksperimenteve.

Detyra e shkencës është që të na hapë rrugën e zhvillimeve të cilat na lehtësojnë jetën tonë. Për këtë arsye, shkenca merr në shqyrtim ligjet e funksionimit të gjithësisë të cilat Allahu i ka vendosur mbi tokë. Në këto rregulla që quhen “Sunnetullah” nuk ka ndryshim dhe elasticitet. Nëse njerëzit nuk i marrin parasysh këto rregulla duke filluar nga më i thjeshti e duke arritur te më i vështiri, nuk mund të përfitojnë mjaftueshëm nga mirësitë e tokës dhe ngelin në vështirësi, skamje, ngatërtime, konfuzione dhe trazira. Për shembull, nëse njerëzit i ndërtojnë shtëpitë e tyre me materiale të dobëta, do të thotë se u kanë hapur rrugë fatkeqësive. Nëse drithërat, zarzavatet dhe perimet nuk mbillen dhe nuk mblidhen në kohën e tyre, përjetoher mungesa e ushqimit dhe zia e bukës. Nëse shtëpitë ndërtohen në shtretërit e lumenjve, rreziku për t’u shkatërruar nga vërshimet e ujit është i pashmangshëm. Shkenca ia ka dalë mbanë të prodhojë energji nga rrezet e diellit dhe nga rrjedha e lëvizjes së ujërave duke i studiuar me vëmendje ligjet e funksionimit të gjithësisë. Në sajë të shkencës, duke u studiuar rregullat e natyrës, janë shpikur dhe vazhdojnë të shpikën një mori gjërash që na e shtojnë komfortin e jetës.

Ndërsa religjioni cakton bazat që ua mundësojnë njerëzve t’i mbështesin marrëdhëniet ndërmjet tyre në një themel të fortë. Mbi të gjitha, religjionet qiellore dhe Islami, caktojnë marrëdhëniet ndërmjet njerëzve dhe marrëdhëniet njeri-objekt pa i bërë shirk Krijuesit. Ato nxjerrin në plan të parë pasurinë e botës së brendshme të njerëzve dhe ibadetin kundër dobësive të tyre. Gjithashtu i ftojnë njerëzit kundër padrejtësisë, tiranisë e barbarizmit dhe për t’i zbatuar dispozitat që ka vendosur Allahu. As në të kaluarën dhe as në kohët e sotshme, religjioni dhe shkenca nuk kanë pasur kontradikta me njëra-tjetrën.

Në asnjë tekst fetar nuk ka ndonjë këshillë në formën: “Mos i studioni ligjet e natyrës! Asnjëherë mos zbuloni shpikje që na lehtësojnë jetën!”

Edhe nga klerikët nuk është bërë ndonjë qortim serioz në formën: “Përse i studioni ligjet e funksionimit të gjithësisë? Përse jepni përpjekje që do të na lehtësojnë jetën tonë?” Edhe shkencëtarët nuk kanë bërë ndonjë ndërhyrje të madhe në fushën e fesë dhe nuk kanë nxjerr ligje në këtë fushë duke u kapluar nga arroganca e zbulimeve që kanë bërë.

Mirë, por çfarë mund të themi për kontradiktat religjion-shkencë, për të cilat po flasim, në procesin historik, veçanërisht në iluminizmin e shekullit të 18-të dhe në periudhën racionale pas tij? Si arriti të bëhej ky gabim i përhapur dhe i pabazë dhe të zërë vend në fushën e shkencës?

Kur ta studiojmë me vëmendje, shohim qartë se tendenca për ta shfaqur religjionin dhe shkencën si alternativa ndaj njëra-tjetrës buron nga reflekset institucionale politike, fetare dhe kulturore që i përkasin kësaj periudhe.

Kontradiktat dhe përplasjet i përkasin fushës së politikës. Pallet politike gjithmonë janë përpjekur për të formuar epërsi mbi kundërshtarët e tyre duke e treguar veten se nganjëherë veprojnë me religjionin dhe nganjëherë me shkencën. Padyshim se në çdo periudhë, siç ka pasur klerikë që nuk janë zhveshur nga fusha e influencës së pasionit për politikë dhe që mbartnin dobësi morale, kanë dalë edhe shkencëtarë që mbartnin të njëjtin pasion dhe që e kanë shndërruar shkencën në një idhull. Për shkak të kësaj kanë marrë përsipër rolin e të qenit gurë shahu të politikanëve që për interesat e tyre çdo gjë e konsiderojnë të lejuar.

Përsëri kjo periudhë, sikundër asaj që dëshirojnë ta shfaqin disa shkrimtarë pozitivistë, nuk është një periudhë dramatike që klerikët i kanë dënuar mizorisht shkencëtarët. Giordano Bruno për të cilin po punohet të shfaqet si kurban i parë i luftës religjion-shkencë, nuk ka qenë një shkencëtar, por ka qenë një klerik. Fjalët e mëposhtme tregojnë se çfarë personaliteti të fortë idealist ka pasur ai:

Përsëri kjo periudhë, sikundër asaj që dëshirojnë ta shfaqin disa shkrimtarë pozitivistë, nuk është një periudhë dramatike që klerikët i kanë dënuar mizorisht shkencëtarët. Giordano Bruno për të cilin po punohet të shfaqet si kurban i parë i luftës religjion-shkencë, nuk ka qenë një shkencëtar, por ka qenë një klerik. Fjalët e mëposhtme tregojnë se çfarë personaliteti të fortë idealist ka pasur ai:

“Zoti i përdor njerëzit e mirë mbi tokë për ta bërë sundues vullnetin e Tij. Ndërsa njerëzit e këqij mbi tokë përdorin Zotin për ta bërë sundues vullnetin e tyre.”

“Zoti i përdor njerëzit e mirë mbi tokë për ta bërë sundues vullnetin e Tij. Ndërsa njerëzit e këqij mbi tokë përdorin Zotin për ta bërë sundues vullnetin e tyre.”

EJA në shpëtim!..

As. doç. dr. Mustafa Xhanllë

*“...Ai që do të gëzohet
më së shumti me ndërmjetësimin
tim në Ditën e Kiametit
është ai që thotë me gjithë zemër
apo me gjithë shpirt:
“La ilahe il-lallah / nuk ka zot
tjetër përveç Allahut.”
(Buhari, Ilm, 33.)*

Esenca dhe përmbledhja e të gjitha feve hyjnore dhe e fesë së fundit, Islamit është shprehja: “La ilahe il-lallah!” “La ilahe il-lallah” është ekuilibri dhe qendra kryesore e jetës së besimtarit në këtë botë. Ndërsa në ahiret, do të jetë shkaku i lumturisë së tij. Në shqip kjo fjalë përkthehet: “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut.” Domethënë, nuk ka asnjë qenie

tjetër që meriton të adhurohet përveç Atij dhe që posedon fuqinë e vërtetë e absolute. Ai është forca absolute dhe Zoti absolut.

“La ilahe il-lallah” është një thirrje e fuqishme që jehon se Allahu, (xh.sh.), është Krijuesi i çdo gjëje dhe se Ai ka fuqi për çdo gjë.

“La ilahe il-lallah” është komponenti kryesor që dominon në të ngrënët, në të pirët, në veshjen, në jetesën sociale, në frymëmarrjen etj. të besimtarit. Apo thënë ndryshe, është komponenti kryesor që dominon në të gjithë jetën e besimtarit. Zemra e umetit rreh me brohoritjet: “La ilahe il-lallah!”

“La ilahe il-lallah” është një vulë që Allahu i Madhëruar e ka vendosur ndërmjet tokës dhe qiellit, pra, që ia ka vendosur të gjithë universit. Gjethet shushurijnë me këtë fjalë dhe zogjtë i rrahin krahët me ngashënjimin e kësaj fjale. Vetëtimat nga retë sikur shkrepin me këtë fjalë dhe thonë: “La ilahe il-lallah!” “La ilahe il-lallah!”

“La ilahe il-lallah” është një thirrje. Është një thirrje që i drejtohet njerëzimit. Në këtë shprehje të shenjtë sikur jehon kuptimi: “O njerëzi! Thuaj:

“La ilahe il-lallah!” – dhe shpëto!” Për këtë arsye, shpëtimi i njerëzimit është në fjalën: “La ilahe il-lallah!”

“La ilahe il-lallah” është dorëzim dhe nënshtrim ndaj Allahut Teala. Kjo do të thotë që t’i nënshtroni Allahut Teala sikur e shohim atë në çdo kohë dhe në çdo vend. Do të thotë që të jemi bashkë me Atë në çdo aspekt të jetës. T’i dorëzohesh Atij, në të vërtetë do të thotë të gjallërohesh apo të gësh jetë.

“La ilahe il-lallah” është pastrim. Pra, ta pranosh Allahun si të pastër nga çdo lloj mangësie dhe ta mbash veçmas çdo gjëje që është krijuar.

“La ilahe il-lallah” është kulmi i besimit. Në një hadith fisnik që transmetohet nga Ebu Hurejra (r.a.), i Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë: *“Besimi është shtatëdhjetë e disa pjesë. Më e larta prej tyre është fjala: “La ilahe il-lallah!”* (Nesai, Iman, 16.)

“La ilahe il-lallah” është ndërmjetësim. I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, ka premtuar se ndërmjetësimi i tij do të jetë për ata që janë të vetëdijshëm për fjalën “La ilahe il-lallah!” (Muslim, Iman, 316.)

Me fjalën “La ilahe il-lallah” fitohet xheneti. Pejgamberi ynë i dashur (a.s.), është shprehur se ai që e pranon Allahun për Zot dhe që lidhet me gjithë shpirt me Të, e meriton xhenetin dhe se xheneti bëhet vaxhib për atë njeri. (Muslim, Imare, 116.)

Madje një herë kur ishte bashkë me shokët e tij dhe bëri dhikrin: “La ilahe il-lallah!”, e falënderoi Zotin (xh.xh.), në këtë mënyrë: “Elhamdulil-lah! O Zot, Ti më ke dërguar mua me këtë fjali. Atë më ke urdhëruar (ta them dhe të veproji sipas saj). Ndërsa në shkëmbim të kësaj ke premtuar xhenetin. Ti gjithmonë e mban premtimin!” Pasi e falënderoi Zotin (xh.sh.), me këto fjalë, u kthye nga sahabët e tij dhe u tha:

“Përgëzime! Patjetër që Allahu, (xh.sh.), ju ka fa-

lur.” (Ahmed ibn Hanbel, IV, 124.)

“La ilahe il-lallah” e bën haram xhehenemin, sepse, siç është shprehur edhe i Dërguari i Allahut, (a.s.): *“Kush dëshmon duke e pranuar me zemër se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, Allahu ia bën haram xhehenimin atij.”* (Buhari, Ilm, 49.)


Përsëri i Dërguari i Allahut (a.s.), na njofton se një besimtar që thotë: “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!” – duke e besuar me gjithë zemër, nuk do të ndëshkohet në xhehenem. (Ibn Maxhe, Zuhd, 35.)

“La ilahe il-lallah” është civilizim. Në esencën e civilizimit që të gjithë pejgamberët, duke filluar nga Ademi (a.s.), e deri te Muhamed Mustafai (a.s.), gjendet fjala “La ilahe il-lallah!” Nisur nga ky aspekt, majaja esenciale e brumit të civilizimit Islam është tevhidi, sepse pa unitet nuk mund të ndërtohet asnjë civilizim.

“La ilahe il-lallah” është dëlirje. Kjo shprehje është dëlirje e zemrës... Ajo e pastron zemrën nga çdo lloj papastërtie, ndryshku, mendimi të papastër, pohimi për të qenë zot dhe gjëra të tjera të ngjashme me këto. Për këtë arsye, këtë fjalë fisnike duhet ta kuptojmë mirë dhe ta zbatojmë. Në fillim të kësaj fjale të bekuar ka mospranim. Domethënë, në fillim thua: “La ilahe / nuk ka zot!” Pra, i nxjerr nga zemra idhujt si epshi, paraja, pozita etj., domethënë, çdo gjë që mund të adhurohet përveç Allahut. Pasi saraji i zemrës të jetë gati për Padishahun, e pret Zotin duke thënë: “Il-lallah / përveç Allahut!” – dhe shprehesh:

“Urdhëro Zoti im! Zembrën e kam sjellë në një gjendje që mund t’i pranojë urdhrat e Tua! Hyr në zembrën time dhe shfaqju asaj!” Tashmë në të gjithë genien tënde ka një zë të vetëm dhe jehues: “La ilahe il-lallah!..” “La ilahe il-lallah!..”

“La ilahe il-lallah” është unitet. Ajo është gjetje



e fuqisë dhe bashkim në një. Për këtë arsye, këtë shprehje e kanë emërtuar “fjala e tevhidit”, që do të thotë bashkuese në një. “La ilahe il-lallah” bashkon dhe unifikon. Besimtarët bashkohen dhe bëhen një rreth të fshehtave të tevhidit. Sikur i gjithë universi bashkohet e bëhet një dhe thotë me një zemër: “La ilahe il-lallah!..” “La ilahe il-lallah!..”

“La ilahe il-lallah” është sakrificë. Domethënë, të sakrifkosh pasurinë, fëmijët dhe jetën për “La ilahe il-lallah!” Pikërisht si Ebu Bekri (r.a.), i cili e flijoi të gjithë pasurinë e tij në rrugë të Allahut Teala. Pikërisht si Ibrahim (a.s.), që ia vendosi thikën në fyt birit të tij Ismailit (a.s.), me një nënshtrim të plotë kundrejt Allahut të Lartësuar...

“La ilahe il-lallah” është kauzë. Domethënë, që të deklarosh dhe të shpallësh në sipërfaqen e tokës se nuk ka zot tjetër përveç Allahut Teala. Këtë e quajmë “Ilau Kelimetullah”, sepse “La ilahe il-lallah” është “kelimetullah”. Gjyshërit tanë kishin një mision: Ilau kelimetullah, domethënë, përhapjen e fjalës “La ilahe il-lallah” te të gjithë njerëzit. Ata e thanë dhe e përjetuan këtë kudo që shkuan. Kjo në një kuptim ishte thirrje ndaj njerëzimit për shpëtim. Dhe kjo thirrje gjeti njerëz që t’i përgjigjeshin. Ndikimin që nuk e dha shpata, e realizoi “La ilahe il-lallah!” Si rezultat, njerëzit hynë më pëlqimin e tyre në Islam.

“La ilahe il-lallah” është fjalë e bukur. Në Kuranin Fisnik “La ilahe il-lallah” cilësohet si fjalë e bukur. (Ibrahim, 24) Domethënë, fjalë e bukur dhe e këndshme... Nisur nga ky aspekt, “La ilahe il-lallah” tregon se Ai është i bukur absolut.

“La ilahe il-lallah” është vepra më e virtytshme. Krenaria e Gjithësisësi, i Dërguari i Allahut (a.s.), na ka njoftuar se asnjë vepër nuk mund ta kalojë fjalën “La ilahe il-lallah” nga aspekti i virtytshmërisë. (Ibn Maxhe, Edeb, 54.)

“La ilahe il-lallah” është dhikër. I Dërguari i

Allahut (a.s.), na njofton se dhikri më i mirë është fjala “La ilahe il-lallah!” (Ibn Maxhe, Edeb, 55.) Malet dhe gurët dridhen me madhështinë e këtij dhikri. Ndërsa oqeanet e bëjnë këtë dhikër dallgë-dallgë duke thënë: “La ilahe il-lallah!..” “La ilahe il-lallah!..”

“La ilahe il-lallah” të bën të përsosur. Sa më shumë të thuhet “La ilahe il-lallah” zemrat e papjekura, me lejen e Allahut, fillojnë të piqen me mirësinë dhe begatinë e këtij dhikri. “La ilahe il-lallah” është një çelës shpëtimi në rrugën e të dashuruarve. I dashuruari e përkujton me këtë dhikër të Dashurin e tij dhe me zemër të përvëlur thotë: “La ilahe il-lallah!..” “La ilahe il-lallah!..” Në këtë mënyrë, i dashuruari vazhdon e digjet pa reshtur.

A e ndan Allahu, (xh.sh.), ndonjëherë të Dashurin e Tij, Muhamed Mustafanë (a.s.), nga vetja e Tij? Për këtë arsye, plotësuesja e fjalës: “La ilahe il-lallah!” – është shprehja: “Muhammedun Resullullah!”

Tevhidi plotësohet me Muhamed Mustafanë (a.s.). Edhe nëse shprehja: “Muhammedun Resullullah!” – nuk thuhet pas fjalës: “La ilahe il-lallah!”, ajo nënkuptohet.

Nëse e përmbledhim të gjithë atë që thamë, mund të shprehemi se fjala: “La ilahe il-lallah!” – është një shprehje aq sublime, saqë edhe poeti shprehet:

“La ilahe il-lallah!”,
I bën rrugë zemrat,
I bën pluhur malet dhe gurët,
I bën robër sulltanët...

Allahu Teala mos na ndaftë nga fjala e tevhidit as në këtë botë dhe as në botën tjetër! Amin!...

“La ilahe il-lallah!..” “La ilahe il-lallah!..” “La ilahe il-lallah!..”



Xhafer Durmush

Të falënderojmë për çdo mirësi

Në tregimin rreth Sulejmanit (a.s.), të cilin e gjejmë ndërmjet ajeteve 16-44 të sures en-Neml, ekspozohen para nesh, skena nga të cilat mund të nxirren shumë mësim. Në kohën kur po bëheshin përgatitjet për të ftuar në Islam mbretëreshën e Sebes, na tërheq vëmendjen një fjali që rrjedh prej gjuhës së Sulejmanit (a.s.). Ajetet ku tregohen këto skena, në mënyrë të përmbledhur janë:

Sulejmani (a.s.), me lejen e Allahut, mbizotëron erërat dhe ka ushtri të përbëra prej xhindëve, njerëzve dhe zogjve. Ai fton në Islam mbretëreshën e Sebes, në lidhje me të cilën u informua nga një zog i quajtur Hud-hud. Për këtë arsye, filluan të vijnë e shkojnë delegacione ndërmjet dy sunduesve. Sulejmani (a.s.), dëshironte që ta priste delegacionin e mbretëreshës së Sebes, me një mrekulli që do t'i linte ata të mahnitur, pa pasur mundësi të sjellin diçka të ngjashme me të. Prandaj, ai mendoi të marrë fronin e mbretëreshës. Kur pyeti ushtarët e tij, se kush mund ta kryente këtë punë të jashtëzakonshme, punën e mori përsipër një prej ushtarëve, i cili i premtoi se do ta sjellë atë në një kohë të shkurtër, sa hap e mbyll sytë ose në një kohë edhe më të shkurtër.

Dëshira e Sulejmanit (a.s.), u plotësua pa dalë ende urdhri nga goja e tij. Për këtë arsye, kur e pa fronin para vetes në një kohë të shkurtër sa hap e mbyll sytë, duke falënderuar për këtë mirësi të Allahut, shprehet:

“...Kur (Sulejmani) e pa të vendosur para tij, tha: “Kjo është nga dhuntitë e Zotit tim, për të më sprovuar a jam mirënjohës apo mohues. Kush falënderon, e bën për të mirën e vet, e kush mohon, (ta dijë se) Zoti im është i Vetëmjaftueshëm dhe Bujar.” (Neml, 40)

Sipas Katades (r.a.), kur e ngriti kokën nga sexhdeja, Sulejmani (a.s.), tha: *“Qoftë i falënderuar Allahu, i Cili ka krijuar njerëz të tillë prej të afërmeve të mi, që kur luten u pranohet”*.

Është me vend, të qëndrojmë pak mbi fjalën që ka

thënë Sulejmani (a.s.), kur iu dha kjo mirësi, sepse qëndrimi i tij, është më i rëndësishëm se mirësia që iu dha atij. Kjo tregon se syri i tij nuk u qorrua përballë kësaj mirësie të jashtëzakonshme dhe zemra e tij nuk rrëshqiti nga mahnitja. Ai nuk u fokusua tek mirësia, por tek Ai që ia dha dhe u shpreh, se ishte duke u sprovuar me atë mirësi. Ky fakt, është me të vërtetë i rëndësishëm dhe ia vlen të mendohet rreth tij. Kjo, sepse shembulli që japin peygamberët me sjelljet e tyre për njerëzimin, dalin në pah veçanërisht kur bëhet fjalë për ekstremizma, qofshin ato në teprime apo në lëshime. Ata janë bërë shembull i përgjeshëm për njerëzimin, kur bëhet fjalë për durimin në skamje dhe pjekurinë në kamje.

Sekreti që e bën fjalën e Sulejmanit (a.s.), shembull për njerëzimin, është fakti se kur ai u shpërblye me një mirësi të pashoqe, në radhë të parë e pengoi egon e vet, e cila ka prirjen t'i atribuojë vetes diçka prej kësaj, pastaj pranon se me këtë mirësi po sprovohet dhe na tërheq vëmendjen se për këtë, duhet të biesh menjëherë në sexhden e falënderimit, duke thënë: **“Kjo është nga dhuntitë e Zotit tim, për të më sprovuar a jam mirënjohës apo mohues”**.

Nga shembulli i kësaj fjalie që na është transmetuar me gojën e Sulejmanit (a.s.), mund të kuptojmë: Besimi i vërtetë, vjen prej mbajtjes gjithmonë gjallë të vetëdijes së sprovës dhe fokusimit në kërkimin e kënaqësisë së Allahut në çfarëdolloj situatë. Prandaj, gjithmonë duhet ruajtur rruga e drejtë, pavarësisht se ngjarjet janë mirësi apo vështirësi për ne. Këto pra duhet të jenë edhe

disa nga fjalitë e qarta që e përkufizojnë myslimanin...

* * *

Në fjalor, fjala mirësi; ka kuptimin e çdo gjëje që i siguron njeriut një jetë të mirë, paqe e rregull. Ndërsa falënderim; shpreh mirënjohjen ndaj Allahut për mirësitë që ka dhënë.

Atëherë, falënderim; është reagimi i natyrshëm i myslimanit ndaj zhvillimit të ngjarjeve dhe përsosmëria e tij, vihet re vetëm tek besimtarët e devotshëm, të cilët nuk e neglizhojnë atë as në skamje dhe as në bollëk; edhe pse mund të pësojnë fatkeqësi, detajet e të cilave nuk i kupton gjithkush, gjendja e tyre nuk ndryshon. Për ta, falënderimi është një ëmbëlsi, shija e së cilës është e pandryshueshme, edhe nëse ndryshon gjendja dhe burimi i së cilës është kënaqësia dhe meditimi.

Njeriu duhet të dëshirojë atë që Allahu Teala e jep me mirësinë e bujarinë e Tij dhe që është më e mirë për të, sepse edhe e pakta që nuk e plotëson nevojën, edhe e shumta që është më tepër se nevoja, kanë vështirësitë e veta. E megjithatë, mund të themi, se ruajtja e rrugës së drejtë në bollëk, kërkon një vullnet më të fortë dhe një përpjekje më të madhe... Edhe Omeri (r.a.), i cili e ndante saktë, të mirën nga e keqja, ka thënë: “Duruam kur u sprovuam me vështirësi, por nuk duruam dot kur u sprovuam me bollëk.” Pra, nëse Omeri (r.a.), ka shprehur frikën e tij në këtë çështje, atëherë ne çfarë duhet të bëjmë?

Njeriu i ditëve tona nuk duhet të harrojë, se sado që të përparojnë zhvillimet teknologjike, njeriu përsëri është i dënuar të ndikohet nga ndryshimi i disa elementeve. Për këtë arsye, ai duhet të ketë gjithmonë parasysh dobësinë e vet dhe nuk duhet të rehatohet nga fakti se ka vite që po sprovohet me bollëk. Po ashtu, nuk duhet të harrojë, se Allahu i Plotfuqishëm që e sprovon me bollëk, nëse dëshiron mund ta sprovojë edhe me skamje.

Allahu Teala i do shumë robërit e Tij. Ai dëshiron që besimtarë të cilët Ai i ka quajtur “robërit e mi”, ta mbajnë gjithmonë të gjallë e të ngrohtë lidhjen me Të. Kur të sprovohemi me skamje dhe vështirësi, të kërkojmë strehim tek Madhështia e Tij, ndërsa kur të arrijmë mirësi dhe bollëk, të falënderojmë sa më shumë...

Omeri (r.a.), ka thënë: “Nëse Allahu ia shton të mirat e kësaj bote dikujt dhe ai nuk e kupton se kjo është një provë, do të thotë, se atë njeri e ka mashtruar mendja e vet”. Egoja e njeriut është e prirë që për fatkeqësitë që i bien, fajin t’ua hedhë të tjerëve, ndërsa mirësitë t’ia atribuon aftësive të saj. Edukimi shpirtëror që përfitohet nga skamja dhe vështirësitë, është i vështirë të përfitohet kur gjendesh në mes të bollëkut dhe mirësive. Nisur nga kjo, besimtari duhet ta mbajë gjithmonë të gjallë vetëdijen, se vetëm Ai është që jep dhe që merr; Atë që vjen prej Tij, duhet ta konsiderojë mirësi dhe të falënderojë për të.

Lexo-Mendo

Islami: Receta e paqes

“O besimtarë! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë! Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut ndaj jush, sepse kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e në saje të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër.” (Ali Imran, 102-103)

Ky ajet fisnik, na bën të mendojmë në këtë mënyrë: Çfarë është devotshmëria, si duhet të jetë e vërteta e saj, deri ku është Islami? Cilat janë përfundimet pozitive të tij në marrëdhëniet njerëzore dhe cilat mund të jenë pasojat e mundshme të mosrespektimit të Islamit?

Nëse devotshmëria është ruajtja nga ndalesat e Allahut me frikën se mos po shkaktoj dënimin e Tij, kjo nuk duhet të mbetet vetëm në fjalë, por nga këto ndalesa duhet të ruhesh me përpikëri. Kujdesi ndaj kritereve të Islamit, nuk duhet të vazhdohet vetëm për një kohë të shkurtër, por deri kur të dorëzohet amaneti tek Allahu.

Mirësia që përgëzon ajeti fisnik dhe në sajë të së cilës shoqëria do të bashkohet në ndjenjat e vëllazërisë, është Islami; është futja e ndjenjës së devotshmërisë në zemra. Kjo, sepse Islami i pajton shoqëritë të cilat ushqejnë urrejtje ndaj njëra-tjetrës deri në gradën e “armiqësisë” dhe i bën ato të ngrihen në gradën e “vëllazërisë”. Asnjë besimtar që ia ka frikën Allahut, nuk përfshihet në ndonjë organizim që do të prishë ndjenjat e vëllazërisë në shoqëri. Dhe ekzistenca e myslimanëve që e kanë frikë Allahun ashtu siç duhet, është burimi i mirësisë dhe ilaçi kundër helmit të të këqijave. Mjafton që besimi dhe frika ndaj Allahut të ketë zënë vend në zemra.





Të besosh

Ahmet Zijlan

Besimi është koka e çdo gjëje. Kështu është edhe në adhurim, edhe në biznes, edhe në arsim, edhe në gjërat e tjera të ngjashme me këto. Nëse njeriu ka ndonjë problem në besim, veprat që bën as që shikohen... Sepse ato nuk shprehin ndonjë kuptim dhe nuk kanë ndonjë dobi. Ai që nuk beson, në fakt edhe nuk mund të veprojë. Edhe nëse vepron, vepron duke hezituar dhe shkatërrohet që në problemin më të vogël me të cilin përballet. Prandaj, njeriu në fillim duhet të besojë vetë. Në fillim duhet të besojë vetë se do t'ia dalë mbanë, se do ta bëjë dhe se do ta arrijë qëllimin.

Në Kuranin Fisnik ka dy ajete që i lexojmë çdo ditë pas namazit të jacisë. Ato janë dhurata e Miraxhit... Pra, janë dy ajetet e fundit të sures Bekare. Si fillojnë ato: "Amene'rr-Rrasulu... Pejgamberi besoi." Në fillim beson i Dërguari i Allahut (a.s.). Pra, i beson mesazhit të tij, detyrës së tij dhe se do t'u sjellë njerëzve e shoqërive lumturinë... Beson se do t'i japë fund xhahilijetit, do t'i shkatërrojë idhujt dhe se do të ndërtojë civilizimin e virtyteve...

Këtu ka një mësim të mirë për të gjithë ata që fillojnë ndonjë punë të dobishme në këtë botë. Askush nuk duhet të thotë: "Të më besojë dikush dhe të më mbështesë, në mënyrë që edhe unë t'ia dal mbanë." Jo, jo, së pari duhet të besosh ti.

I Dërguari i Allahut (a.s.), nga njëra anë ishte një sipërmarrës. Ai hodhi hapin për ta ndërruar gjendjen e një shoqërie e cila kishte vite që jetonte në xhahilijet/injorancë. Ai e kishte të plotë edhe mbështetjen te Allahu, edhe besimin ndaj vetes. Me lejen e Allahut Teala e arriti suksesin për 23 vjet. Siç e pranoi thirrjen e tij i gjithë gadishulli arabik, edhe krahinat e gjera u njoftuan për mesazhin e Islamit. Prandaj është shumë e rëndësishme që njeriu t'i besojë pikërisht vetes së tij, por edhe liderët e kauzave të mëdha dhe sipërmarrësve të mëdhenj kanë nevojë për një kuadër që i mbështesin dhe u besojnë. Ata janë ndihmësit më të mëdhenj dhe burimet e moralit.

Kur i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, mori shpalljen e parë, shkoi në shtëpinë e tij duke u dridhur nga madhështia e asaj që kishte përjetuar. Ai një herë digjej nga temperatura dhe një herë kishte të ftohtë sikur ta

kishte kapur sëmundja e malaries. Kur Hatixhja e pyeti: “Çfarë të ka ndodhur?” – i Dërguari i Allahut (a.s.), ia tregoi të gjitha ato që kishte përjetuar. Pastaj i tregoi rreth madhësisë dhe vështirësisë së detyrës për të cilën ishte zgjedhur. Ajo, nëna jonë e madhe, i tha: “Përse shqetësohesh?” Ai ia ktheu: “Kush do të më besojë mua?” Hatixhja i tha: “Të besoj unë, o i Dërguari i Allahut!”

Ja, mbështetja më e madhe është mbështetja që të vjen nga shtëpia. Mbështetja që të vjen nga bashkëshortja. Mbështetja që të vjen nga njeriu më i afërt. Pa mendoni një herë për një bashkëshorte që i thotë burrit të saj: “Mos vallë je i çmendur? Përse merresh ti me këto gjëra? Mos do të na hapësh telashe?” Ky do të ishte një shkatërrim morali shumë i madh që në hapin e parë. Për këtë arsye, kanë thënë: “Pas çdo burri të suksesshëm ka një grua.”

Të besosh është shumë e rëndësishme. Besimi dhe besnikëria e njerëzve, të cilët ecin drejt një ideali, ndaj liderëve të tyre janë shumë të rëndësishëm. I Dërguari i Allahut, (a.s.), e formoi këtë kuadër në periudhën e Mekës. Allahu i Madhëruar atë kohë i dhuroi atij kuadri edhe ngjarjen e miraxhit, në mënyrë që t’i forcohej besimi. Domethënë, miraxhi ishte një nderim për të Dërguarin e Allahut (a.s.), por ishte edhe një sprovë e madhe për myslimanët e parë. Politeistët filluan të talleshin duke thënë:

“A e keni dëgjuar se çfarë ka thënë ai profeti juaj?! Ai paska shkuar deri në xhaminë Aksa. Sikur të mos mjaftonte kjo, paska shkuar deri në qiell. A edhe këtë do ta besoni? Mos na thoni se edhe kjo është e vërtetë!” Këto fjalë ia thanë edhe Ebu Bekrit (r.a.). Përgjigja e vetme e Ebu Bekrit (r.a.), ishte kjo: “Nëse e ka thënë ai, është e vërtetë.” Në këtë mënyrë, ai vuri në pah logjikën dhe arsyetimin e zgjuar të tij duke u shprehur: “Unë besoj se ai merr shpallje nga Allahu Teala dhe se takohet me Xhebrailin, (a.s.). Nëse u besoj këtyre, sigurisht se do t’i besoj çdo gjëje që thotë ai. Prandaj, çfarëdo që thotë ai është e vërtetë.”

Ja, kështu u bë Siddik Ebu Bekri (r.a.). Përgjatë jetës 23 vjeçare të profecisë së të Dërguarit të Allahut (a.s.), Ebu Bekri (r.a.), ishte mbështetësi më i madh materialo-financiar dhe shpirtëror i tij në Mekë, në hixhret, në Medine, në luftërat dhe në çdo vend.

Kur i Dërguari i Allahut (a.s.), u shtroi një gosti të afërmve të tij, asnjëri prej tyre nuk bëri zë. Ndërsa ata që mendonin si Ebu Lehebi filluan të ofendonin. Aliu, edhe pse ishte një fëmijë i vogël, u hodh përpara dhe tha: “Ty të besoj unë, o i Dërguari i Allahut!” Nderimi më i madh që Allahu Teala i dha Pejgamberit (a.s.), ishin këta besimtarë. Për këtë arsye, patjetër duhet të keni ndihmëtarë që i besojnë idealit tuaj dhe që besojnë se ju do ta arrini synimin që i keni vënë vetes. Nisur nga kjo, ju duhet të formoni pikë së pari një kuadër të sinqertë dhe besnik.

Disa prej pashallarëve që e kundërshtonin që në fillim rrethimin e Stambollit, përgjatë ditëve të rrethimit që kalonin, i propozonin Fatihut që ta hiqte dorë nga rrethimi. Ndërsa Akshemseddini u bë mbështetësi më i madh i Fatihut dhe fuqia shpirtërore e tij duke insistuar për çlirimin. Më në fund, çlirimi u realizua me sukses. Prandaj, konsulti mi është kusht, por patjetër duhet të bëhet me njerëz trim, të ditur dhe optimistë...

Ne kemi nevojë për njerëz që na këshillojnë në lidhje me dispozitat e fesë së Allahut të Lartësuar dhe na japin kurajë për të bërë atë që është më e drejta e për të vepruar me ndershmëri. Gjithmonë duhet t’ua vëmë veshin njerëzve që na këshillojnë me fjalë të urta, me histori mësimdhënëse dhe me shembuj domethënës. Sado që ne të dimë, prapë se prapë kemi nevojë të pashmangshme për të dëgjuar dhe mësuar. Përse i përsërisin me qindra herë reklamat në radio dhe televizion? Sepse kështu gdhenden në mendje dhe zënë vend në memorie. Prandaj edhe ne kemi nevojë ta dëgjojmë me qindra herë të vërtetën.

Babai im ka qenë një njeri që kishte biseda të ëmbla, orator, elokuent dhe një njeri me shpirt prej poeti. Ai bënte kuvende fetare duke treguar

Ajo,
nëna jonë
e madhe, i tha:
“Përse shqetësohesh?”
Ai ia ktheu:
“Kush do të
më besojë mua?”
Hatixhja i tha:
“Të besoj unë,
o i Dërguari
i Allahut!”

shembuj plot urtësi. Unë kam dëshmuar disa herë kur njerëzit e dëgjonin bisedën fetare të babait tim deri në orën dy apo tre të natës pa u mërzhitur dhe bezdisur aspak. Gjithashtu ka pasur raste edhe kur thoshin: “Mahmut aga, u bë vonë, por sidoqoftë na trego edhe më shumë!”

Më sipër thamë se edhe njëra prej urtësive të Miraxhit ishte të provuarit e fuqisë së besimit të besimtarëve. Kjo sprovë nuk ishte e vlefshme vetëm për atë periudhë, por do të jetë e vlefshme deri në Kiamet. Edhe dje ka pasur prej atyre që nuk kanë besuar, edhe sot ka prej tyre.

Një herë, kur babai im ishte gjallë, një ditë para natës së miraxhit, një i pafe kishte mbledhur dy-tre veta në një tavolinë para lokalit dhe po i helmonte duke u thënë: “Si mund të dalë një njeri në qiell? Kjo na u quaka miraxh! Kë po mashtrojnë këta?” Ata tre burrat ishin trembur dhe i kishin thënë: “Si mund ta thuash këtë?” Ai ua kishte kthyer: “Vëllëzër, a mund t’ua pranojë logjika juaj këtë? Si paska shkuar dhe paska ardhur pa iu ftohur ende vendi në shtratin e tij? A mund të ndodhë diçka e tillë?” Ata të tre i kishin thënë për shkak të padijes së tyre: “Ai ka dalë në qiell, por ka dalë me syrin e zemrës.” Burri dukej qartë se ishte prej ateistëve materialistë nga ideologjia komuniste. Çfarë të kuptojë ai nga zemra dhe shpirti? Atyre u kishte thënë: “Mos u bëni kaq injorantë! Njeriu ka katër sy në zemër. Në dy prej tyre qarkullon gjak i pastër dhe në dy të tjerët qarkullon gjak i papastër. Njëri qarkullon në trup, ndërsa tjetri shkon në mëlçi dhe pastrohet. Mos ka edhe ndonjë sy tjetër zemra që thoni se ka dalë në qiell me syrin e zemrës?”

Ndërkohë i Dërguari i Allahut (a.s.), nuk është ngjitur në qiell ashtu si në botën e ëndrrave. Veçanërisht për Isranë, domethënë, për shkuarjen nga Mesxhidu’l-Haram në Mekë deri në Mesxhidu’l-Aksa në Kuds ka konsensus ndërmjet dijetarëve se ka shkuar me shpirt dhe me trup. Kjo vërtetohet me ajetin fisnik. Shumica dërmuese e dijetarëve janë në konsensus se ky udhëtim ka vazhduar në të njëjtën mënyrë, domethënë, me trup dhe me shpirt. A nuk është Allahu i plotfuqishëm? A nuk është Ai që i ka krijuar këto ligje të fizikës? A mund të jetë i varur Ai nga këto ligje? Asnjëherë... Nëse Ai dëshiron ta çojë në qiell robin e Tij, i krijon shkaqet dhe e çon. Por ja që burri nuk besonte. Çfarë mund t’i thoni atij në këtë situatë? Prandaj ai le të mohojë derisa t’i vijë vdekja, të ngrihen perdet, të vijë Dita e Kiametit dhe ta shohë atë botë me sytë e tij!

Këta tre burrat në fjalë nuk i jepnin dot përgjigje

atij. Për shkak se nuk ia mbyllnin dot gojën, filluan të shqetësoheshin prej tij. Nuk e di si ta quajmë, rastësi apo mirësi, por ja që në ato momente babai im po kalonte aty. Ata menjëherë i thirrën babait, ngaqë e dinin se ai ishte orator, elokuent, mjeshtër në të folur dhe i aftë për t’i bindur të tjerët:

-Mahmut aga! Mahmut aga! A mund të vish pak?

-Çfarë ka ndodhur?

-Këtu ndodhet një i pafe dhe jobesimtar. Ai e mohon ngjarjen e Miraxhit. Thuaja ndonjë fjalë këtij!”

Babai im mori frymë thellë. Çështja ishte serioze... Burri i pafe ishte ulur dhe po devijonte njerëzit. Atij duhej t’ia tregonte cakun. Babai ishte ulur dhe i kishte pyetur: “Cili është problemi?” Ata i treguan për çdo gjë. Babai im u kishte thënë:

-Domethënë kështu ë? Shumë mirë. Atëherë, para se të fillojmë debatin, le ta nxjerrim në pah veten tonë. Kush je ti dhe kush jam unë? Çfarë je ti dhe çfarë jam unë? Që nga dita e parë e deri më sot njeriu ka gjetur dhe ka zgjedhur një të adhuruar për vete. Qoftë ky i adhuruar i vërtetë apo i gabuar. Dikush ka adhuruar zjarrin, dikush ka adhuruar idhujt, dikush ka adhuruar lopët dhe dikush tjetër i ka besuar Allahut. Dikush është bërë i krishterë, dikush është bërë çifut, dikush është bërë kështu, dikush është bërë ashtu, ndërsa dikush tjetër është bërë mysliman. Kjo është një e vërtetë historike, apo jo?

-E vërtetë!

-Atëherë, cili prej këtyre je ti? Ta dimë këtë, në mënyrë që të debatojmë sipas kësaj.

Burri kishte thënë:

“Unë nuk pranoj asnjërin prej këtyre.”

“Unë t’i thashë njëri pas tjetrit. Njerëzit kanë kërkuar dhe kanë gjetur një të adhuruar për veten e tyre. Meqë ti nuk i pranuale asnjërin prej këtyre, do të thotë se nuk je njeri. Ndërsa unë nuk di të flas gjuhën e kafshëve. Për të folur me ty, duhet të jesh kafshë. Andaj, unë nuk kam asgjë për të folur me ty!” Në këtë mënyrë ia kishte treguar vendin. Pra, kjo ishte një formë tjetër e shprehjes se Ebu Bekrit. “Unë besoj. Ti po deshe beso, po deshe mos beso! Nëse nuk beson, ti do të humbasësh. Nëse beson, ti do të fitosh. Prandaj mos u mundo për t’i hedhur njerëzit në dyshim!” Njeriu beson. Ai beson sikur sheh me sy. Nuk i heton dhe nuk i sheh me dyshim gjërat që beson. Njerëzit e tillë janë myslimanët. Ata besojnë se Allahu ka dërguar pejgamberë, se ka dërguar libra dhe se engjëjt që janë rreth nesh i shkruajnë veprat tona. Domethënë, u besojnë shu-

më gjërave që nuk mund t'i perceptojë mendja jote e ngushtë. Prandaj përse të mos i besojnë Miraxhit? Ti e paske humbur besimin tënd. Gjithashtu e paske humbur edhe humanizmin.

Nëse dyshon për Miraxhin, do të dyshosh për çdo gjë. Pastaj thua: "Nuk ka engjëj, nuk ka libër dhe nuk ka shpallje." Kjo nuk ka fund. Pastaj e mohon edhe Allahun, Zoti na faltë.

Unë kam besuar dhe e kam kuptuar çështjen. E kam hapur syrin e zemrës dhe e kam kuptuar çështjen, edhe nëse nuk e sheh dot syri i kokës. Edhe ti do ta kuptosh një ditë, siç thuhet edhe në Kuranin Fisnik: **"Për çfarë e pyesin ata njëri-tjetrin? Për Lajmin e madh, rreth të cilit ata kanë kundërshtime. Ani, shpejt do ta marrin vesh! Sigurisht që shpejt do ta marrin vesh!"** (Nebe', 1-5) Por atë ditë të kuptuarit nuk do të ketë dobi: **"Dhe, kur të sillet Xhehenemi, atë Ditë njeriu do të kujtohet - por ç'i duhet se u kujtua!"** (Fexhr, 23) Për këtë arsye, së pari duhet të besojmë. Në çdo moment duhet t'i besojmë ekzistencës e njësimin të Allahut Teala dhe nuk duhet të kemi qoftë edhe dyshimin më të vogël. Si kush? Si nëna jonë Hatixhja. Si sahabi i nderuar, Ebu Bekr es-Siddiku. Si sahabi i nderuar, Aliu (r.a.).

Përse kemi ardhur në këtë botë?

Junus përse ke ardhur në këtë botë?

Që gjuha ta përmendë Zotin natë e ditë.

Poeti i njohur, Junus Emre e shpjegon çdo gjë me dy vargje. Allahu i Lartësuar na ka dërguar në këtë botë për t'ju nënshtruar, për ta adhuruar dhe për ta përmendur Atë natë e ditë. Allahu na bëftë prej robërve të Tij që e përmendin pa reshtur dhe mos na bëftë prej atyre që e humbin besimin dhe dyshojnë në çdo gjë!

Që nga fillimi po e shtjellojmë temën duke nxjerrë në pah se edhe në jetën e biznesit duhet t'i besosh synimit që ke. Ti e ke vendosur synimin dhe beson se do t'ia dalësh mbanë me sukses. Nëse ke vepëruar kështu, atëherë mos u preokupo me ata që e shohin të palogjikshme këtë dhe që nuk e pranojnë.

Disa njerëz çdo gjë e shohin me dyshim. Nëse bota do të kishte ngelur gjithmonë në dorë të këtyre kundërshtuesve, shumë gjëra nuk do të shpikeshin. A do të prodhoheshin avionët e sotëm sikur të merrëshin parasysh fjalët e atyre që thoshin: "A mund të fluturojë një gjë e rëndë me tonelata?" Mendoni për operacionet. Mendoni për shumë teknika nga mikro deri te makro. Të gjitha këto janë sukseset e atyre njerëzve që besuan se ia dilnin mbanë. Po ashtu janë edhe sukcesi i atyre që u besuan dhe i mbështetën ata.

Të besosh do të thotë të shikosh para se të shohësh me sy dhe ta integrosh atë në zemër apo në kokë. Kur Fatihu ishte fëmijë, shikonte ëndrrat e çlirimit. Ai e besonte këtë gjë. Atëherë, si t'ua shpjegonte atyre që nuk e besonin? Këtë mund t'ua shpjegonte vetëm duke e çliruar Stambollin. Ai e çliroi Stambollin dhe e nxori në pah suksesin e tij. Edhe njeriu që shpik, e kryen projektin dhe e nxjerr në pah. Këtu sigurisht se duhet ta shtjellojmë në veçanti edhe çështjen e të vepruarit vetëm sipas imagjinatës.

Asnjëherë nuk duhet të harrojmë se Allahu është i Plotfuqishëm, ndërsa ne nuk jemi. Gjërat që njeriu mund t'i imagjinojë pa futur në llogari të vërtetat e tregut, ligjet e fizikës, shpenzimet e prodhimit dhe gjendjen e vendit e të botës, nuk janë plane apo projekte, por imagjinata të pavlera. Sikundër njerëzve që e ekzagjerojnë në dyshime dhe në vesvese, ka prej atyre që i besojnë vetes më tepër seç duhet dhe janë tepër optimistë. Domethënë janë robër të imagjinatës dhe aventurës. Nëse njerëzit e tillë i bëjnë edhe të tjerët që t'u besojnë imagjinatave të tyre, në pah dalin falimentime dhe dështime të mëdha. Në lidhje me këta njerëz gjithmonë duhet të pyesim: "Çfarë suksesesh kanë arritur deri më sot? Ai i kanë borxhe kujt? A gënjejnë? Si i kanë llogaritë personale? A mund t'i administrojnë si duhet paratë e tyre? A e njohin vetë punën që duan të bëjnë? Vallë, flasin për para që fitohen shpejt dhe lehtë apo për një fitim të ngadaltë dhe të vazhdueshëm që arrihet me punë serioze?"

"Për çfarë e pyesin ata njëri-tjetrin? Për Lajmin e madh, rreth të cilit ata kanë kundërshtime. Ani, shpejt do ta marrin vesh! Sigurisht që shpejt do ta marrin vesh!"

MREKULLITË E Kuranit

RREZIQET E TATUAZHEVE

Shkencëtarët paralajmërojnë për rreziqet e shumta që mund të sjellin tatuazhet, tatuazhi mund të bëhet shkak për shumë sëmundje madje edhe për kancer. Sepse pigmentet që përdoren për bërjen e tatuazhit shkaktojnë irritim të qelizave. Tatuazhet shkaktojnë infeksione dhe komplikime të tjerë të lëkurës, tatuazhi mund të shkaktojë infeksione të ndryshme dhe nëse pajisa që përdoret është e kontaminuar me gjak të infektuar mund të merren sëmundje të tilla si Hepatit B, Hepatit, C. Tetanus dhe HiV. Për të parandaluar dëmet që mund të shkaktojnë tatuazhet Profeti (a.s.) ka mallkuar ata që bëjnë tatuazhe në trupin e tyre dhe artistët që praktikojnë këtë profesion.



RËNDËSIA E LOJËS TEK FËMIJËT

Psikologët e zhvillimit të fëmijëve konsiderojnë se loja është shumë e rëndësishme në aspektin e zhvillimit sociologjik, psikologjik dhe intelektual të fëmijës. Në aspektin sociologjik fëmija mëson respektimin e rregullave të lojës dhe lojtarëve të tjerë, si dhe rrit komunikimin. Në aspektin psikologjik fëmija ushtron vëzhgimin, fantazinë, mendimin dhe inovacionin. Loja i ndihmon fëmijët të shprehin botën e tyre të ndjenjave. Loja gjithashtu ndihmon në zhvillimin e aftësive intelektuale të fëmijëve. Kurani e përmend lojën e fëmijëve në rastin e Jusufit (a.s.) kur vëllezërit i thonë babait të tyre, Jakubit (a.s.): **“Dërgoje nesër me ne që të argëtohet dhe të luajë. Të sigurojmë se do ta ruajmë.”** (Jusuf,12)

"Në vend të Allahut, ata kanë zgjedhur për zot rabinët dhe murgjit e tyre, si dhe Mesinë, të birin e Merjemes."

(Teube, 31)

Një Ajet

Marrëdhënia Zot-njeri është një çështje shumë delikate. Çdo fe ka klerikët e vet. Këta kryejnë rolin e ndërmjetësit midis njeriut dhe Zotit. Janë pikërisht këta njerëz që në shumë raste e keqpërdorin pozitën që kanë. Këta gjithmonë përbejnë risk për të përdorur fenë për interesa të tyre.

Disa cilësi që i takojnë vetëm Zotit, njerëzit ua kanë atribuar edhe klerikëve, thënë ndryshe, këta konsiderohen si të shenjtë nga ana e shoqërisë. Këtë fenomen mund të vëmë re gjatë gjithë historisë. Kurani u jep një hapësirë të rëndësishme klerikëve të Ehli Kitabit. Ai trajton marrëdhëniet e të krishterëve me shpirtëroren. Ai thekson faktin e devijimit të tyre nga Tevhidi, duke shenjtëruar klerikët. Ajeti kuranor i lartpërmendur thekson pikërisht këtë fakt. Në ajet, Kurani nuk kritikon vetëm klerikët, por edhe masën e gjerë të shoqërisë, e cila ndjek ata.

Sipas një transmetimi, në një rast kur tek Profeti (a.s.), erdhi Adi ibn Hatimi, i cili i përkiste një fisi me rrënjë të forta kristiane, Profeti (a.s.), i lexoi atij disa ajete nga surja Teube. Kur arriti tek ajeti i lartpërmendur e ndërpreu leximin. Adi ibn Hatimi i tha: 'Ne nuk adhurojnë klerikët.' Profeti (a.s.), i tha: "A lejojnë atë që ka ndaluar Allahu dhe ndalojnë atë që ka lejuar Allahu? A nuk i ndiqni ju ata në këtë çështje? Po," u përgjigj Adi ibn Hatimi. Atëherë ky është vetëm adhurim. (Tirmidhi, Tefsir, IX.)

Shenjtërimi dhe hyjnizimi i dikujt nuk nënkupton domosdoshmërisht konsiderimin e tij zot, mendimi se dikush ka të drejtën dhe autoritetin për të bërë ndryshime dhe vendosur rregulla të reja fetare përbën hyjnizim dhe shenjtërim të tij.

Respekti ndaj dijetarëve dhe njerëzve të urtë nuk përbën asnjë problem, proble-

mi fillon kur mësimet e tyre merren si të shenjta dhe të drejta absolute pa i kaluar aspak nëpër sitën e kritikës. Madje dhënia e besës Profetit (a.s.), është e kushtëzuar vetëm për gjërat e drejta dhe të arsyeshme. (Mumtehine,12) Përderisa një kusht i tillë vendoset për profetët, a nuk duhet që në lidhje me dijetarët dhe klerikët gjendja të jetë edhe më e ndjeshme?

Jo çdo mendim dhe veprim i klerikëve është i drejtë dhe i saktë. Ditën e Gjykimit çdo njëri do të gjykohet për veprat e veta. Pra e vërteta nuk përcaktohet sipas dijetarëve, por mendimet dhe qëndrimet përcaktohen sipas të vërtetës.

Të krishterët e parë besonin vetëm Allahun, por me kalimin e viteve, në raste vështirësish ata filluan të kërkojnë ndihmë nga njerëz të urtë, të cilët më vonë i konsideruan të shenjtë. Akoma më vonë njerëzit filluan të besojnë se këta të shenjtë kishin cilësi mbinatyrore. Papën e konsiderojnë si të shenjtë dhe të ruajtur nga mëkatet, për pasojë bindja ndaj tij është bërë obligim fetar.

Ajeti është edhe një vërejtje për myslimanët, në mënyrë që të mos bien në të njëjtin gabim si Ehli Kitabit. Sepse edhe myslimanët nuk janë të mbrojtur nga ky rrezik. Devijimet fillojnë në mendime dhe besim pastaj në përligjen e interpretimeve të ndryshme për t'u konsideruar si të vërteta dhe praktikuar nga brezat e mëvonshëm.

Në historinë islame janë evidentuar raste të shenjtërimit të dijetarëve dhe klerit, por kanë qenë raste sporadike. Ajeti në fjalë është një paralajmërim me vend për të gjithë myslimanët që të jenë vigjilentë, mos të bien në të njëjtin gabim që kanë rënë fetë e tjera.

Resulullahi (sal-lallahu alejhi ve sel-lem) ka thënë:

“Unë dhe kujdestari i jetimit në xhenet jemi kështu, dhe bashkoi dy gishtat.”

(Buhari, Talak, 25)

DY FJALË KOMENTI:

Sipas islamit njeriu është në qendër të ekzistencës, ai është krijesa më e vlerësuar. Kjo vlerë i vjen atij nga të qenit njeri. Prandaj Islami i jep një rëndësi të veçantë gjithë procesit jetësor të njeriut, duke filluar nga ngjizja në barkun e nënës deri në vdekje. Kurani për të mbrojtur të drejtat e njeriut ka sjellë dispozita të veçanta. Islami nuk pranon në asnjë mënyrë që të cenohet e drejta e të dobëtit dhe të pafuqishmit. Një kujdes jash-tëzakonisht të veçantë tregon kur midis gjithë të dobëtëve bëhet fjalë për jetimët dhe gratë. Prandaj në një hadith Profeti (a.s.), i lutet Allahut në këtë mënyrë: “O Zot, ji dëshmitar që i kam paralajmëruar fort njerëzit që të tregojnë kujdes ndaj të drejtave të jetimit dhe gruas.

Kurani dhe Tradita profetike i trajton me detaje të drejtat e jetimëve. Madje në jurisprudencën islame “e drejta e jetimit” është një lëndë e veçantë. Profeti (a.s.), midis nëntë mëkateve të mëdha ka përmendur shpërdorimin e pasurisë së jetimit.

“Vërtet, ata që shpenzojnë pasurinë e jetimit pa të drejtë, vetëm mbushin barkun e tyre me zjarr dhe ata do të digjen në zjarrin flakërues.” (Nisa, 10)

Feja islame ka marrë masa të forta për të krijuar kushte të përshtatshme për rritjen dhe edukimin e jetimit. Kurani këtë detyre ia ka ngarkuar personalisht Profetit (a.s.), duke e këshilluar të mos e nënçmojë dhe zemërojë jetimin. Shtëpia e Profetit (a.s.), ishte vendi ku të gjithë jetimët gjenin qetësi dhe dashuri. Pejgamberi (a.s.), këshillonte

duke thënë se shtëpia më e mirë ndër myslimanët është ajo shtëpi në të cilën ndodhet një jetim dhe që trajtohet me mirësi, ndërsa shtëpia më e keqe ndër myslimanët është ajo shtëpi në të cilën ndodhet një jetim dhe që keqtrajtohet. Profeti (a.s.), i dha përparësi jetimëve të dëshmorëve të luftës së Bedrit ndaj vajzës së tij të dashur Fatimes. Profeti (a.s.), kujdesej personalisht për jetimët e dëshmorëve dhe vazhdimisht i këshillonte besimtarët të bënin të njëjtën gjë. Dhembshuria, mëshira, ndihma për jetimin ishte amaneti i Tij. Fatkeqësisht në ditët tona ky sensibilitet për jetimin ka humbur. Shoqëria është bërë indifereente ndaj kësaj klase të shoqërisë. Nga që zemrën e kemi të mbushur me gjërat e kësaj bote nuk ka mbetur hapësirë për jetimët.

Sidomos në këto ditë të vështira, ku shumë fëmijë kanë mbetur jetimë në shumë vende të botës islame për shkak të luftërave, ne duhet të rizgjojmë sensibilitetin ndaj jetimëve.

Një person që përkëdhel kokën e një jetimi për hir të Allahut ka shpërblime sa numri i fijeve të flokut të prekura. (Musned, V, 250)

MËSIMET QË NXJERRIM NGA HADITHI

1. Rëndësia që Islami i jep jetimit
2. Kujdesi ndaj jetimit sjell fitimin e Xhenetit
3. Kujdesi ndaj jetimit bën të mundur që në Xhenet të jemi bashkë me Profetin (a.s.).

Mjë Hadith



NGA MORALI SHEMBULLOR I TË DASHURVE TË ALLAHUT

VËLLAZËRIA

Vëllazëria islame është një e drejtë madhështore, që Allahu e ka vendosur midis besimtarëve dhe, nëse respektohet ashtu siç duhet, ka një shpërblim të mrekullueshëm. Ajo është burimi i paqes, gëzimit dhe lumturisë individuale e shoqërore. Po ashtu, vëllazëri islame, do të thotë të përfshish të gjithë besimtarët në atmosferën e dashurisë shpirtërore, të jesh një mik i sinqertë dhe për kokë, të gëzohesh me gëzimin e vëllait dhe t'i qash hallet atij, të jesh burim ngushëllimi në kohë të vështira dhe, nëse është e nevojshme, të sakrifikosh edhe prej vetes.

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Ka disa njerëz prej robërve të Allahut, që nuk janë as pejgamberë e as shehidë/dëshmorë, por për shkak të pozitës së lartë që do të kenë tek Allahu në Ditën e Kiametit, do t'i kenë zili edhe pejgamberët edhe dëshmorët.”

Sahabët e nderuar thanë:

“Kush janë këta dhe çfarë punësh të mira kanë bërë? Na i trego edhe neve, që t'i duam dhe të bëhemi të afërt me ta, o Resulullah!”

Resulullahu (a.s.), tha:

“Këta janë njerëz të tillë, që edhe pse midis tyre nuk ka asnjë lidhje farefisnore dhe asnjë marrëdhënie tregtie apo pune, ata e duan njëri-tjetrin vetëm për hir të Allahut. Për Allahun! Fytyrat e tyre janë dritë, e ata vetë, qëndrojnë mbi ulëse prej drite. Kur njerëzit të tmerrohen në Ditën e Kiametit, këta nuk do të kenë

frikë. Kur njerëzit të hidhërohen, këta nuk do të hidhërohen.” Pastaj, menjëherë pas këtyre fjalëve, lexoi këto ajete fisnike:

“Pa dyshim, miqtë e Allahut nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar dhe as për t’u dëshpëruar. (Të tillë janë) ata që besojnë dhe që (i) frikësohen (Allahut). Ata i pret lajmi i mirë në këtë jetë dhe në tjetrën. S’ka ndryshim në fjalët e Allahut; kjo është fitorja madhështore.” (Junus, 62-64)¹

Në një hadith tjetër, Pejgamberi ynë (a.s.), duke theksuar, se të duash një vëlla feje vetëm për hir të Allahut, bëhet shkak për dashurinë e Allahut, tregon:

“Një njeri, doli për udhë që të shkonte për vizitë tek një vëllai i tij (i fesë) që ndodhej në një fshat tjetër. Allahu Teala i dërgoi një melek (në formën e njeriut) për ta vëzhguar (dhe sprovuar). Kur njeriu kaloi pranë melekut, ai e pyeti:

“Ku po shkon?” Njeriu u përgjigj:

“Tek ai fshat, kam një vëlla të fesë, të cilit po i shkoj për vizitë.” Meleku pyeti përsëri:

“Ke ndonjë interes tek vëllai yt?” Njeriu përgjigjet:

“Jo, unë e dua atë vetëm për hir të Allahut, prandaj po i shkoj për vizitë.” Pas këtyre fjalëve, meleku thotë:

“Ashtu siç e doti atë, edhe Allahu të doty. Unë jam i Dër-

1. Ebu Daud, Buju, 76/3527; Hakim, IV, 170.

guari i Allahut dhe kam ardhur të të përgëzoj për këtë.”²

Në një hadith tjetër, Pejgamberi (a.s.), thotë:

“Janë shtatë kategori njerëzish, të cilët Allahu Teala do t’i strehojë nën hijen e Vet (Arshit të Tij), në ditën kur nuk do të ketë hije tjetër përveç saj... (një nga këto kategori janë edhe) njerëzit që e duan njëri-tjetrin vetëm për hir të Allahut dhe që bashkohen vetëm në sajë të kësaj dashurie...”³

Qëllimi i thelbësor i dashurisë që ndjejnë besimtarët e tillë të devotshëm për vëllezërit e tyre, është arritja e kënaqësisë së Allahut. Qëllimi i vetëm i tyre, është të përfitojnë prej lutjes së vëllait të tyre të fesë për të qenë robër të afërt me Allahun.

Në tasavuf, koncepti *“ihvan”*, që do të thotë *“vëlla”*, shpreh solidaritetin reciprok në rrugën që të çon drejt Allahut, mbështetjen e njëri-tjetrit në çështje fetare e shpirtërore, plotësimin e nevojave të vëllait të fesë dhe bashkimi me hallet e tij. Dhe kjo, është përjetimi i vëllazërisë islame me ndjenja të pastra dhe të thella.

I dashuri i Allahut, Bishr-i Hafî, e dërgon Esved bin Salimin tek i nderuari Maruf-i Kehri. Esved Bin Salimi i thotë:

“Bishr-i Hafî kërkon vëllazëri me ju. Për shkak se i vjen zor t’jua thotë hapur këtë, më dërgoi mua për t’jua thënë. Ai dëshiron që ta pranoni në vëllazërinë tuaj. Mirëpo, ka frikë se mos nuk i respektton të drejtat e vëllazërisë ashtu siç duhet.”

2. Muslim, Birr, 38; Ahmed, II, 292.

3. Buhari, Ezan, 36.

Pas këtyre fjalëve, i nderuari Maruf-i Kehri thotë:

“Unë nuk dua të ndahem, as natën, as ditën prej atij me të cilin bëhem vëlla.” Pastaj i tregon atij shumë hadithe që flasin për mirësinë e dashurisë vetëm për hir të Allahut. Më pas, duke i shpjeguar kuptimin e vëllazërisë fetare dhe se si duhet të jetë dashuria e vërtetë vëllazërore, shprehet:

“Resulullahu (a.s.), kur e bëri Aliun (r.a.), vëlla të tijin, në të njëjtën kohë e bëri atë edhe ortak në dije. Po ashtu, i dha atij edhe vajzën e tij më të dashur. Tani, meqë ai të ka dërguar ty, ti je dëshmitar se unë e pranova atë në vëllazërinë time vetëm për hir të Allahut. Edhe sikur ai të mos më vizitojë, unë do ta vizitoj atë. I thuaj atij të takohemi në tubimet fetare. Të mos më fshehë asnjë gjë prej gjendjes së tij, por të më tregojë çdo gjë...”

Kur Ibn Salimi ia tha këto të nderuarit Bishr-i Hafîut, ai u gëzua jashtë mase dhe pranoi me gjithë kënaqësi.

VËLLAZËRIA ISLAME ËSHTË MË E EPËRME...

Vëllazëria islame është një lidhje aq madhështore, saqë nuk mund të krahasohet as me miqësitë e përkohshme, as me ato që zgjasin një jetë të tërë dhe madje, as me vëllazërinë prej gjakut.

Resulullahu (a.s.), i cili i ligjëroi njerëzimit një urdhër **“vëllazëror”**, që nuk ka të ngjashëm gjatë gjithë historisë njerëzore, ka thënë:

“Nëse do të kërkoja një mik prej njerëzve, do të zgjidhja Ebu Bekrin. Por vëllazëria islame është më e epërme.” (Buhari, Salat, 80.)

*“Ka disa njerëz
prej robërve të Allahut,
që nuk janë as pejgamberë
e as dëshmorë, por për shkak
të pozitës së lartë që do të
kenë tek Allahu në Ditën e
Kiametit, do t’i kenë zili
edhe pejgamberët edhe
dëshmorët.”*

Kjo do të thotë se vëllazëria islame përbën kulmin e miqësisë. Ebu Bekri (r.a.), ishte i vetmi që e shoqëroi Pejgamberin (a.s.), kur u fshehën në shpellën Seur gjatë emigrimit për në Medinë, ishte i dyti i të dyve dhe besniku i madh!... Ai ishte një sahab, për të cilin i Dërguari i Allahut ka pasur konsideratë të lartë dhe ka thënë: *“Të mbyllen të gjitha dyert përveç derës që të çon tek Ebu Bekri...”*; *“Ebu Bekri është prej meje dhe unë jam prej tij...”* Dhe për shkak të kësaj afërsie me Pejgamberin (a.s.), ai njihej edhe si “njohësi i sekreteve të Pejgamberit (a.s.)”. Mirëpo, Pejgamberi ynë i nderuar (a.s.), vëllazërinë islame e mban më lart këtij koncepti miqësie që kishte ndaj këtij sahabiu fisnik... Po ashtu edhe në jetën e Ebu Bekrit (r.a.), janë shfaqur shembuj të bukur të vëllazërisë islame.

Vëllazëria gjinore apo fisnore është diçka e përkohshme dhe relative, që i përket kësaj bote. Ashtu siç nuk i zgjodhëm vetë prindërit tanë kur erdhëm në këtë botë, nuk i kemi zgjedhur vetë as vëllezërit tanë prej gjaku. Në lidhje me këtë çështje, robrit nuk i është dhënë ndonjë drejtë zgjedhjeje. Mirëpo, në lidhje me zgjedhjen se kush do të jetë vëllai ynë i fesë, neve na është dhënë drejta e zgjedhjes. Dhe ajo që do t'i bëjë dobi njeriut, është vendimi i qëlluar që do të bëjë në zgjedhjen e tij në lidhje me këtë çështje.

Hasan Basriu, ka thënë:

“Miqte dhe vëllezërit tanë janë më të dashur për ne se sa pjesëtarët e familjes sonë. Kjo, sepse familjarët tanë na përkujtojnë në këtë botë, ndërsa miqtë tanë na kërkojnë në Ditën e Mahsherit (gjykimit).”⁴

Ndërsa Muhamed bin Jusuf Isfehani, thotë:

“E si mund të jetë familja dhe fëmijët e njeriut si vëllazëria e sinqertë? Familja dhe fëmijët i marrin trashëgiminë dhe kalojnë kohën duke e ngrënë atë me gjithë qejf. Ndërsa vëllazëria e sinqertë mban zi për të, mendon për gjendjen e tij në varr dhe lutet për të kur ai dergjet nën tokë.”

Siç e pamë, një nga kushtet më të rëndësishme të

vëllazërisë islame, është besnikëria. Pra, dashuria për vëllain gjatë gjithë jetës dhe vazhdimi i kësaj dashurie edhe pas vdekjes së tij, duke ruajtur miqësinë me familjarët dhe të dashurit e tij dhe duke e kujtuar atë vazhdimisht me lutje.

VËLLAZËRIA ENSAR-MUHAXHIR

Allahu i Madhëruar, për të na e bërë të kuptueshme se si duhet të jetë vëllazëria islame, na ka bërë shembull vëllazërinë e Ensarëve me Muhaxhirët. Pra, Ai dëshiron që ne të peshojmë veten tonë duke marrë ata si shembull.

Marrëveshja vëllazërore që realizoi Pejgamberi ynë (a.s.), midis Ensarëve dhe Muhaxhirëve, është një shembull i pashoq në historinë e njerëzimit.

Aq, sa Ensarët deklaruan pasuritë e veta dhe vunë në dispozicion të Muhaxhirëve të gjithë pasurinë që kishin duke qenë të gatshëm ta ndanin atë në dy pjesë të barabarta. Në këmbim të kësaj, Muhaxhirët, zemrat e të cilëve ishin thesare më vete, duke u treguar të kënaqur me atë që zotëronin, shfaqën pjekuri të jashtëzakonshme, sa që thoshin: “Allahu jua begatofte mallin dhe pasurinë o vëllezër, por mjafton të na tregoni vetëm rrugën për në treg!” Ata shfaqën edhe shumë shembuj të tjerë mesimdhënës që tregojnë më së miri se vëllazëria fetare është më e epërme se vëllazëria fisnore.

Në luftën e Bedrit, që ishte edhe rezistenca e parë e besimit ndaj mohimit, Ebu

Bekri (r.a.), rrahu shpatën me djalin e tij, Ebu Ubejde bin Xherrah (r.a.), me babain e tij, ndërsa Hamzai (r.a.), me vëllain e tij. Pra, lidhja fetare, i shumëzoi me zero të gjitha lidhjet e tjera...

Ndërsa tablonë e vëllazërisë së jashtëzakonshme fetare që u përjetua në Uhud, na e tregon Zubejr bin Avvami (r.a.):

“Nëna ime Safije, nxori dy rrobe që i kishte marrë me vete dhe tha:

«Këto i solla për të mbuluar vëllain tim Hamzain.»

I morëm rrobat dhe shkuam pranë Hamzait (r.a.). Pranë tij gjendej edhe një dëshmor tjetër prej Ensarëve, për të cilin nuk ishte gjetur ende një qefin



4. Ihjau Ulumiddin, V. II, fq. 437.

për ta mbuluar. Neve na erdhi zor që ta mbulonim Hamzain me të dyja rrobat dhe ta linim Ensarin pa qefin. Prandaj, njërën prej rrobave menduam ta bënim qefin për Hamzain dhe tjetrën për Ensarin. Por për shkak se njëra prej rrobave ishte më e madhe se tjetra, zgjedhjen e bëmë me short.” (Ahmed, I, 165.)

Allahu Teala i ka lavdëruar ata për këta shembuj të pashoq vëllazërie që kanë shfaqur dhe duke i bërë një mesazh për të gjithë njerëzimin, i ka përmendur edhe në Kuranin Kerim:

“Ndërsa ata që banojnë në Medinë dhe që e kanë pranuar besimin qysh më parë, i duan mërgimtarët që vijnë në Medinë dhe në zemrat e tyre nuk ndjejnë kurrfarë rëndimi për atë që u është dhënë atyre, por duan t’u bëjnë më mirë mërgimtarëve sesa vetes, edhe pse vetë janë nevojtarë...”
(Hashr, 9)

Ky ajet fisnik, përmban shumë ligjërime në lidhje me të drejtat e vëllazërisë. Në bazë të kësaj, qëllimi i vëllazërisë islame, nuk është vetëm miqësia dhe shoqëria për kafe e çaj në kohë të mira, por shfaqja e solidaritetit dhe miqësisë me vëllain e fesë edhe në kohë të vështira. Përveç kësaj, të sakrifikosh edhe veten për vëllain tënd.

MOS U BËJ BARRË, POR NDIHMË!..

Dikush i tha të dashurit të Allahut, Xhunejd Bagdadit:

“Sot, janë pakësuar vëllazëritë e vërteta. Ku janë ato vëllazëri që bëheshin për hir të Allahut?..” Me ta dëgjuar këtë, i nderuari Xhunejd Bagdadi tha:

“Nëse kërkon dikë që të mbajë barrën tënde dhe të plotësojë nevojat e tua, sot nuk mund ta gjesësh një vëlla të tillë. Por, nëse kërkon një vëllazëri që t’u ndihmohet për hir të Allahut dhe të mbash barrën e tyre, të këtyllë ke shumë.”

Pejgamberi ynë i dashur (a.s.), ka thënë:

*“Besimtari shkon mirë me të tjerët dhe të tjerët shkojnë mirë me të. Nuk ka dobi prej atij që nuk shkon mirë me të tjerët dhe të tjerët nuk shkojnë mirë me të.”*⁵

5. Ahmed, II, 400; V, 335; Hakim, I, 73/59.

Për këtë arsye, kushti i parë i miqësisë me vëllain e fesë, është të mundohesh të mos bëhesh barrë. Pra, të mos i bëhesh barrë vëllait pa qenë nevoja, përkundrazi të përpiqesh që të lehtësosh barrën e tij. Miqësia e atij që nuk të sjell vështirësi dhe dashuria e atij që nuk të mundon, është jetëgjatë.

Në vëllazërinë islame ka disa rregulla, të cilat duhen respektuar patjetër. Respektimi i këtyre rregullave, është e drejta e vëllazërisë islame mbi ne. Pejgamberi ynë i dashur (a.s.), këto rregulla i përmbledh në këtë mënyrë:

“Të drejtat e myslimanit ndaj myslimanit, janë gjashtë: T’i japësh selam kur të takohet me të, t’i përgjigjet ftesës nëse ftohet, të këshillojë nëse kërkohet këshilla e tij, nëse vëllai tështin dhe falënderon Allahun (thotë elhamdulillah), t’i thotë “jerhamukallah”, ta vizitojë nëse sëmuret dhe t’i përcjellë xhenazen kur të ndërrojë jetë.”
(Muslim, Selam, 5.)

“Përhapni selamin, ushqeni të varfrit dhe në këtë mënyrë behuni vëllezër ashtu siç ju ka urdhëruar Allahu i Plotfuqishëm e i Madhëruar.” (Ibn Maxhe, Et’ime, 1.)

Në lidhje me marrëdhëniet vëllazërore, horizonti ynë duhet të jetë shumë i gjerë, sepse niveli ynë në vëllazëri, tregon edhe nivelin e pjekurisë sonë. Në bazë të kësaj:

1. Ndhima e besimtarit në gjendje të mirë, ndaj vëllait të tij i cili ndodhet në gjendje të vështirë, është **shkalla e parë** e vëllazërisë. Në lidhje me këtë, në një ajet fisnik urdhërohet:

“...Bëju mirë të tjerëve, ashtu si Allahu të ka bërë mirë ty!..” (Kasas, 77)

Aliu (r.a.), ka thënë:

“Janë dy mirësi që nuk e di se cila prej tyre më gëzon më shumë. E para, kur një njeri vjen tek unë (më zgjedh mua) duke shpresuar se unë mund t’ia plotësoj nevojën dhe më kërkon ndihmë me sinqeritet të plotë. Ndërsa e dyta, kur Allahu Teala ia plotëson kërkesën këtij personi ose ia lehtëson çështjen në sajën tim. Për mua është më mirë t’i plotësoj nevojën një myslimani, se sa të kem një botë të tërë me ar e argjend.”⁶

6. Ali el-Muttaki, Kenzu'l-Ummal, VI, 598/17049.



2. Ndërsa **shkalla e dytë**, është të kuptosh të fshehtën e ajetit “...**Do t’i njohësh (ata) nga pamja e tyre...**” dhe t’ia plotësosh nevojën vëllait tënd, pa pasur nevojë që ai ta kërkojë. Ky ajet fisnik, na motivon që të arrijmë një ndjesi shpirtërore të tillë, sa që t’i njohim prej pamjes së tyre të jashtme vëllezërit tanë të cilëve u vjen zor të përmendin nevojat e tyre për shkak të nderit e turpit. Arritja e kësaj, tregon nivelin e lartë të horizontit të besimtarit.

Kjo është edhe ndjeshmëria shpirtërore që e bëri Omerin (r.a.), të vinte vërdallë në mes të natës me thesin e miellit në krahë për t’u ardhur në ndihmë të varfërve dhe hallexhinjve.

Nëpër karvan-sarajet apo bujtinat që kanë ndërtuar të parët tanë Osmanët, u ofrohej ushqim e strehim udhëtarëve që vinin aty, pa parë se kush ishin dhe të gjithë ata mund të qëndronin aty për tre ditë. Ndërsa, kur përgatiteshin për të ikur, nëse u ishin vjetërsuar këpucët, u jepeshin të reja. Në atë kohë, të pasurit shkonin nëpër burgje dhe lironin ata që ishin burgosur për shkak të borxheve duke ua larë borxhet. Gjithashtu, besimtarët e pasur, veçanërisht gjatë muajit të Madhëruar të Ramazanit, shkonin nëpër dyqane dhe lanin borxhet e atyre që kishin blerë veresie, pa e marrë vesh vetë borxhliu. Një shembull tjetër i vëllazërisë vetëm për hir të Allahut, ishin edhe gurët e lëmoshës, ku vendoseshin para apo ushqime me qëllim që të mos përballej ai që jepte me atë që merrte.

Kjo vetëdije në lidhje me vëllazërinë fetare, bëri që institucionet e vakëfeve ta përfshinin të gjithë shoqërinë si një rrjetë mëshire. Me aq sa është verifikuar, në kohën Osmane, janë formuar rreth 26 mijë vakëfe. Kjo shifër, tregon qartë përpjekjen e madhe të të parëve tanë në lidhje me këtë çështje.

Ndërmjet tyre, vakëfi që ngriti në Sham/Damask, Nëna e Sulltanit, Bezm-i Alemi, ka një rëndësi të veçantë. Fusha e shërbimeve të këtij vakëfi, përfshin

dëmshpërblimin e sendeve që shërbyesit dëmtonin pa qëllim, në mënyrë që të mos qortoheshin apo t’u hapeshin probleme.

Ndjenjat e vëllazërisë fetare që shfaqën të parët tanë para shumë shekujsh në sajë të dashurisë për besimin, ishin në një nivel të tillë, sa që shoqëritë e sotme të bazuara në interesa dhe përfitime personale, as që mund t’i mendojnë.

3. Një shkallë më sipër, qëndron mirësia e vërtetë. Pra, të dëshirosh për vëllain tënd atë që dëshiron për veten. Të mos e konsiderosh vëllain tënd jashtë vetvetes.

Kur po shkohej në betejën e Bedrit, për shkak të pamundësive ekonomike, në një deve hipnin me radhë tre persona. Pejgambëri ynë (a.s.), e ndante deve në me Aliun (r.a.) dhe Ebu Lubaben (r.a.). Megjithëse që të dy sahabët dëshironin me gjithë shpirt t’ia linin radhën e tyre Pejgamberit (a.s.), ai nuk e pranoi këtë gjë dhe vazhdoi të hipte në deve vetëm kur i vinte radha.⁸

Pejgambëri (a.s.), ka thënë: “Ai që nuk dëshiron për vëllain e tij të fesë atë që dëshiron për veten e tij, nuk mund të jetë besimtar i vërtetë.” (Buhari, Iman, 7.)

Një shembull tjetër i kësaj shkalle të virtytit, është edhe Osmani (r.a.). Në kohën kur myslimanët po vuanin për ujë në Medinë, ai bleu pusin “Rume” duke paguar një shumë të madhe parash dhe e dhuroi atë si vakëf për myslimanët. Sipas transmetimeve, edhe ai hynte në radhë si gjithë të tjerët për të marrë ujë nga ky pus.

Pjekuria dhe ndjenjat e thella të të parëve tanë në lidhje me kujdesin ndaj vëllezërve të fesë, ishte bërë shkak i një delikatese dhe mirësjellje të tillë, sa që kur në një shtëpi ndodhej ndonjë i sëmurë, në dritaren e asaj shtëpie vendosej një lule e kuqe. Në këtë mënyrë, shitësit ambulante, madje edhe fëmijët e lagjes, e kuptonin se aty duhej kaluar në qetësi për të mos e shqetësuar të sëmurin.

Në kohën kur myslimanët po vuanin për ujë në Medinë, Osmani (r.a.) bleu pusin “Rume” duke paguar një shumë të madhe parash dhe e dhuroi atë si vakëf për myslimanët. Sipas transmetimeve, edhe ai hynte në radhë si gjithë të tjerët për të marrë ujë nga ky pus.

7. Kur'an: el-Bekare, 2/273.

8. Shih. Ibn Sa'd II, 21.

4. **Shkalla më e lartë** e vëllazërisë fetare, është grada e “*isar*”it. Pra, kur besimtari e vendos vëllain e tij të fesë, para vetvetes, të drejtën e vet ia jep atij dhe e konsideron atë më të lartë se veten. Kjo, do të thotë që kur është nevoja, të jesh i gatshëm të privosh veten dhe të mendosh për nevojën e vëllait tënd para se të mendosh për nevojën tënde. Ja pra, ky është niveli i besnikëve, të devotshmëve dhe të sinqertëve. Është shkalla më e lartë e dashurisë për hir të Allahut.

Po ashtu, edhe Pejgamberi ynë (a.s.), mendonte më shumë për popullin e tij se sa për veten. Pa u ngopur shokët e tij, nuk ngopej as ai dhe as familja e tij. Gjithçka që kishte ua shpërndante të varfërve dhe në shtëpinë e tij nuk ndizej zjarr e nuk gjendej bukë për ditë të tëra.

Një ditë, Ebu Hurejrën (r.a.), e kishte marrë uria. Por për arsye se nuk kishte gjetur gjë për të ngrënë, kishte lidhur një gur në bark. Ndërsa ishte në këtë gjendje, takoi Ebu Bekrin (r.a.) dhe me shpresën se mos i jepte diçka për të ngrënë, e pyet atë për një ajet. Pasi iu përgjigj, Ebu Bekri (r.a.), u nda me të dhe shkoi në shtëpi. Më vonë takoi Omerin (r.a.). Por edhe ai veptoi të njëjtën gjë, sepse në ato momente, asnjëri prej tyre nuk kishte mundësi për ta ndihmuar. Ndërkohë, Pejgamberi ynë (a.s.), e pa Ebu Hurejren (r.a.) dhe prej fytyrës së tij, e kuptoi atë që kishte në zemër, prandaj dhe e ftoi në shtëpinë e tij. Në shtëpinë e Pejgamberit (a.s.), kishin sjellë pak qumësht në një enë. Kur Ebu Hurejra (r.a.), e pa qumështin, u gëzua. Por nuk zgjati shumë, sepse Pejgamberi (a.s.), e urdhëroi që të thërrasë sahabët e Sufës⁹. Sahabët e Sufës, ishin mysafirët e Islamit. Ata nuk kishin as familje, as pasuri dhe as të afërm. Kur Pejgamberit (a.s.), i vinte ndonjë sadaka, e dërgonte tek ata dhe për vete nuk mbante asgjë prej saj. Por, nëse vinte ndonjë dhuratë, mbante një pjesë për vete dhe me pjesën tjetër qeraste sahabët e Sufës.

Ftesa që i bëri i Dërguari i Allahut (a.s.), sahabëve të Sufës, nuk i pëlqeu fort Ebu Hurejrës (r.a.), sepse qumështi nuk mjaftonte as për sahabët e Sufës, e jo

9. Sahabët e Sufës: Shokët e Pejgamberit (a.s.), të cilët prej varfërisë, banonin në një pjesë të xhamisë, ku edhe merrnin dijet fetare.

më të ngelej ndopak për të. Mirëpo, duke menduar se nuk ishte e drejtë të mos i bindej urdhrit të Resullullahut (a.s.), ai shkoi dhe ftoi sahabët e Sufës. Kur erdhën, Pejgamberi (a.s.), e urdhëroi Ebu Hurerjen (r.a.), që t'i qeraste një nga një sahabët e Sufës. Çdo sahab që e merrte enën, pinte deri sa ngopej dhe ia kthente përsëri enën. Pasi pinë të gjithë sahabët e Sufës, Ebu Hurerja (r.a.), ia zgjati enën Resullullahut (a.s.), i cili e mori atë dhe ia dha përsëri Ebu Hererjes duke i thënë:

“*Ulu dhe pi!*” Ai u ul dhe piu derisa u ngop. Sa herë që ia jepte enën Pejgamberit (a.s.), ai i thoshte përsëri:

“*Ulu dhe pi!* Më në fund, Ebu Hurejra (r.a.), tha:

“Jo! Beto hem në Allahun që të ka dërguar si Pejgamber të së vërtetës, se nuk më ka ngelur më vend për të pirë.” Pas kësaj, Pejgamberi (a.s.), e mori enën, e falënderoi Allahun, tha bismilalh dhe piu qumështin që kishte mbetur.”¹⁰

Po ashtu, edhe kjo ndodhi që ka ngjarë gjatë ditëve të betejës së Hendekut, është shumë mbresëlënëse:

Sahabët që po gërmonin hendekun, erdhën tek Resullallahu (a.s.) dhe e lajmëruan se rastisën në një shkëmb të fortë, të cilin nuk mundën ta thyenin dot. Pejgamberi ynë (a.s.), i cili kishte tri ditë pa ngrënë gjë dhe për këtë arsye kishte lidhur edhe gurë në bark, zbriti në hendek dhe duke e goditur shkëmbin, e bëri copë e thërrime.

Ndërkohë, Xhabiri (r.a.), mori leje prej Resullullahut (a.s.), për të shkuar në shtëpi. Kur shkoi në shtëpi, i tregoi gruas së tij, se Resullallahu (a.s.), është në një gjendje të keqe për shkak të urisë dhe e pyet:

“Çfarë ka për të ngrënë në shtëpi?”

Gruaja, i tha se ka vetëm pak elb dhe një kec. Xhabiri (r.a.), e preu kecin dhe e bloi elbin. Pasi e vuri mishin në tenxhere dhe bukën në furrë, shkoi menjëherë pranë Resullullahut (a.s.) dhe i tha:

“O i Dërguar i Allahut! Kam pak ushqim. Merr dy tre veta dhe urdhëroni tek ne.”

Pejgamberi (a.s.), e pyeti se sa ushqim kishte.

10. Shih. Buhari, Rikak, 17.



Ndërsa Xhabiri (r.a.), i tha atë që kishte. Pas kësaj, Pejgamberi (a.s.), tha:

“Oho, paska edhe shumë, qenka edhe e mirë! I thuaj gruas, të mos e heqë tenxheren nga zjarri dhe bukën nga furra derisa të vij unë!” Pastaj, u kthye nga sahabët dhe u tha:

“Ngrihuni!” Muhaxhirët dhe Ensarët u ngritën të gjithë përnjëherë. Kurse Xhabiri (r.a.), i shqetësuar, shkoi tek gruaja dhe i tha:

“Të mjerët ne ç’na gjeti! Po vjen Pejgamberi (a.s.), së bashku me Muhaxhirët, Ensarët dhe të tjerët që ishin me ta.” Gruaja i tha:

“A të pyeti se sa ushqim keni?”

“Po më pyeti!” tha Xhabiri (r.a.). Pas kësaj, kjo grua e urtë, e qetësoi burrin e saj duke i thënë:

“Atëherë s’ke përse shqetësohesh!”

Pa kaluar shumë, ia behën sahabët. Pejgamberi (a.s.), u tha:

“Hyni dhe mos e shtrëngoni njëri-tjetrin!”

Resulullahu (a.s.), këput një copë buke, i vë mish sipër dhe për çdo herë e mbyll tenxheren dhe furrën, pastaj ua jepte sahabëve. Ai vazhdoi të këpuste bukë dhe të vendoste mish, derisa u ngopën të gjithë. Më në fund, ngeli edhe pak prej ushqimit. Pejgamberi (a.s.), i tha gruas së Xhabirit (r.a.):

“Haje këtë, gostit edhe fqinjët, sepse uria i ka këputur të gjithë!”¹¹

Në lidhje me çështjen e vendosjes së vëllait të fesë para vetes, duke thënë, **“më parë vëllai im”**, kemi edhe një tablo tjetër nga *“Epoka e Lumturisë”*, ku Ibn Omeri (r.a), ka thënë këto fjalë shumë kup-timplote:

“Ne kemi parë kohë të tilla, kur askush prej nesh nuk mendonte se e meritonte arin dhe argjendin më shumë se vëllai i tij mysliman. Ndërsa tani, jemi në një kohë, kur e duam arin dhe argjendin më shumë se vëllain tonë mysliman.” (Hejthemi, X, 285.)

Në kohën tonë, kur në shoqëri, ekuilibri materie-shpirt është prishur në dëm të shpirtit, në dashurinë ndaj besimit po përjetohej erozione të shpejta

dhe shpirtat kanë pësuar çarje të thella, kjo tablo, merr një formë edhe më të mjerueshme. Për hir të gjërave të vogla dhe interesave materiale, ndërmjet besimtarëve ka hyrë urrejtja dhe ftohtësia; ndërsa si pasojë e injorancës, egoizmit dhe pandjeshmërisë, vëllazëria islame ka pësuar dëme të mëdha.

Udhëzuesi ynë Pejgamberi (a.s.), urdhëron që besimtarët të ndërtojnë një atmosferë dashurie të sinqertë duke i dhënë përparësi njëri-tjetrit para vetvetes. Mirëpo, edhe dashuria nuk duhet të jetë thjeshtë një pretendim i thatë. Pa i qarë hallet vëllait dhe pa ndarë me të vështirësitë e tij, pa ia falur gabimet dhe pa sakrifikuar të drejtën tënde, nuk mund të bëhet fjalë për dashuri të vërtetë.

Në bazë të kësaj, vëllazëria fetare duhet të përjetohej me shfaqje konkrete të dashurisë dhe jo vetëm me pretendime dashurie që shprehen vetëm me fjalë dhe pa vepra. Besimtarët e devotshëm, të cilët kanë arritur të tregojnë konkretisht dashurinë e tyre, përgëzohen me nderin e madh të të qenit vëllezër të Pejgamberit tonë (a.s.).

Një ditë, Pejgamberi (a.s.), tha:

“Do të kisha shumë dëshirë t’i shihja vëllezërit e mi. Sa më ka marrë malli për ta!”

Sahabët që ndodheshin aty pranë, thanë:

“Po ne, a nuk jemi vëllezërit o tu, O Resulullah” Pejgamberi (a.s.), përgjigjet: *“Ju jeni shokët e mi. Kurse vëllezërit e mi, janë ata që nuk kanë ardhur ende(në jetë).”* (Muslim, Taharet, 39, Fedail, 26.)

Për të merituar dashurinë dhe përgëzimin **“vëllezërit e mi”** të Pejgamberit tonë (a.s.), është e domosdoshme që të merremi me hallet e popullit dhe t’u shërbejmë vëllezërve tanë. Kjo, sepse shërbimi ndaj robit, është si shërbimi ndaj Allahut Teala; ndërsa shërbimi ndaj popullit, është si shërbimi ndaj Pejgamberit tonë (a.s.).

Zoti ynë na bëftë prej robërve të lumtur që marrin përgëzimin e çlirimit prej përgjegjësisë vëllazërore, duke respektuar ashtu siç duhet të drejtat vëllazërore! Po ashtu, i mbushtë zemrat tona me frymëzimin shpirtëror të vëllazërisë fetare!

Amin!

11. Shih. Buhari, Megazi, 29; Vakidi, II, 452.



Dhuratat dhe përgëzimet që erdhën nga Miraxhi i Pejgamberit

(sal-lallahu alejhi ve sel-lem)

.....
﴿ Irfan Ežtyrk ﴾
.....

Në uljet që bëjmë përgjatë namazit themi lutjen “et-tehijjatu”. Tehijjati ka ndodhur një vit para hixhretit në ngjarjen e Miraxhit që u realizua natën e njëzet e shtatë të muajit Rexhep. Kur të Dërguarit të Allahut (a.s.), në Qabe-Kavsejn iu bë me shenjë: (Jepi salam Zotit tënd!” Pejgamberi, (a.s.), tha: “Et-tehijjatu lil-lahi ve’s-salavatu ve’t-tajjibat.” Allahu i Lartësuar ia ktheu: “Es-selamu alejke ejuhe’n-nebijju ve rahmetullahi ve berakatuh.” I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, menjëherë tha: “Es-selamu alejna ve ala ibadi’l-lahi’s-salihin.” Sapo engjëjt e dëgjuan këtë dialog, menjëherë thanë: “Eshhedu en la ilahe il-lall-llah ve eshhedu enne Muhammeden abduhu ve Rasuluh.”

Ja, kështu ishte i mbushur miraxhi me shfaqje madhështore! Nata e mirë e dytë që do ta arrijmë në tre muajt e shenjtë është nata e njëzet e shtatë e muajit Rexhep. Në këtë natë duhet të meditojmë

rreth kësaj mirësie të madhe hyjnore, rreth nderimit të të Dërguarit të Allahut (a.s.), te Allahu Teala dhe rreth mahsherit (tubimit të madh në Ditën e Gjykimit) që duhet ta kujtojmë nëpërmjet miraxhit. Allahu i Madhëruar thotë kështu për ngjarjen e Israsë, që është fillimi i miraxhit: **“I lavdëruar qoftë Ai që e mbarti robin e Tij (Muhamedin) natën nga Xhamia e Shenjtë (në Mekë) në Xhaminë e Largët (të Jeruzalemit), rrethinën e së cilës e kemi bekuar, për t’i treguar atij disa nga mrekullitë Tona. Ai, me të vërtetë, dëgjon çdo gjë dhe sheh çdo gjë.”** (Isra, 1)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), e tregon kështu këtë ngjarje madhështore: “Unë isha në vendin Hatim të Qabesë në një gjendje ndërmjet gjumit dhe zgjimit... Pranë meje u soll një kafshë e bardhë më e madhe se gomari dhe më e vogël se mushka. Ky ishte Buraku. Ai ecte duke e hedhur këmbën e parë në pikën më të fundit që i shikonte syri. Mua më hipën mbi të. Në këtë mënyrë, Xhebraili, (a.s.), më shpuri.

Shkuam deri në qiellin e kësaj bote. Ai kërkoi që të hapej dera. Atij iu tha: “Kush është?” Ai tha: “Jam Xhibrili!” Atij iu tha: “Kush është bashkë me ty?” Ai tha: “Është Muhamedi, alejhi’s-selam.” Atij iu tha: “A i është dërguar atij ftesa për miraxh?” Xhebraili (a.s.), tha: “Po!” Atij iu tha: “Mirë se ka ardhur! Sa ardhje e mirë që është kjo!” – dhe dera u hap. Pasi e kaluam derën, aty pashë Ademin, (a.s.). Më thanë: “Ky është babai juaj, Ademi! Jepi salam atij!” Unë i dhashë salam. Edhe ai ma ktheu selamin. Pastaj më tha: “Mirë se erdhe bir i mirë! Mirë se erdhe Pejgamber i mirë!” Pastaj Xhebraili më ngjiti lart dhe shkuam në qiellin e dytë. Këtu u takova me Jahjanë dhe Isain, alejhime’s-selam. Ata kanë qenë djem tezezesh.

Pastaj Xhebraili më nxori në qiellin e tretë dhe aty u takuam me Jusufin, (a.s.). Në katin e qiellit të katërt u takuam me Idrisin, (a.s.), në katin e qiellit të pestë u takuam me Harunin, (a.s.), në katin e qiellit të gjashtë u takuam me Musain, (a.s.). Ai më tha: “Mirë se erdhe vëlla i mirë! Mirë se erdhe Pejgamber i mirë!” Pasi e kalova atë, ai qau. Atij iu tha: “Përse po qan?” Ai tha: “Sepse pas meje erdhi një Pejgamber i ri. Ata që do të hyjnë në xhenet prej umetit të tij janë më shumë se ata që do të hyjnë në xhenet nga umeti im!” Ai u brengos për shkak të mirësisë që nuk e arriti dot. Pastaj Xhebraili (a.s.), më nxori në qiellin e shtatë dhe aty u takuam me Ibrahimin, (a.s.). Xhebraili, (a.s.), më tha: “Ky është babai yt, Ibrahim. Jepi salam atij!” Unë i dhashë salam. Edhe ai ma ktheu selamin. Pastaj më tha: “Mirë se erdhe biri im i mirë! Mirë se erdhe Pejgamber i mirë!” Pastaj më tha: “O Muhamed! Jepi salam umetit tënd nga unë dhe njoftoje se toka e xhenetit është shumë e bukur, uji është shumë i ëmbël, sipërfaqja është mjaft e gjerë dhe e sheshtë. Gjithashtu u thuaj që të mbjellin shumë pemë. Pemët e xhenetit përbëhen nga fjalët “Subhanallahu ve’l-hamdu lil-lahi ve la ilahe il-lall-llahu vall-llahu ekber!” Pastaj më nxorën te Sidretu’l-Munteha.

Frutat e saj ishin të mëdhenj si kanat e Hexherit (Jemenit). Ndërsa gjethet ishin si veshët e elefantit. Xhebraili (a.s.), më tha:

“Ja, kjo është Sidretu’l-Munteha!” Aty kishte katër lumenj. Dy prej tyre ishin të fshehtë dhe dy të tjerët ishin të qartë. Xhebrailin e pyeta: “Çfarë janë këta, o Xhebrail?” Xhebraili, (a.s.), më tha: “Këta dy lumenjtë e fshehtë janë dy lumenjtë e xhenetit. Ndërsa njëri prej të qartëve është Nili, e tjetri është Eufirati!” (Buhari, Bed’u’l-Halk, 6; el-Enbija, 22, 43; Menakibu’l-Ensar, 42; Muslim, Iman, 264; Tirmidhi, Tefsir, 94, Deavat, 58; Nesai, Salat, 1; Ahmed, V, 418.)

I Dërguari i Allahut (a.s.), e vështroi xhenetin dhe xhehenemin nga një pikë në të cilën bashkohet e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja. Ai (a.s.), shprehet: “Në natën e miraxhit pashë këtë fjalë të shkruar mbi derën e xhenetit: “Lëmosha do të shpërblehet me dhjetë fish, ndërsa borxhi me tetëmbëdhjetë fish.” Unë e pyeta Xhebrailin: “O Xhebrail! Përse gjëja e dhënë borxh është më e lartë se lëmosha?” Ai m’u përgjigj: “Sepse lypësi (në shumicën e rasteve) kërkon lëmoshë edhe pse ka para. Ndërsa ai që kërkon borxh, e bën këtë për shkak të nevojës.” (Ibn Maxhe, Sadakat, 19.) Në Sidretu’l-Munteha Xhebraili, (a.s.), më tha: “O i Dërguari i Allahut! Këtej e tutje do të shkosh vetëm!” I Dërguari i Allahut (a.s.), e pyeti: “Përse, o Xhebrail?” Ai iu përgjigj: “Allahu i Lartësuar më ka dhënë leje për të dalë vetëm deri këtu. Nëse hedh një hap përpara nga këtu, digjem dhe bëhem pluhur!..” (Razi, XXVIII, 251.)

Allahu Teala thotë për miraxhin në Kuranin Fisnik: **“Beto hem në yllin kur perëndon, se shoku juaj (Muhamed Mustafai), nuk ka humbur e nuk ka devijuar! Ai nuk flet sipas qejfit të vet, por ajo (që thotë) është vetëm shpallje hyjnore, që i vjen atij. Atë ia ka mësuar atij një (engjëll) shumë i fuqishëm (Xhebraili), mendjelartë, që iu paraqit qartë në horizontin më të lartë.”** (Nexhm, 1-7) **“Pastaj iu afrua e iu lëshua.”** (Nexhm, 8) **“Largësia (ndërmjet Muhamed Mustafait dhe Zotit ishte sa largësia) midis dy harqeve ose edhe më afër.”** (Nexhm, 9) **“Allahut i shpalli robit të Tij, atë që i shpalli.”** (Nexhm, 10)

Në një hadith fisnik që transmetohet në Sahihun e Muslimit, thuhet: “Të Dërguarit të Allahut (a.s.), iu dhanë tri gjëra (në mi-

raxh): Pesë vaktet e namazit, fundi i sures Bakara dhe lajmi se do t'u falen mëkatet e mëdha atyre që nuk bien në shirk prej ume-tit të tij..." (Muslim, Iman, 279.) **"Zemra** (e Muhamed Mustafait) **nuk gënjen për atë që ka parë. Vallë, a do ta kundërshtonit atë për çfarë ka parë, ndërkohë që ai e ka parë atë edhe një herë tjetër, te Sidretul Muntehaja, ku ndodhet Xheneti i Strehimit. Kur Sidrën çfarë nuk e mbulonte?!"** (Nexhm, 12-16)

Krenaria e Gjithësisë, i Dërguari i Allahut (a.s.), u pyet: "O i Dërguari i Allahut! Çfarë pe që e kishte mbuluar Sidrën?" Ai u përgjigj: *"Pashë se atë e kishin mbuluar fletë prej floriri dhe në çdo gjethe të saj qëndronte një engjell që i bënte dhikër Allahut."* (Taberi, XXVII, 75; Muslim, Iman, 279.) Sipas transmetimit të Ibn Abbasit, radijallahu anhum, Allahu Teala e ka shpërblyer Musain (a.s.), me të folurit, Ibrahimin (a.s.), me miqësinë dhe Muhamed Mustafain me shikimin e Tij (shikimin e Zotit të Lartësuar në një formë të panjohur prej nesh)." (Taberi, XXVII, 64.) Sipas një transmetimi tjetër që vjen nga Ibn Abbasi (r.a.), i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë: *"Unë e pashë Zotin e Lartësuar!"* (Ahmed, I, 285; Hejsemi, I, 78.) Në një transmetim tjetër, i Dërguari i Allahut (a.s.), i përgjigjet kështu pyetjes "A e ke parë Zotin?": *"Unë kam parë një Dritë!"* (Muslim, Iman, 292.)

O vëlla! Allahu i Madhëruar do t'ua mundësojë edhe besimtarëve që ta shohin bukurinë e përsosur të Tij në xhenet. Për t'u bërë prej atyre që do ta shohin Allahun në atë ditë takimi, duhet të mos ndahemi nga gjurmët e të Dërguarit të Tij (a.s.). Mbi të gjitha, ne duhet të largohemi sikur ikim nga zjarri prej këtyre gjendjeve që na ka ndaluar:

I Dërguari i Allahut (a.s.), në miraxh kaloi nga disa njerëz. Aty vuri re se buzët e tyre ishin si buzët e devesë. Atyre njerëzve u prisnin buzët dhe u fushin gurë në gojë. Ai e pyeti Xhebrailin (a.s.): "O Xhebrail! Kush janë këta?" Xhebraili, (a.s.), iu përgjigj: "Ata janë ngrënësit e pasurive të jetimëve me pa të drejtë!" (Taberi, XV, 18-19.) Pastaj i Dërguari i Allahut, (a.s.), kaloi pranë disa njerëzve të tjerë. Ata i gërvishtnin fytyrat dhe kraharorët

e tyre me thonj prej bakri. Pejgamberi (a.s.), e pyeti Xhebrailin (a.s.): "O Xhebrail! Kush janë këta?" Xhebraili, (a.s.), iu përgjigj: "Këta janë ata që hanë mishin e njerëzve (duke i përgojuar) dhe që luajnë me nderin e namusin e tyre." (Ebu Davud, Edeb, 35/4878.) Më tutje i Dërguari i Allahut (a.s.), i pa imoralët si fatkeqë që hanin fëlliqësira, i pa ngrënësit e kamatës në një gjendje të poshtëruar me bark shumë të fryrë dhe sikur t'u kishte hyrë shejtani, i pa gratë, të cilat bëjnë imoralitet dhe që i vrasin fëmijët e tyre, një pjesë të varura nga gjokset dhe një pjesë tjetër të varura me kokë poshtë. (Shik. Taberi, XV, 18-19.)

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë edhe në një hadith tjetër fisnik: *"(Përgjatë Miraxhit ndalova te dera e xhenetit dhe pashë brenda. Shumica e atyre që kishin hyrë aty përbëhej nga të varfrit. Të pasurit ishin të burgosur (për të dhënë llogari). Ndërsa për ata që ishin banorë të xhehenemit prej këtyre, u urdhërua që të hidheshin në xhehenem. U ndalova edhe te dera e xhehenemit. Shumica e atyre që kishin hyrë aty përbëhej prej grave."* (Buhari, Rikak, 51; Muslim, Zuhd, 93.)

I Dërguari i Allahut (a.s.), na e ka tërhequr vërejtjen kështu, ngaqë i ka dëshmuar këto pamje të tilla: *"Sikur të dinit atë që di unë, patjetër do të qeshnit pak dhe do të qanit shumë!"* (Buhari, Tefsir, 5/12.)

O vëlla! Këto gjendje për të cilat na ka njof-tuar i Dërguari i Allahut (a.s.), do të përjetohen një nga një. Andaj, le të bëjmë një jetë në përputhje me pëlqimin e Allahut Teala në këtë botë provizore, në mënyrë që të mos poshtërohemi në jetën e përhershme. Namazin, i cili është dhuratë nga Miraxhi, le ta falim me ndjesinë e miraxhit. Gjithashtu, le të përpiqemi t'ua dimë vlerën kësaj nate dhe dhuratave të saj duke u thënë "amin" këtyre lutjeve që ndodhen në fund të sures Bakara: **"...Zoti ynë, mos na ndëshko për atë që harrojmë ose veprojmë pa qëllim! Zoti ynë, mos na ngarko barrë të rëndë, ashtu si i ngarkove ata para nesh! Zoti ynë, mos na ngarko me diçka që nuk mund ta bartim! Na i shlyej gjynahet tona, na i fal ato dhe na mëshiro! Ti je Zoti Ynë! Prandaj na jep fitore kundër atyre që nuk besojnë!"** (Bakara, 286)

Çfarë nevojë ka për ta fshehur Islamin, nderkohë që të privuarit e presin atë!

H. Kybra Ergin

A jeni të informuar rreth aktiviteteve që organizojnë bashkitë në qendrat kulturore? Nëse nuk jeni të informuar, këshilla ime është që të merrni informacion sa më shpejt të jetë e mundur. Jam e sigurt se do të gjeni seminare dhe ligjërata, madje edhe teatro që do t'ju interesojnë. Zgjidhni ndonjërin prej këtyre dhe shkoni për ta shikuar bashkë me familjen tuaj. Në këtë mënyrë, bëni një aktivitet të bukur me bashkëshortin/ten dhe fëmijët tuaj. Përveç të tjerash, merrni edhe informacione rreth të cilave mund të bisedoni më vonë. Njerëzit tanë ikin kur thuhet qendër kulturore, kinema dhe teatër. Sigurisht që kanë të drejtë, sepse deri në një kohë të afërt, këto vende ishin në dorën e një mentaliteti të huaj për popullin e vet, për besimin fetar të popullit dhe për kulturën e tij. Edhe pse akoma kjo klasë ka epërsi në kulturë dhe art, tashmë po edukohen mendimtarë, letrarë dhe artistë edhe nga bota jonë. Ndjekja e këtyre aktiviteteve dhe frekuentimi i tyre është mjaft i rëndësishëm për t'i mbështetur ata, për të shpëtuar nga ekrani i televizorit e internetit dhe për ta edukuar veten tonë në një aktivitet që na jep informacion e kulturë.

Unë vetë banoj në lagjen Fatih. Aktivitetet që organizohen në qendrën kulturore Ali Emiri përpiqem t'i ndjek sa të kem mundësi. Nganjëherë gjej më shumë se ç'pres. Për shembull, në muajt e kaluar, në sajë të një simpoziumi mora informacion në lidhje me një organizatë të quajtur Unioni Mysliman i Evropës (European Muslim Union – EMU).

Qëllimi i formimit të kësaj organizate ishte që evropianët ta njohin Islamin në një formë të saktë dhe ndihma ndaj myslimanëve për të zgjidhur vështirësitë e shumta në fusha të ndryshme të tyre. Formuesi i Unionit ishte një i udhëzuar gjerman i

cili kishte marrë emrin Ebu Bakr pasi ishte bërë mysliman. Tashmë emri i plotë i tij ishte Abu Bakr Rieger.

Pasi bëra disa hulumtime në lidhje me të, lexova këta rreshta në të cilët tregonte historinë e udhëzimit të tij:

“Edhe poeti gjerman Goethe kishte shkruar rreth Islamit dhe i ishte afruar, por nuk ishte bërë dot mysliman, ngaqë nuk ishte ftuar në Islam. Ai i kishte parë njerëzit duke falur namaz e duke kryer ibadetet e tyre dhe ishte ndikuar shumë nga Islami, por thirrja nuk i ishte bërë. Unë jam thirrur në Islam dhe e kam pranuar.”

Për të mos dhënë ndonjë mundësi keqkuptimi e shoh të dobishme që të bëj një shpjegim. Andrea nuk ishte bërë papritur Ebu Bakr. Para së gjithash, kishte studiuar në juridik. Zoti Ebu Bakri ishte një njeri që kishte lexuar filozofi dhe letërsi. Ai nuk e sheh vetëm si tregim të tij udhëzimin e vet dhe thotë:

“Filozofia Evropiane po kërkon Islamin.” Ndër të tjera thotë: “Komunizmi ka marrë fund. Ideologjitë kanë mbaruar. Kapitalizmi është shndërruar në një gjendje shkatërruese nga vetvetja. Çfarë alternative tjetër u ngel njerëzve përveç Islamit?” “Doktrina më e rëndësishme që ndikoi te unë ishte besimi i tevhidit në Islam. Unë kam studiuar shumë, veçanërisht rreth Islamit.”

Krahas këtyre ai na tërheq vëmendjen edhe rreth të vërtetës se besimi nuk është një vendim i dhënë me logjikë, por edhe një tërheqje shpirtërore:

“Shejh Abdulkadir Sufi më njohu me misticizmin Islam. Veçanërisht filozofia dhe poezia gjermane më afruan te Islami.”

“Pasi t’ju tregojnë për madhështinë e Islamit dhe nderin e të Dërguarit të Allahut, alejhi’s-salam, juve nuk ju ngelet derë tjetër (përveçse të pranoni Islamin).”

Ndërsa ajo që më bëri më shumë përshtypje ishin këto fjalë që tha për historinë e udhëzimit të tij: “Myslmanët evropianë më gjetën mua...” “Në fund të debateve dhe diskutimeve, më bindën...” Këto fjali e shtrojnë parasysh nevojën e paralajmërimit me predikim, në mënyrë që njeriu t’i drejtohet synimit të krijimit të tij.

Çështja e predikuesit zë një vend të rëndësishëm ndërmjet temave të shkencës së akaidit dhe kelamit. Siç shpjegohet edhe në çështjen “nevoja për profecinë”, sado që shpirti i njeriut të jetë i gatshëm për ta njohur Krijuesin e tij, për ta mësuar qëllimin e krijimit të tij dhe për ta realizuar këtë qëllim, absolutisht ka nevojë për predikues / thirrës, i cili do të bëhet shkak për udhëzimin, në mënyrë që ai t’ia dalë mbanë kësaj... Edhe në ditët e sotme e shohim qartë se shumica e dërmuese e popullsisë së botës nuk bën kërkime dhe nuk përpiqet për ta bërë jetën të kuptimtë dhe të vlefshme.

Psikologu që ka hedhur mendimin e hierarkisë së nevojave, Maslow thotë se çdo njeri së pari plotëson nevojat materiale të domosdoshme për të qëndruar në jetë dhe pastaj mendon për plotësimin e nevojave psiko-sociale, si besueshmërinë, dashurinë, respektin etj. Pas këtyre shprehet se radha i vjen realizimit të vetes (plotësimit të nevojave shpirtërore), por për shkak të mirëqenies që po shtohet mjaft shpejt në botë, te shumë njerëz, edhe pse i kanë mundësitë për t’i plotësuar këto nevoja, radha nuk i vjen plotësimit të nevojave shpirtërore. Përkundrazi, problemi i cili quhet sindroma e Kalifornisë po përhapet me shpejtësi nëpër botë. Domethënë, shumica e njerëzve po mundohen ta shtypin urinë shpirtërore të tyre me dhënien pas dëshirave epshore, devijim dhe me varësi të tjera radikale e të shumëllojshme. Madje, për shkak të internetit, dhënia pas dëfrimeve dhe argëtimit po përhapet me shpejtësi. Shumica e këtyre njerëzve, për shkak se nuk kanë ndonjë paralajmërues, nuk i drejtohen kërkimit të së vërtetës, në mënyrë që ta shërojnë gjendjen e tyre shpirtërore në depresion, sepse njeriu, aktivitetet e të mësuarit i vazhdon me metodën e marrjes së kulturës nga mjedisi në

të cilin ndodhet nëpërmjet imitimit jo vetëm kur është fëmijë, por përgjatë gjithë jetës. Për këtë arsye, edhe vazhdimin e jetës, edhe metodat për ta bërë jetën të vlefshme i mëson nëpërmjet imitimit nga mjedisi në të cilin gjendet. Shumica dërmuese e njerëzve nuk i sitin me sitën e kritikës ato që u thuhet dhe as që kërkojnë për më të mirën. Madje, lehtësisht mund të themi se shumica ka një strukturë që e lejon të rezistojë kundër atyre që u sjellin ndonjë lajm të ndryshëm nga gjërat me të cilat është ushtruar.

Atëherë, predikimi i fesë, domethënë, rëndësia e detyrës për t’ua çuar njerëzve dritën e të vërtetës që Allahu Teala na e ka predikuar nëpërmjet të Dërguarit të Tij, nuk mund të diskutohet, sepse për përvojën që ka përjetuar zoti Ebu Bakri, kanë nevojë gjashtë miliardë njerëz që jetojnë në këtë botë.

Por për fat të keq, njëri prej problemeve më të mëdha të shekullit në të cilin jetojmë është se popujt myslimanë kanë filluar të formojnë struktura xhematësh duke u bazuar në medhhebe të ndryshme dhe si rezultat, të kalojnë në ifrat e tefrit për shkak të akumulimit që e kanë sjellë nga historia dhe për shkak të metodave për të luftuar me sprovat nëpër të cilat po kalojnë...

Ngaqë një shkrim nuk mund t’i nxërë shembujt e shumë të ifratit dhe tefritit, më mirë le të vërtetojmë se cila është metoda e saktë e predikimit. Pas kësaj vëmë re se çështja më e rëndësishme në predikim është të shprehurit e së vërtetës duke mos pasur frikë nga asnjë. Në ajetin fisnik, të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), i thuhet:

“O i Dërguar! Trego atë që të është shpallur nga Zoti yt! Në qoftë se nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke përcjellë Mesazhin e Tij; Allahu të ruan ty prej njerëzve. Natyrisht që Allahu nuk i udhëzon njerëzit që nuk besojnë.” (Maide, 67) Në këtë mënyrë, i Dërguari i Allahut (s.a.s.), urdhërohet që të mos ketë frikë nga njerëzit, të mos fshehë ndonjë gjë që nuk u pëlqen atyre dhe ta predikojë të vërtetën pa përdorur ndonjë hipokrizi.

Nëse i radhisim në mënyrë të krahasuar specifikat e fesë islame, do të shohim që specifika më e rëndësishme është se Islami nuk është si ndonjë tarikat, subjekt politik apo *ekol filozofik* që ka formuar ndonjë prej njerëzve. Islami është feja e Allahut. Kjo nxjerr në pah domosdoshmërinë që kjo fe t’u shpjegohet në mënyrë të qartë të gjithë robërve

**“O i Dërguar!
Trego atë që të është shpallur
nga Zoti yt! Në qoftë se nuk
e bën këtë, atëherë nuk e
ke përcjellë Mesazhin e Tij;
Allahu të ruan ty prej njerëzve.
Natyrisht që Allahu nuk
i udhëzon njerëzit
që nuk besojnë.”**

të Allahut Teala. Ndërsa çështja se kush do ta pranojë dhe kush do ta refuzojë, nuk është një çështje që i përket predikuesit. Në fakt, edhe fjala predikim tregon se predikuesi nuk ka ndonjë përgjegjësi në këtë çështje. Përveç të tjerash, këtë mendim e përforcojnë edhe ajetet si: **“Ti ke për detyrë vetëm predikimin.”**

Gjithashtu, të gjitha ajetet që kanë të bëjnë me urdhrin e predikimit nxjerrin në pah të vërtetën se predikimi nuk bëhet, në mënyrë që t'u pëlqejë atyre që u predikohet dhe se predikimi nuk e mbart një kusht të tillë. Madje, ajeti i mëposhtëm, është inkurajues për ta thënë të vërtetën haptazi edhe nëse njerëzit nuk e pëlqejnë:

“Ti prediko haptazi atë që të është urdhëruar (domethënë, predikoj haptazi atë që je urdhëruar me një këmbëngulje të vërtetë dhe duke mos hezituuar nga asgjë, edhe nëse atyre u dhemb apo u plas koka) **dhe largohu nga idhujtarët** (Mos ua vër veshin fjalëve të tyre dhe mos u jep rëndësi atyre dhe atyre që bëjnë). **Ne të mjaftojmë ty kundër atyre që të tallin.”** (Hixhr, 94-95)

Shpjegimet brenda në paranteza që kanë të bëjnë me komentimin e ajetit, reflektojnë mrekullitë letrare të tekstit origjinal në arabisht dhe janë marrë nga tefsiri i të ndjerit Elmallëllë Hamdi Jazërit. Sipas një transmetimi, kur i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, e lexoi këtë ajet, një beduin që e dëgjoi ra në sexhde. Atyre që e pyetën: “Mos besove vallë?” – ua ktheu: “Nuk e mbajta dot veten përballë letërsisë që reflekton ajeti.” Ky është një paralajmërim që me të vërtetë është bërë pa ndonjë hezitim dhe pa ndonjë frikë, sepse është bërë nga Zoti (xh.xh.). Prandaj, ndikimi që ngjall te njerëzit del në pah duke i detyruar ata që të bëjnë sexhde instinktivisht dhe me plot frikë kundrejt Allahut të Lartësuar, sepse këto ajete janë një ftesë e Krijuesit që ia ka dërguar krijesës së tij. Ftesa që vjen nga një pozitë kaq e lartë duhet t'i mbartë shenjat e madhësisë dhe lartësisë që i kanë hije. Ja, shprehja: “Mos i jep rëndësi nëse besojnë apo jo!..” – është një shenjë e qartë pikërisht e kësaj madhësie. Të gjithë ata që e kanë lexuar Kuranin Fisnik kanë thënë se janë ndikuar nga madhështia në metodën e tij dhe se kanë ndjerë besim e siguri ndaj mënyrës së qartë të shprehurit, sepse ajo është larg një gjuhe propagandistike e gjarpëruese.

Këto shprehje, përveç të tjerash, japin një detaj të rëndësishëm për sa i përket çështjes së sjelljes që duhet të shfaqë predikuesi. Kjo sjellje, para së gjithash, është një sjellje që duhet ta shfaqë një njeri që i beson plotësisht të vërtetës që predikon. Predikuesi nuk ka ndonjë synim të fshehtë apo ndonjë interes që synon ta arrijë duke i bërë njerëzit të besojnë dhe duke i bindur ata. Atij i mësohet sjellja që i ka hije duke qenë i sigurt se do ta marrë shpërblimin nga

Zoti (xh.xh.), për punën që ka bërë edhe nëse nuk i beson askush. (Shuara, 109, 127, 145) Ky është edhe kuptimi që shprehet në ajete të ndryshme si:

“Prandaj këshilloji (njerëzit o Muhamed), **se ti je vetëm këshillues dhe nuk je ngarkuar t'i detyrosh ata me forcë!”** (Gashije, 22-23)

“S'ka detyrim në fe, sepse tashmë është dalluar e drejta nga e shtrembra! Ai që mohon idhujt (dhe gjithçka që adhurohet në vend të Allahut) **dhe beson në Allahun, ka siguruar lidhjen më të fortë, e cila nuk këputet kurrë. Allahu dëgjon dhe di gjithçka.”** (Bekare, 256)

Për këtë arsye, predikuesi nuk ka ndonjë dëm nëse njerëzit besojnë apo jo. Ai që beson, beson për veten e tij. Ndërsa ai që mohon, mohon duke i bërë dëm vetes së tij.

Krahas të gjitha këtyre, në ajetet fisnike tregohet se një thirrës që i fton njerëzit në shpëtim është shumë i mëshirshëm ndaj atyre që i fton dhe ndjen shumë dhembshuri për ta. Edhe pse nuk është detyrë e predikuesit, ai përpëlitet deri në atë masë, sa që mund ta shkatërrojë veten, në mënyrë që njerëzit të besojnë dhe të shpëtojnë.

Siç tregohet në ajete të ndryshme të Kuranit Fisnik, qëllimi i dërgimit të Pejgamberit (s.a.s.), është që njerëzit të bëhen të dashur te Allahu Teala duke e pasuar atë dhe si rezultat, të bëhen të lumtur përjetësisht në xhenetin e Tij. Meqë qëllimi përfundimtar i thirrjes dhe udhëzimit është mirësia e njerëzve, atëherë, kjo duhet të bëhet me një metodë që i ka hije. Nisur nga kjo, edhe pse i Dërguari i Allahut (s.a.s.), urdhërohet që të mos tolerojë në dispozitat e fesë, prapë se prapë urdhërohet që “të thotë fjalë të buta” (Taha, 44), “të këshillojë me urtësi” (Nahl, 125) dhe “me fjalë ndikuese” (Nisa, 63).

Në ajetet të ndryshme, gjithashtu thuhet se i Dërguari i Allahut (s.a.s.), së pari është “beshir”, domethënë, përgëzues me lumturinë e përhershme dhe pastaj “nedhir”, domethënë, paralajmërues e qortues për ata që nuk pranojnë:

“Ne të kemi dërguar ty me të Vërtetën, për të sjellë lajme të mira dhe për të paralajmëruar; nuk ka pasur asnjë popull që të mos i ketë ardhur paralajmërues.” (Fatir, 24)

Ata që i kanë numëruar fjalët e Kuranit Fisnik kanë dëshmuar se falja e mëshira përmenden më shumë se ndëshkimi dhe dënimi. Prandaj edhe predikuesi duhet ta reflektojë këtë në metodën e thirrjes së tij. Gjithashtu, ai duhet të jetë përgëzues dhe sihariqdhënës në metodën e tij me kusht që të shprehet haptazi dhe të jetë i qëndrueshëm. Shkurtimisht, predikuesi duhet të përpiqet vetëm që ta shpjegojë Islamit siç është dhe ta shpjerë atë te njerëzit.

Ummu Halid

(RADIJALLAHU ANHA)

Mustafa Erish

Ummu Halid, (r.a.), ishte një zonjë e nderuar, e cila lindi dhe u rrit në një familje myslimane, që luftoi kundër idhujtarëve të Mekës për të jetuar të lirë besimin e tyre dhe që më në fund emigruan në Etiopi!..

Një zonjë fatlume, e cila ndodhej në grupin që i solli Pejgamberit tonë (a.s.), selamet e sundimtarit të Etiopisë!..

Një zonjë e devotshme, së cilës Resulullahu (a.s.), i dhuroi një rrobë që i kishte dërguar dikush!..

Bashkëshortja e sahabiut të njohur Zubejr ibn Avvami (r.a.), i cili ishte një prej sahabëve të përgëzuar me xhenet!..

Ajo lindi në Etiopi. Emri i saj i vërtetë, ishte Emet, ndërsa “Ummu Halid”, ishte emri me të cilin u bë e njohur më vonë. Babai i saj ishte Halid bin Saidi (r.a.), ndërsa nëna e saj, Humejne (r.anha). Nëna dhe babai i saj ishin në grupin e parë që emigroi në Etiopi. Ummu Halidi (r.a.), lindi atje pas emigrimit dhe qëndroi aty deri në moshën e rinisë.

Ummu Halid (r.anha), ishte një zonjë fatlume e cila udhëtoi nëpër det me grupin që i solli Pejgamberit tonë (a.s.), selamet e sundimtarit të Etiopisë, Nexhashiut. Ky udhëtim u zhvillua kështu:

Ummu Habibe (r.anha), e cila ndodhej në Etiopi, nuk iu nënshtrua burrit të saj që tradhtoi fenë dhe nuk lëshoi pe nga besimi i saj. Pas vdekjes së burrit të saj, ajo ngeli e vetmuar. Resulullahu (a.s.), dëshiroi të martohej me këtë zonjë me besim të palëkundur. Për këtë arsye, ai i dërgoi një letër Nexhashiut, i cili ia plotësoi menjëherë dëshirën.

Nëna jonë Ummu Habibe (r.anha), kishte caktuar si kujdestar të saj, babanë e Ummu Halid (r.a.), Halid ibn Sadin (r.a.). Ndërsa Nexhashiu, u lidhi kurorën, përgatiti shumë dhurata dhe, duke formuar një grup prej myslimanëve, i dërgoi ato në Arabi me një anije të posaçme.

Nexhashiu, shkoi personalisht tek moli dhe e përcolli grupin, duke u thënë: “Të gjithë çojini selamet e

mia të Dërguarit të Allahut”. Edhe Ummu Halid binti Said (r.a.) ishte në mesin e tyre.

Kur Ummu Halid (r.a.), erdhi në Arabi, shkoi të vizitonte Pejgamberin (a.s.), së bashku me babain e saj. Ajo, në lidhje me këtë ngjarje, tregon:

“Unë, së bashku me babain tim, shkua me vizitimet Resulullahun (a.s.). Unë kisha veshur një rrobë me ngjyrë të verdhë. Pejgamberi (a.s.), duke bërë me shenjë rrobën time, tha: “Seneh! Seneh!..” Kjo, në gjuhën Etiopase, do të thoshte, “e bukur, e bukur!”¹. Pra, në këtë mënyrë ai na uroi.”

Pejgamberi (a.s.), i kishte ngopur të gjithë sahabët me dashurinë e vet. Ai gjithmonë gjente rastin e volitshëm për t’i uruar ata dhe dhuratat që i vinin, gjithmonë ua jepte atyre. Një ditë, i kishin sjellë disa veshje. Midis tyre, gjendej edhe një veshje me ngjyrë të zezë që ngjante si një flamur. Edhe këtë, do t’ia jepte një sahabeje, por kujt?.. Pikërisht, në lidhje me këtë ngjarje, Ummu Halid (r.anha), transmeton këtë hadith:

“Rasulallahut (a.s.), i kishin sjellë një veshje të zezë me pulla. “Kujt thoni se do t’i shkonte kjo”, tha ai. Ata që ishin përreth, heshtën dhe askush nuk nxori zë. Pejgamberi (a.s.), tha: “Më sillni Ummu Halid!” Më çuan pranë tij. Ndërsa ai, mori rrobën dhe me dorën e vet e hodhi mbi mua. Pastaj tha dy herë rresht: “E vjetërsofsh duke e veshur, e vjetërsofsh duke e veshur!”

Ai shihte pullat me ngjyrë të verdhë e jeshile mbi copën e zezë dhe duke bërë shenjë me dorë, tha:

“O Ummu Halid! Seneh!.. Seneh!.. Bukur!.. Bukur!..”

Ummu Halid (r.anha), u martua me sahabin e njohur Zubejr ibn Avvam (r.a.), i cili ishte edhe një prej sahabëve të përgëzuar me xhenet. Nga kjo martesë, lindën dy djem, Halidi dhe Omeri. Pas kësaj, ajo u bë e njohur me emrin Ummu Halid (nëna e Halidit).

Allahu qoftë i kënaqur prej saj. Amin!

1. Shih. Buhari, Libas 22, 32,188; Menakibu'l-Ensar 37, Edeb 17; Ebu Daud, Libas 1.



Hija e shpresës

Edison Çeraj

Mund të themi se tashmë është fakt që përherë e më shumë njerëz anekënd botës po humbasin besimin (që e kishin me aq tepri prindërit dhe gjyshërit e tyre) se e ardhmja do jetë më e mirë se e tashmja. Kjo do të thotë se, për pasojë, edhe zhgënjimi është i konsiderueshëm. Të gjithë e dimë se numri i njerëzve të vetmuar e të braktisur është një alarm dërrmues. Vetëvrasjet gjithë po aq. Pa harruar kasaphanat në emër të sigurisë/paqes, sido që një çështje më vete.

Në pamje të parë, kjo mungesë besimi dhe ky zhgënjim duket sikur adresohet vetëm te drejtues shtetesh, apo te klasa politike në përgjithësi. Por, në thelb, kjo është një mungesë besimi e secilit nga ne në raport me veten më së pari. Në fakt, kemi kohë që nuk rrimë me veten, dhe pohimi i sapobërë mund të na duket çudan apo që ka të bëjë me tjetrin (ose me Tjetrin) e jo me ne. A nuk është thënë e provuar kaq shumë herë në të shkuarën e në të tashmen se çdo vend meriton ata drejtues që ka!? Afërmendsh, pasi drejtuesit e një vendi janë produkt i atij vendi; nuk kanë zbritur as nga Hëna e as nga Marsi. Me pak fjalë, ajo që është më e rëndë-

sishmja është se drejtuesit janë pasqyra e njerëzve mbi të cilët udhëheqin, si dhe *vice versa*.

Besimi tanimë i djeshëm se e ardhmja do jetë më e mirë se e tashmja, lidhej ngushtë me mitin modern që e quajmë shkencë, dhe më në veçanti me një pjellë të këtij miti: me teknologjinë, që ka dalë jashtë kontrolli duke ushtruar gjithnjë e më shumë kontroll.

Por, çdo të thotë të besosh te shkencë? Pse shkencëtarët vazhdojnë të na kërkojnë që të besojmë tek ajo kur ata vetë janë kaq dyshues e nazikë? Si mund të na kërkohet me kaq ngulm propagandistik¹ që të besojmë një të ashtuquajtur teori shkencore kur kjo mund të rrëzohet nga një tjetër nën dritën e “fakteve” të reja? Si i bëhet kur ne e gërvishtim pak syp-rinën e shkencës dhe na del përpara një koleksion përkufizimesh e kuptimesh nga më të ndryshmet që tashmë meritojnë të vendosen në muze? Këto përkufizime dhe kuptime janë të atilla që thonë shumëçka dhe asgjë njëherësh. Dhe rezultati është një konfuzion që injekton mosbesim.

1. Një megaindustri mediatike në dispozicion për të shpërndarë lajme nga shkencë, sikurse ndodh rëndom nga mëngjesi gjer në darkë.

Thuhet shpesh se shkenca merret me faktet, me atë që mund të provohet, që mund të analizohet e paskëtaj të klasifikohet. Por a mund të reduktohet jeta apo njeriu vetëm në fakte materiale? Pse krahas biologjisë kemi edhe letërsinë? A nuk është letërsia një “fakt” i lexueshëm? Si ka mundësi që një shkencëtar si Einstein-i ishte kaq i dhënë pas romaneve të Dostojevskit? Si është e mundur që një personazh imagjinar si Uliksi apo Don Kishoti, të jenë kaq të mirënjohur dhe të ushtrojnë kaq ndikim mbi çdo brez?! Si ka mundësi pra që janë kaq “të gjallë”? Ose në ç’kuptim dhe dimension janë kaq “të gjallë”? Pikërisht praninë e papranishme materialisht të këtij kuptimi kaq të mundshëm hedh poshtë apo lë mënjanë shkenca, por jo detyrimisht edhe shkencëtarit.

E thënë me fjalë të tjera, shkenca operon si një fe e re, pasi ajo na kërkon të besojmë tek arritjet e saj (të diskutueshme apo të mundshme!). Shkenca na kërkon që të mjaftohemi vetëm me “faktet” dhe të mohojmë apo harrojmë çdo gjë tjetër – ja dhe një arsye tjetër e fortë se pse ajo vepron si një fe e re. Ja që shkenca e ngritur në fe qenka opiumi i popujve.

Gabimi ynë ka qenë se ne i kemi besuar verbërisht asaj që do të duhej vetëm ta përdornim, dhe tani jemi në pozitat e të qenit të përdorur. Kështu ne kemi ngritur mitin mbi shkencën, pa të cilin nuk bëjmë dot, nga i cili nuk po çlirohemi dot. Nuk kemi të bëjmë më me një çështje që mbetet në stadin e logjikës, në kuptimin praktik, që ajo na duhet për të bërë këtë apo atë, për të arritur këtu apo atje dhe kaq – por, tashmë jemi në kushtet që kjo “duhet” buron dhe lidhet me diç përtej logjikës; domethënë, tani ka të bëjë me besimin dhe me shpresën.

Duhet theksuar se, tjetër gjë është shpresa e brendashkruar që shoqëron njeriun për një të nesërme më të mirë, dhe tjetër fare është botëkuptimi që “zyrtarizoi” iluminizmi (dhe e provoi me “fakte” Darwin-i) për një të ardhme të ndritur, por që ngrihet mbi mohimin e të shkuarës si e errët. E para është ideologji, që shfaqet në një kohë të caktuar për qëllime të caktuara; e dyta lind bashkë me nje-

2. “Mjerë për faktet!” (Hegel).

riun. Njeriu duhet të shpresojë për të mirën duke qenë i vetëdijshëm për origjinën apo për identitetin e tij, qoftë në kuptimin e ngushtë të këtij të fundit (prejardhja), qoftë në një kuptim më të gjerë (origjina – që e transcendon kohën dhe hapësirën), si dhe duhet ta shoqërojë shpresën me ndërmarrjen e shkaqeve. Ja pse ideologji të caktuara, siç qe dhe është rasti me komunizmin dhe demokracinë, gjejnë përkrahje masive, pasi ato shfaqen e mëkëmben në formë mesianike, duke premtuar një të nesërme më të mirë, ose më të mirën (brave new world), duke përdorur/shfrytëzuar pra shpresën e brendashkruar me të cilën vjen në jetë çdo njeri, për të qenë sa më të besueshme.

Kemi edhe një teologjizim deri në absurd të fesë dhe fetarisë, veçmas të Krishterimit dhe të Islamit, pasojë edhe diktatit që ushtron miti i shkencës, gjë që shumë njerëzve ose u ka hequr ndjeshmërinë dhe kërkshërinë (dy hapat e parë drejt një zbulimi të caktuar) për fenë, ose i ka bërë të ndihen të vegjël e të parëndësishëm. Nuk është fare çudi që kemi kaq shumë fetarë pa fetari³ e kaq shumë jofetarë me fetari.

Sigurisht që këtij diktati nuk i ka shpëtuar as arti, duke u bërë përherë e më i saktë, klinik dhe konvencional/social⁴, e për pasojë anonim⁵ – thjeshtë pjesë e realitetit. Sa më shumë të presim – domethënë, të shpresojmë – se gjërat do përmirësohen vetvetiu me kalimin e kohës, pa luajtur rolin që na takon qoftë edhe nëpërmjet heshtjes, aq më shumë do fundosemi në anonimata, dhe do jenë gjërat (sistemi) ato që do na kushtëzojnë ne në çdo hap. Jo rastësisht ndihemi kaq të kushtëzuar sot.

Hija e shpresës është më e rëndësishme se vetë shpresa.

3. Një karikaturë e llojit të vet.

4. “Në thelb arti është i papërshtatshëm, i padobishëm, antisocial, i rrezikshëm. Dhe kur s’është i tillë, ai është gënjeshtër, manekin.” (Jean Dubuffet)

5. “Arti nuk flet në mënyrë të përgjithësuar për njeriun, por gjithmonë për një njeri të caktuar – fjala vjen, për Oliver Tuistin, për Eugjen Onjeginin, për Fjodor Karamazovin. Bliri që përmend poeti nuk është kurrsesi një bli në përgjithësi, çfarëdo, për të cilin flet botanika, por kurora erëmirë në kopshtin e shtëpisë së poetit, nën hijen e të cilës ai shihte ëndrrat e veta djaloshare. Arti na duket më i vërtetë ngaqë, përnjëmend, të gjitha gjërat që ekzistojnë janë të veçanta.” (Izetbegović)



SHKAQET E MOSSUKSESIT SHKOLLOR

Nuredin Nazarko

Shkollimi i fëmijës në ditët e sotme është një nga sfidat më serioze me të cilën duhet të përballet familja. Kjo, jo thjesht për koston financiare, për të cilën prindërit nuk lënë sakrificë pa bërë që fëmija i tyre, të përfitojë një shkollim të caktuar. Qëllimi përfundimtar i shkollimit është mundësi më të mira punësimi dhe rrjedhimisht jetesë më e mirë. Por që të mbërrijmë tek ky qëllim, duhet kaluar nëpër të gjitha hallkat e sistemit arsimor. Më pas, nëse do të ketë apo jo jetesë më të mirë si shkak i shkollimit është çështje tjetër, natyrisht jo e parëndësishme.

Sfida më serioze e shkollimit lidhet me suksesin e fëmijës në shkollë.

Suksesi i fëmijës në shkollë është dëshira e çdo prindi. Vështirë se gjen prindër që të mos dëshirojnë që fëmija i tyre të mos jetë i suksesshëm përgjatë viteve të shkollimit, edhe pse çdo rregull ka përjashtimet e veta, pasi që konsiderata ndaj shkollimit lidhet edhe me perceptimin që kanë prindërit ndaj vetë shkollimit. Sidoqoftë, dëshira për sukses shkollor mbetet e fortë dhe vazhdimisht prindërit janë këmbëngulës, të paktën teorikisht, që rezultatet

mësimore të fëmijës së tyre të jenë gjithmonë në rritje. Por, përtej pritshmërive prindërore jo gjithmonë ndodh që fëmija të përfjohet sukses shkollor, madje në ditët e sotme për hir të së vërtetës suksesi shkollor i fëmijës është në tkurrje të vazhdueshme, aq sa në raport me të tërën, të suksesshmit zënë një përqindje të ulët.

Rrjedhimisht, përballë këtij shqetësimi, shqetësim që nuk lidhet thjesht dhe vetëm me të tanishmen, por për më tepër me kostot që do të mbajmë në të ardhmen, natyrshëm, kërkohet të dihen shkaqet e këtij mospërfitimi, pasi që askush dhe askujt nuk i pëlqen që të endet në sferën e dështimit apo të cilësohet si një i dështuar.

Por, cilat janë shkaqet e kësaj pasojë kaq të padëshirueshme, dhe kaq prezente në realitetin e sotëm?

Për studiuesin kroat, Prof. Dr. Stanisha Nikoliq, në librin e tij “Bota e psikës fëmijërore”, faqe, 249-252, shkaqet e mospërfitimit shkollor klasifikohen në disa grupe.

Le t'i vështrojmë këto shkaqe, duke i ndërlidhur dhe me realitetin e prekshëm, atë që shohim çdo ditë të angazhimit tonë me shkollimin e brezave të rinj.

NEVOJA PËR SHKOLLIM SPECIAL

Këtu përfshihen ata fëmijë, të cilët për arsye fizike apo mendore nuk arrijnë të përshtaten me mjedisin e zakonshëm shkollor dhe shoqëror. Në pamundësi për të ecur me të njëjtat hapa si bashkëmoshatarët e tyre, kësaj kategorie i duhen krijuar kushtet për shkollim në shkolla speciale që i përshtaten nivelit të zhvillimit të tyre psiko-fizik. Kjo nuk do të thotë që kjo kategori po diskriminohet, por kjo do të thotë që kësaj kategorie po i jepet ajo çka është më e mira për gjendjen e tyre. Do të jetë dështim i plotë për këta fëmijë, nëse do të shkolloheshin në një shkollë të zakonshme, qoftë edhe sikur të kryhet punë e diferencuar nga mësuesit, sepse edhe në këtë rast nuk do të përfitojnë vëmendjen dhe kujdesin e plotë. Në rast se aplikohet arsimi gjithëpërfshirës, kategoria që preket drejtpërsëdrejti nga mospërfitimi shkollor janë pikërisht fëmijët me nevoja speciale, të cilët kanë nevojë për përkushtim dhe vëmendje me kohë të plotë si dhe kanë nevojë të mos ndihen të paaftë në raport me fëmijët normalë, teksa shohin ecurinë shkollore të këtyre të fundit.

ÇRREGULLIMET INSTRUMENTALE

Ndodh që fëmijë të caktuar, qoftë që nga lindja apo nga ndonjë dëmtim i mëvonshëm, edhe pse janë fëmijë inteligjentë të manifestojnë probleme me të folurin, shqiptimin e saktë të tingujve, fjalëve,


shprehje jo me gjuhë të rregullt të mendimeve. Në të tilla raste, nëse nuk merren masat e nevojshme për korrigjim të këtyre defekteve me ndihmë të specializuar për këto raste, edhe kjo kategori mund të përballlet me mospërfitim shkollor. Duke pasur të tilla vështirësi, krijohen kushtet për mosasimilim të duhur të njohurive në shkollë dhe me kohë rritet hendeku mes asaj çfarë do të kishte mësuar në kushte normale dhe asaj çfarë mëson sipas kushteve në të cilat gjendet. Kësisoj, edhe pse inteligjent, nuk do të kishte një ecuri të mirë dhe mund të krijohen kushtet e braktisjes së të mësuarit, për shkak të një paaftësie të korrigjueshme. Prandaj, edhe kjo kategori duhet të trajtohet në përputhje me nevojat që ka, që aftësitë e tyre të mos shkojnë dëm.

MUNGESAT NGA SHKOLLA

Për arsye të caktuara nxënës të caktuar mund të mos prezantohen për një kohë të caktuar në mjedisin shkollor. Nxënësi mund të qëndrojë një kohë të gjatë në spital, mund të jetë i ngujuar për shkak të gjakmarrjes, mund ta jetë larg shkollës për shkak të angazhimit të tij me ndonjë punë të caktuar në ndihmë të familjes, mund të banojë larg shkollës dhe në kohë të caktuara të mos e frekuentojë, apo i lënë në harresë nga angazhimet e prindërve me punë. Kjo është një kategori nxënësish inteligjentë, por që mungesat e gjata në shkollë për arsyet që përmendëm apo dhe për arsye të tjera, sjellin zgjerimin e masës së njohurive të pamësuar, duke krijuar mësim të fragmentarizuar të njohurive, fragmentarizim që nuk i jep mundësinë kësaj kategorie të shfaqet me aftësitë dhe potencialet që zotëron.

GABIMET NË ORIENTIMIN SHKOLLOR

Dëshira për të pasur një shkollim, sidomos në realitetin shqiptar ku kaosi i tranzicionit, mungesa e vizionit dhe psikoza që çdo gjë zgjidhet nga shteti, kanë sjellë pasojë edhe në keqorientimin e shkollimit të fëmijëve nga ana e prindërve. Për prindërit sot në përgjithësi me rëndësi është të përfunduarit, të paktën të shkollimit të mesëm. Fëmijë të caktuar shpesh vazhdojnë arsimin e mesëm të lartë, thjesht sepse këtë e kanë vendosur prindërit apo se nuk shtyhet dita në shtëpi. Me padëshirën për t'u shkolluar shtynë ditët dhe nuk angazhohen në leximin e mësimin e asaj çfarë kërkohet shkollimi në arsimin e mesëm të lartë. Ndërkohë, mund të ishin nxënës pozitivë në një shkollë profesionale. Kështu që për shkak të një orientimi të gabuar në shkollim, ky fëmijë inteligjent kthehet në një fëmijë vegetativ, pa nerv, sepse ajo çfarë i kërkohet të mësojë shkon në kah të kundërt me atë çfarë atij i pëlqen të mësojë, shkon në kah të kundërt me prirjet e tij. Duke u përfshirë në shkollim



të papërshtatshëm për natyrën dhe prirjet e tij, ky fëmijë do ta braktisë të mësuarin dhe thjesht do t'i duhet të shtyjë ditët në shkollë. Dhe e gjithë kjo për shkak të një keqorientimi.

SHKAKTARËT SHOQËRORË DHE FAMILJARË

Edhe këta faktorë janë tepër ndikues në krijimin e gjendjeve që mund të çojnë në mënyrë të pashmangshme drejt mossuksesit shkollor.

Përsa i përket faktorëve shoqërorë, kjo lidhet me raportet që krijon fëmija me mjedisin shkollor dhe me mjedisin shoqëror brenda mjedisit shkollor. Përshtatshmëria e fëmijës me mjedisin e ri, i cili është fare i ndryshëm nga mjedisi familjar, sfidat e shoqërizimit, përballja më vështirësi të pandeshura më parë, të mosqënit i përgatitur emocionalisht për kalimin nga mjedisi familjar në mjedisin shkollor, krijojnë kushte për vështirimin e shkollës si një mjedis i frikshëm, i lodhshëm, i mërzitshëm. Ngritja e një perceptimi të tillë çon në lindjen e ndjenjës edhe të urrejtjes, por edhe të braktisjes së të mësuarit, sepse fëmija i përqëndron energjitë e tij në mbrojtjen e vetvetes nga ky mjedis i papërshtatshëm për syrin e tij, në vend që t'i shpenzojë për mësim. Ky faktor është i lidhur ngushtësisht me atë familjar.


Këtu mund të përballemi me një situatë paradoksale. Si është e mundur që familja të rezultojë një faktor pengues në suksesin shkollor, kur dëshira e tyre është që fëmija të shkëlqejë? Kjo ndodh sepse shpesh familja e gjykon mossuksesin shkollor të fëmijës së vet vetëm si rezultat i problemeve pedagogjike apo si rezultat i punës së dobët nga aparati pedagogjik i shkollës. Këtu del një problem tjetër, tepër i mprehtë, problemi i masës së rolit që ka familja dhe i rolit që ka shkolla në edukimin dhe shkollimin e fëmijës. Para se familja të drejtojë gishtin e akuzës ndaj aparatit pedagogjik për paaftësi, lë të bëjë llogaritë me veten, me mjedisin familjar që ka krijuar për fëmijën e vet, le të bëjë llogaritë me mbështetjen emocionale që i jep fëmijës së vet. A është mjedisi familjar një mjedis ku fëmija gjen paqe pas një dite të lodhshme,

gjen dashuri dhe harmoni pas një dite stresuese, gjen përkujdesje dhe mbështetje për shqetësimet e tij apo injorohet dhe lihet me shokët teknologjikë? Apo mos vallë gjen një mjedis të dhunshëm, me prindër që i shmangen përgjegjësi të të qënit prindër, të dehur apo gjysëm të dehur, apo në vend që ta gjejë prindin në shtëpi e të bisedojë me të i duhet ta takojë tek llojtoja e lagjes, ose ta shkulë me forcë nga shikimi i telenovelës së rradhës? Prandaj familja duhet më së pari të realizojë përgjegjësitë e saj prindërore, sepse kjo është një detyrë e shenjtë dhe jo një lojë në kurriz të krijesave të pafajshme, fajësia e dështimit të të cilëve i adresohet më pas mjedisit shkollor.

SHKAKTARËT PEDAGOGJIKË

Ky faktor mund të shndërrohet në faktor mossuksesiv shkollor sepse më shumë sesa t'i mëshojë njohjes psikologjike të fëmijës i mëshon qëndrimeve të rrepta pedagogjike dhe qëndrimeve unifikuese, duke dashur që të jetë në koherencë me atë çfarë kërkon programi mësimor. Shpesh qëndrimet e rrepta pedagogjike vijnë edhe si rezultat i kohës së pamjaftueshme për t'i kushtuar vëmendje të posaçme nevojave të secilit nxënës brenda një ore të caktuar mësimore. Prandaj duhen riparë programet mësimore, volumi i lëndëve që zhvillohen në shkollë dhe për më tepër i duhet kushtuar vëmendje anës morale dhe konceptuale nga ana e programeve mësimore. Po kështu duhet marrë në konsideratë edhe bota psikologjike e fëmijës, natyrshmëria e tij e pastër sa pa u ndotur me negativitetet që e rrethojnë, në të kundërt programet e ngarkuara, lëndë të tepërta dhe të panevojshme do të sjellin medoemos mossuksesin shkollor edhe sikur niveli i komunikimit nxënës-mësues të qëndrojë në shkallë të lartë.

Faktorët e mossuksesit nuk mund t'i adresohen tërësisht vetëm fëmijës që nuk lexon, familjes apo shkollës, apo mjedisit shoqëror. Ata ndikojnë në mossukses në mënyrë komplekse, por faktori themelor në këtë mes mbetet familja dhe puna për zgjimin e vullnetit për punë tek nxënësi.



Parime jetike nga Pejgamberi (a.s.)

Halid bin Velidi (r.a.), transmeton një hadith:

Një ditë erdhi një burrë tek Pejgamberi (a.s.) dhe i tha:

- O Resulullah! Do t'ju lutesha të më tregoni për disa gjëra që mund të më mjaftojnë si në këtë botë, ashtu edhe në tjetrën.

I Dërguari i Allahut (a.s.), i tha:

- Urdhëro, çfarë dëshiron?

Dhe pastaj, vijoi ky dialog:

- Dua që të bëhem më i dituri në botë.

- *Ki frikë nga Allahu, atëherë do të bëhesh më i dituri në botë.*

- Dua të bëhem më i pasuri në botë.

- *Ji i vetëmjaftueshëm, atëherë bëhesh më i pasuri në botë.*

- Dua të bëhem më i miri në mesin e njerëzve.

- *Ai që është më i dobishëm për njerëzit është më i miri në mesin e njerëzve.*

- Dua të bëhem më i drejti në mesin e njerëzve.

- *Atëherë, atë çfarë dëshiron për vete, dëshiroje edhe për të tjerët.*

- Dua të bëhem më i veçanti në mesin e njerëzve.

- *Kujtoje shumë Allahun (bëji dhikër), atëherë bëhesh më i veçanti në mesin e njerëzve.*

- Dua që të jem nga bamirësit.

- *Atëherë zbukuroje edukatën tënde, që të përsoset imani yt.*

- Dua të bëhem nga njerëzit që janë të bindur.

- *Kryeji gjërat që Allahu ka obliguar për njerëzit, atëherë bëhesh i bindur.*

- Dua të bëhem më i fuqishmi në mesin e njerëzve.

- *Mbështetu tek Allahu dhe bëji tevekkul Atij; bëhesh më i fuqishmi në mesin e njerëzve.*

- Dua që të më pranohet duaaja.

- *Largohu nga harami.*

- Dua që Allahu të mos më bëjë rezil në mesin e njerëzve.

- Nëse nuk dëshiron që të bëhesh rezil në mesin e njerëzve, atëherë ruaje gjuhën dhe organin gjenital. Dhe sipas një tjetër transmetimi; rregulloje nderin dhe veset e këqija. (Kurtubiu)

* * *

Në një hadith është thënë:

"Allahu i Madhëruar në Ditën e Kiametit mbledh të gjitha krijesat dhe dikush thërret kështu:

- *Ku janë ata që bënë bamirësi pa shpërblime?*

Nga mesi i njerëzve çohet një grup njerëzish dhe me shpejtësi i drejtohen Xhenetit. Ndërkohë engjëjt i zënë ata dhe i thonë:

- *Kush jeni ju që po shpejtoni për të hyrë në Xhenet?*

- *Ne jemi ata që kemi bërë bamirësi pa u kërkuar shpërblim njerëzve. – i thonë ata.*

- *Cilat janë veprat që keni bërë pa shpërblime ju? – pyesin engjëjt.*

- *Ne, kur na u bë padrejtësi, duruam. I falëm ata që na bënë keq. – i thanë ata.*

- *Hyni në Xhenet, atëherë! Lum për ata që bëjnë vepra të tilla! – thanë engjëjt.*

Pastaj një dikush tjetër thirri:

- *Ku janë njerëzit e durueshëm?*

Sërish nga mesi i njerëzve u ngrit në këmbë një grup njerëzish dhe me shpejtësi iu drejtuan Xhenetit. Engjëjt sërish i zënë ata dhe i pyesin:

- *Kush jeni ju, që po hyni me kaq shpejtësi në Xhenet?*

- *Ne jemi të durueshmit. – i thanë ata.*

- *Kundrejt kujt keni duruar ju? – i pyetën engjëjt.*

- *Ne duruam lidhur me bindjen ndaj Allahut. Rezistuam që të mos kundërshtonim Allahun e Madhëruar. – thanë ata.*

Atëherë, atyre u thuhet:

- *Hyni në Xhenet!*

PARA SE BOTËS T'I JAPIM NDONJË GJË...



Doç. dr. Harun Emysh

Kushti parësor për t'ua dhënë edhe të tjerëve një vlerë është të pasurit e saj. Nëse në ditët e sotme hedhim një vështrim të përgjithshëm, çfarë kanë myslimanët e botës që njerëzit ta kenë zili dhe që të presin t'ua japin edhe atyre?

Në ditët e sotme, për fat të keq, shtetet islame janë vendet në të cilat më së shumti vihet re injoranca, fanatizmi, imitimi, medhhebizmi, despotizmi, barbaria, korrupsioni, mjerimi dhe disfatizmi. Cili jomysliman, i cili e shikon këtë gjendje të myslimanëve, dëshiron të bëhet mysliman? Ata që bëhen myslimanë absolutisht janë fatlumët që e njohin Islamin dhe vlerat e tij pa e njohur gjendjen e myslimanëve. Sepse sot, shumica dërmuese e myslimanëve nuk e përfaqësojnë në një mënyrë të denjë fenë e tyre. Rruga për t'ua dhënë Islamit njerëzve të tjerë është përfaqësimi i denjë i tij.

Islami nuk përbëhet vetëm nga kryerja e riteve si namazi, agjërimi dhe haxhi. Këto formalisht mund t'i mësojmë dhe t'i praktikojmë. Sigurisht se janë të rëndësishme edhe format e dukshme të këtyre që tregohen në shariat, por kryerja e këtyre nuk mjafton. Ndërkohë që ne i kryejmë këto, edhe ato duhet të influencojnë te ne, domethënë, duhet të formojnë ndryshime pozitive te ne. Në të vërtetë, këto për këtë punë janë, domethënë, janë urdhëruar që ne të bëhemi njerëz të mirë e të denjë. Përndryshe, Zoti na faltë, Allahu Teala nuk ka nevojë për këto.

Për shkak se nuk është e mjaftueshme që adhuret të kryhen vetëm formalisht, disa dijetarë kanë

kundërshtuar që në kohë shumë të hershme shtjellimin e urdhrave fetare vetëm në këndvështrimin e jurisprudencës islame duke i bërë kurbanë të formalitetit. Më i njohuri prej këtyre është autori i veprës me titull *Ihjaw ulumi'd-din*, Imam Gazaliu (v. 505). Kur Imam Gazaliu i klasifikon shkencat, shkencën e jurisprudencës e vendos ndërmjet shkencave të kësaj bote, sepse jurisprudenca cakton përshtatshmërinë në pamje të jashtme të një ibadeti apo vepra ndaj rregullave fetare. Ndërsa pranimin te Allahu të atij ibadeti nuk mund ta dijë. Kjo është një specifikë që mund ta dijë vetëm Allahu i Madhëruar.

Domethënë se qëllimi kryesor i ibadeteve / adhurimeve që bëjmë është që të bëhemi njerëz të pranueshëm, pra, të bëhemi besimtarë të devotshëm dhe të moralshëm siç dëshiron Allahu Teala dhe i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam. Feja kërkon që ne të bëhemi njerëz të moralshëm. Por ja që të qenët fetar, domethënë, kryerja formale e ibadeteve, detyrimisht nuk e bën njeriun të moralshëm. Me një thënie tjetër, kryerja e adhurimeve detyrimisht kërkon që të jemi të moralshëm, por nuk mund të thuhet se çdo njeri që bën ibadet është i moralshëm. Njeriu mund të jetë i privuar nga morali, edhe pse e fal namazin, e agjëron ramazanin dhe e kryen haxhin.

Ne si myslimanë normalisht e shohim si të rëndësishme dhënien e edukimit fetar fëmijëve tanë, por moralin shpesh herë e hedhim në plan të dytë. Tani po më duket sikur po shikoni një kontradik-

të ndërmjet këtyre dy fjalive. Dhe me vete po thoni: Feja dhe morali nuk janë të ndarë. Në të vërtetë, feja jonë urdhëron moralin e lartë. I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, është dërguar për të përsosur moralin e lartë. Andaj, kur fëmijëve tanë u japim edukimin fetar, synojmë t'i bëjmë njerëz që e duan popullin dhe atdheun, që u binden prindërve, që i respektojnë të drejtat e të tjerëve, që sillen me qytetari ndaj njerëzve dhe që kanë shpirt human duke u dhënë dije për Allahun, Pejgamberin dhe Librin e Allahut. Domethënë, shkaku që ne u japim atyre edukim fetar është që t'ua mundësojmë për t'u bërë njerëz të moralshëm.

Po, të nderuar lexues, të gjitha kundërshtimet që i parashtruat duken me vend, por ja që, kur diçka nuk e ka emrin, shpesh herë nuk gjendet edhe vetë. A ka ndonjë krijesë në botën e jashtme që nuk i dihet emri apo që nuk është emërtuar? Sigurisht që ka, por vetëm se ajo krijesë pret që të njihet dhe të zbulohet nga njeriu. Ndërsa, nëse njihet nga njeriu, asaj absolutisht i është dhënë një emër, sepse gjëja që e quajmë krijesë, përbëhet nga gjërat që njerëzit i njohin dhe i kanë emërtuar. Krijesat që nuk i njohim dhe që nuk ua kemi vendosur emrin janë gjëra të paditura që akoma nuk kemi njohuri për to. Kur këto gjëra të panjohura t'i njohim ndonjë ditë, do t'ua vendosim edhe emrat. Faktikisht, një gjë është e njohur kur ka emër apo kur i vendoset emri. Sa më shumë gjëra të dijë një mendje, do të thotë se aq shumë gjëra njeh poseduesi i asaj mendjeje, sepse çdo dije në mendje korrespondon me një krijesë në botën e brendshme apo të jashtme. Ja, kjo është pika që e ndan dijetarin nga injoranti. Dijetar është ai njeri që e njeh botën e ekzistencës nga një perspektivë më e gjerë për shkak të shumë krijesave që korrespondojnë me të dhënat (emrat) që ai ka në mendjen e tij. Domethënë se emrat nuk janë të paqëllimshëm, sepse secili prej tyre tregon një gjë. Nëse ju e zhdokni atë emër, automatikisht e zhdokni edhe atë gjënë që shpreh ai. Nisur nga kjo, përderisa morali të mos theksohet në veçanti, edhe pse gjendet brenda fesë, edhe ai vetë ngelet në plan të dytë. Në këtë situatë, edukimi fetar pandehet se përbëhet nga disa shkenca në formë kallëpi dhe disa ibadete formale. Si rezul-

tat, Zoti na ruajtë, dalin fetarë pa moral. Ata falin namaz, mbajnë agjërim dhe e kryejnë haxhin, por lehtësisht mund të mashtrojnë, mund të shpifin, mund të bëjnë dredhi e shtirje, mund t'i ndihmojnë padrejtësisht ata që ndodhen në medhhebin dhe mentalitetin e tyre, madje, mund të harrojnë se të gjithë myslimanët janë vëllezër, Zoti na ruajtë, duke i konsideruar ata në humbje dhe ta shohin medhhebin e tyre si Firkatu'n-Naxhije / grupi i shpëtuar e të sillen si të atillë.

Të gjithë e shohin qartazi se, para se t'i japim diçka botës, duhet t'i kemi vetë disa gjëra. Meqë kemi dalë në pah me identitetin e myslimanit, është e qartë se së pari, duhet të kemi moral. Madje, siç ka thënë edhe i ndjeri Sejjid Kutubi, meqë nuk jemi në gjendje të garojmë me botën në çështjet e shkencës, artit, teknologjisë, armatimit etj., vlera e vetme që ne sot mund t'ia japim botës është morali i lartë dhe sjelljet shembullore.

Po ta këshillosh dikë te ne në çështjen e edukatës, jo për sa i përket marrëdhënies mësues-nxënës apo prindër-fëmijë, për shembull, po t'i dhurosh një libër edukate dikujt, në kulturën tonë konsiderohet si turp dhe konceptohet si mosrespekt, sepse kjo është sikur t'i thuhet bashkëbiseduesit: "Ti ke nevojë të mësosh rregullat e edukatës." Fakti që këtë shkrim ia kam kushtuar çështjes së moralit, e kuptoj se mund të lërë një përshtypje të atillë, por edhe të mashtruarit e vetes me gjëra boshe duke bërë sikur nuk i shohim të vërtetat, jo që nuk i zgjidh problemet, por i thellon edhe më shumë. Nëse ju thoni së myslimanët nuk kanë dobisë në moral, atëherë nuk kam asnjë fjalë për t'ju thënë. Vetëm se realiteti na tregon qartë se aspak nuk është ashtu.

Vetë personalisht, veçanërisht pas shtatëmbëdhjetë dhjetorit, shumë herë i kam bërë vetes këtë pyetje: "Sa njeri i moralshëm jam unë?" Ndoshta jam shumë pesimist, nuk e di, por sipas meje, myslimanët që gjenden në fushën e politikës dhe atë të medias, në organizata shoqërore, në lëvizje civile e xhemate dhe në çfarëdo fushe tjetër, duhet t'ia bëjnë vetes këtë pyetje dhe të bëjnë një llogari serioze të neftsit të tyre. A nuk është kështu edhe sipas jush?..

*Nëse
në ditët e sotme
hedhim një vështrim
të përgjithshëm,
çfarë kanë myslimanët
e botës që njerëzit ta kenë
zili dhe që të presin
t'ua japin edhe
atyre?*



JETA E PROFETIT IBRAHIM

(alejhi selam)

Ibrahim Iljazi

Historia e Ibrahimit (a.s.), ceket në Kuranin fisnik në shtatëdhjetë e tre vende, gjë e cila është tregues i madhësisë së këtij Profeti dhe rëndësisë së historisë së tij. Ibrahim (a.s.), është nga pasardhësit e Sam-it, djalit të Nuhut (a.s.). Ibrahim (a.s.), lindi dhe u rrit në veri të Irakut, në qytetin e Babilonisë. Ky qytet ishte selia e civilizimit të asaj kohe dhe banorët e tij ishin idhujtarë. Zoti në Kuran thotë:

Dhe ai tha: “Ju, në vend të Allahut, keni zgjedhur idhujt, për shkak të dashurisë midis jush në këtë jetë.”¹

Po ashtu, kur ai i tha të atit dhe popullit të tij:

“Kur ai i tha të atit dhe popullit të tij: ‘Ç’janë këta idhuj, që ju po i adhuroni kaq shumë?’, ata thanë: ‘Baballarët tanë i adhuroni këta.’²

Ata vetë e pranonin se ishte një rit që e kishin trashëguar nga të parët e tyre. Me pyetjet e tij, Ibrahim (a.s.), synonte stimulimin e tyre për të menduar dhe logjikuar mbi adhurimin e idhujve të tyre. Njeriu e adhuron Zotin, me qëllim që kur të ketë nevojë ta lusë dhe Ai t’i përgjigjet. Ai e adhuron Zotin, me qëllim që ta udhëzojë në jetë dhe ta ndihmojë të jetojë konform natyrës dhe ligjeve të Zotit. Megjithatë, këta njerëz e kishin kyçur arsyen e tyre dhe nuk ishin racionalë në këtë çështje. Këtë çështje Kurani e përshkruan më këto ajete:

“Në të vërtetë, Ne e udhëzuam Ibrahimin në rrugë të drejtë qysh më parë dhe e njihnim atë (se ishte i aftë për këtë gjë).”³

Ibrahimi (a.s.), është njëri prej pesë peygamberëve që janë të cilësuar me nofken “**Ulul-Azmin**” që ka kuptimin peygamberët e vendosmërisë së lartë, prej të cilëve Allahu pati marrë premtimin e fortë, e të cilët janë: Nuhu, Ibrahim, Musai, Isai dhe Muhamedi (a.s.). Ky pra është Ibrahim (a.s.), të cilin Allahu e sprovoi me sprovë të mëdha, sprovë që tejkaluan mundësitë njerëzore. Prej mirësive të Allahut ndaj Ibrahimit (a.s.), është fakti se atë e kishte bërë prijës të njerëzimit, duke bërë që nga pasardhësit e tij të ndriçonte drita e peygamberisë dhe e librave të shpallur. Çdo peygamber pas Ibrahimit (a.s.), ishte prej bijve dhe nipave të tij, me çka edhe u plotësua premtimi i Allahut dhënë atij, se asnjë peygamber nuk do të dërgohej më pa qenë prej lozes së tij.⁴

Nëse vazhdojmë të hulumtojmë më tutje rreth nderimit, fisnikërimit dhe dhuntive të Allahut (xh. sh.), ndaj Ibrahimit (a.s.), vërtet do të mbesim të mahnitur e të habitur për epitete të tjera që ja jep Kurani i madhërisëm.

Ibrahimi (a.s.), dallohet në Kuran po ashtu edhe me titullin *Halilullah* (mik i Allahut). Dijetaret kanë thënë se fjala Halil do të thotë: i dashur, i afërt, dashamir, mik.⁵ Po ashtu, Ibrahim (a.s.), përshkruhet si shembull dhe model i të mirëve, adhurues i sinqertë dhe besimtar i drejtë:

“Vërtet, Ibrahim ka qenë shëmbëlltëyrë e të mirave, adhurues i Allahut, besimtar i drejtë dhe nuk ka qenë nga idhujtarët.”⁶

1. El-Ankebut: 25 (përkthimi i ajeteve Kuranore është marrë nga Kurani - në gjuhën shqipe, përktheu H.sherifi 1992.

2. Enbija, 52-53.

3. Enbija, 51.

4. Ahmet Behgjet “Të dërguarit e Allahut”, Boton Dituria islame, Prishtinë, 2009, faq. 120.

5. Po aty fq. 120.

6. Nahel, 120.

Një ditë Ibrahim (a.s.), e pa babain e tij duke gdhendur puta dhe e pyeti: “Çfarë është kjo o baba? Veshët i paska të mëdhenj, madje shumë më të mëdhenj se veshët tanë.” Azeri iu përgjigj: “Ky është ‘Merduhu’ Zoti i Zotave, o biri im! Këta dy veshë të mëdhenj simbolizojnë urtësinë dhe mençurin e tij të thellë.” Atëherë Ibrahim e pyeti babain e tij dhe i tha: “Kush e ka krijuar njeriun?” Ai i tha: “Unë të kam bërë ty, e mua babai im.” Ibrahim (a.s.), u përgjigj: “Kjo nuk është e vërtetë baba, sepse unë kam dëgjuar një plak të moshuar duke u ankuar dhe thoshte: ‘O zoti im, përse nuk më fal fëmijë?’” Atëherë babai i kishte thënë: “Ashtu është biri im. Zoti e ndihmon njeriun që ta bëjë njeriun, por ai nuk vë dorën e tij në të, por thotë **“BËHU!”** dhe bëhet. Njeriut nuk i mbetet tjetër pos të lutet dhe të përulet para krijuesit të të gjithë botëve. Atëherë Ibrahim (a.s.), i tha: “Nëse Zoti ndihmon në bërjen e njeriut, atëherë si mundet që njeriu të bëjë zotat? Ti po gdhend dhe laton zotat të shumtë dhe po u ndihmon atyre, atëherë pse zotat nuk të ndihmojnë ty për të bërë shumë fëmijë, që të bëhesh njeriu më i fuqishëm në botë?” Kështu dialogu mes tyre përfundoi me zgjatjen e dorës se babit, i cili e goditi fort në faqe Ibrahimin (a.s.).⁷

Nga kjo revoltë në shtëpinë e Azerit, babit të tij, Ibrahim (a.s.), vazhdoi të sfidojë politeizmin e fisit të vet. Ibrahim (a.s.), njihet edhe si prishësi i idhujve dhe themelues i monoteizmit dhe luftues i injorancës.

Ibrahim (a.s.), i shkatërroi të gjithë idhujt e tyre dhe la vetëm njërin pa prishur. Kur panë banorët se çfarë kishte ndodhur, thanë se këtë kishte mundësi ta bënte vetëm Ibrahim. Dhe çuan njerëz ta thërrisnin Ibrahimin. Ata e pyetën se kush e kishte bërë këtë. Ibrahim (a.s.), u përgjigj duke u thënë të pyesnin më të madhin se ndoshta ai e dinte kush e kishte bërë këtë gjë. Ata iu përgjigjën se ai nuk di të flasë. Ibrahim (a.s.), u përgjigj: “Si adhuron ju një idhull, kur ai nuk flet; mjerë për ju dhe për ata që ju adhuron!”

“Po përgjigjja e popullit të tij nuk ishte tjetër vetëm të thoshin: ‘Mbyteni atë ose digjeni! Mirëpo Allahu e shpëtoi atë prej zjarrit. Për një popull që beson, këtu vërtet ka fakte bindëse.’”⁸

Ata e sollën Ibrahimin (a.s.), para idhujve të tyre. Ndezën zjarrin në praninë e tyre, qëllimi i djegies ishte që ata të shohin dhe të kënaqen në vend hakmarrjeje, ceremonia e hakmarrjes ishte tejet masive. Ata grumbulluan drurë si dhe iu drejtuan zotave

të tyre. Para të pranishmëve, filluan ta ndezin zjarrin. Ibrahim (a.s.), nuk tentoi të ikte, por u fut në turmën e drurëve ku zjarri ishte gjithnjë e në rritje. Në një situatë të tillë siç ishte Ibrahim (a.s.), ishte e mundur që zjarri të shuhej nëpërmjet rrëkeve të shiut, nëse dëshironte Allahu (xh.sh.), por Ai (xh.sh.), nuk e dëshironte këtë duke u dhënë atyre një bindje se i dërguari i Zotit Ibrahim (a.s.), ishte në mision për t’i shpëtuar njerëzit nga injoranca dhe për t’i bindur se ekziston vetëm një Zot i plotfuqishëm në këtë botë.

Vullneti i Allahut pamundësoi dhe pengoi vetitë djegëse të zjarrit dhe për këtë Allahu (xh.sh.), në Kuranin fisnik, thotë:

“Po Ne i thamë : ‘O zjarr, bëhu i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin!’”⁹

Sidoqoftë, kjo mrekulli që ndodhi në sytë e tyre për t’u bindur se Ibrahim (a.s.), ishte i dërguar i Zotit, ata prapë se prapë nuk i dhanë fund përpjekjeve të jobsimtarëve për ta persekutuar dhe izoluar Ibrahimin (a.s.), i cili qëndroi i patundur në besimin e tij, i durueshëm në vuajtjet e tij, i dashur në sjelljen e tij deri në migrimin e tij për në tokat e Aramit dhe Kananit. Duke parë refuzimin e banorëve të tij, Ibrahim (a.s.), vendosi ta lërë qytetin e tij të lindjes, ndërkohë mbreti Nemrud për të cilin thuhet se kishte në sundimin e tij një pjesë të madhe të botës asokohe, kishte dëgjuar për një djalosh që e kishin hedhur në zjarr dhe nuk ishte djegur .

Ai dërgoi ushtarët që ta gjenin djaloshin në fjalë. Ata e gjetën Ibrahimin (a.s.) dhe e sollën para Nemrudit. Ai filloi ta pyeste Ibrahimin (a.s.), mbi besimin dhe Zotin e tij. Këtë ngjarje e përshkruan Kurani ku Zoti (xh.sh.), thotë:

“A nuk ke dëgjuar ti (Muhamed) për atë që bëri fjalë me Ibrahimin për Zotin e tij, sepse Allahu i kishte dhënë pushtet? Kur Ibrahim i tha: ‘Zoti im është Ai që jep jetë dhe shkakton vdekje’ – ai (Nemrudi) u përgjigj: ‘Edhe unë mund të jap jetë e të shkaktoj vdekje’ – për të vërtetuar se edhe ai jep dhe merr jetë, Nemrudi solli dy të burgosur, njërin e ekzekutoi në çast, kurse tjetrin e liroi – Ibrahim pastaj i tha: ‘Allahu e sjell Diellin nga lindja. Sille ti nga perëndimi!’ Atëherë, ai (mohuesi) mbeti me gojën hapur. Allahu nuk i udhëzon ata që janë keqberës.’”¹⁰

Pas kësaj bisede Nemrudi e la të lirë të largohej Ibrahimin (a.s.).

7. Ahmet Behgjet "Të dërguarit e Allahut", Boton Dituria islame, Prishtinë, 2009, fq. 124.

8. Enbija 67.

9. Enbija, 69.

10. Bekare, 258.



Sutbe të zgjedhura

Naim Drijaj

Gjërat me të cilat arrihet ëmbëlsia e besimit

Enesi (r.a.), transmeton se Profeti (a.s.), ka thënë: *“Ai që ka këto tri cilësi, ka gjetur ëmbëlsinë e besimit: Të dojë Allahun dhe të Dërguarin e Tij më shumë se çdo gjë tjetër. Ta dojë një person vetëm për hir të Allahut. Ta urrejë kthimin në mosbesim (kufr), ashtu siç urren të hidhet në zjarr”*.¹ Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *“E ka shijuar besimin ai që është i kënaqur me pranimin e Allahut si Zot, Islamit si fe dhe Muhamedit si të dërguar”*.²

Pejgamberi (a.s.), na ka lajmëruar, se besimi ka shije dhe zemra e shijon atë, ashtu siç e shijon goja ushqimin dhe pijen. Kush e arrin diçka të tillë, zemra i qetësohet dhe ai ka fituar kënaqësinë e Allahut.

Ëmbëlsia e besimit në Zot nuk krahasohet me asnjë ëmbëlsi tjetër, që ekziston mbi tokë. Kur njeriu e shijon ëmbëlsinë e besimit, do të thotë ashtu siç kanë thënë të parët tanë: *“Sikur ta dinin pasanikët se çfarë ëmbëlsie kemi ne në zemrat tona, do të luftonin për të na e marrë, qoftë edhe me shpatat e tyre”*. *“Shija e imanit nuk është si shijet e tjera, sepse shija e një ushqimi largohet pas ngrënies së ushqimit tjetër, kurse shija e imanit mbetet një kohë të gjatë, sepse njeriu kur bën një ibadet me zemër, përkushtim dhe përujle ndaj Allahut, vëren se ushqehet një kohë të gjatë me atë ibadet”*³

Profeti (a.s.), ka thënë: *“Rruga e parë për të shijuar ëmbëlsinë e besimit është: “Ta duash Allahun (xh.sh.), dhe Muhamedin (a.s.), më shumë se çdo gjë tjetër që ekziston në gjithësi”*.

Abdullah ibn Hudhafe, ishte një nga shokët e profetit Muhamed (a.s.). Ai u kap rob nga bizantinët, bashkë me disa shokë të tjerë. Komandanti bizantin, bëri disa tentativa që ta thyejë dhe ta nxjerrë nga besimi, por dështoi. Fillimisht, ai e lidhi në një pemë dhe i urdhëroi ushtarët të hidhnin shigjeta drejt tij, por pa e goditur. Abdullahu nuk lëvizte fare dhe nuk tregonte shenja frike dhe dëshpërimi. Komandanti mori dy nga shokët e Abdullahut dhe i hodhi të gjallë në një kazan me vaj të nxehtë. Ai i kërkoi të braktiste fenë Islame, në këmbim të faljes së jetës, por Abdullahu sërish refuzoi. Kur e afruan pranë kazanit me vaj të nxehtë, Abdullahut i rrodhën disa pika lot. Kjo e gëzoi komandantin bizantin, pasi mendoi se e kishte rrënuar qetësinë shpirtërore, e cila e kishte karakterizuar gjër atëherë. Duke qeshur me ironi, ai i tha: *“Përse qan? Apo je gati që tani ta braktisësh fenë tënde, në këmbim të jetës?”* Abdullahu iu përgjigj: *“Jo, unë qava pasi kam vetëm një shpirt të vetëm, të cilin do ta jap për hatër të Zotit. Do të doja që të kisha shpirtra aq sa kam qime në trup dhe të gjithë t’i jepja për hatër të Zotit.”*

Ibn Tejmije (Allahu e Mëshiroftë) ka thënë: *“Në dynja ekziston një xhenet, kush nuk e shijon atë, nuk e shijon xhenetin e ahiretit. Ai xhenet është njohja e Zotit dhe dashuria për Të.”*

Rruga e dytë për të shijuar ëmbëlsinë e besimit është: “Ta duash tjetrin vetëm për hir të Allahut”.

Vëllazëri e vërtetë është ajo që lidhet për hir të Allahut, larg interesave të dynjasë, qofshin ato poste apo gjëra materiale, sepse sado dhe sido që të jenë, ato mbeten të përkohshme. *“Allahu i ma-*

1. Buhariu dhe Muslimi.

2. Muslimi.

3. “Kitabu Teuhid” Ibn Ulthejmini.



dhëruar Ditën e Kiametit do të thotë: ‘Ku janë ata të cilët kanë dashur njëri tjetrin për hir të Madhërisë Sime? Sot do të jenë nën hijen Time, në këtë ditë kur nuk ka hije tjetër pos hijes Sime.’⁴ “Allahu thotë: ‘ata që duan njëri tjetrin për hir të Madhërisë Sime, ata do të jenë në piedestale të dritës dhe do t’ua kenë lakmi pejgamberët dhe shehidët.’”⁵

“Një njeri vendosi të vizitojë vëllain e tij në një qytet tjetër. Allahu ia caktoi një melek në rrugë. Kur iu afrua meleku e pyeti: Për ku je nisur? Kam një vëlla në këtë qytet dhe desha ta vizitoj, tha ai. Meleku e pyeti: “A mos të ka borxh ndonjë pasuri dhe shpreson ta marrësh atë?” Ai tha: “Jo, unë e dua atë vetëm për hir të Allahut.” Meleku tha: “Unë jam i dërguar i Allahut te ti për të të lajmëruar se Allahu të do ty siç do ti vëllain tënd për hir të Tij.”⁶

Tregohet se Ahmed Ibn Hanbeli⁷, një dijetar shumë i madh, shkoi nga Bagdati në një vend tjetër. Nata e zuri në xhami, por pasi u fal namazi i jacisë, pastruesi i saj, i cili nuk e njohte, i tha: “Dil se do të mbyll xhaminë dhe nuk lejohet askush të rrijë në xhami”. Imam Hanbeli doli në shi dhe nuk dinte ku të strehohej. Dikush e pa dhe i tha: “O njeri përse rri në mes të shiut”. Imam Hanbeli u përgjigj: “Vallahi nuk kam ku të rri sonte”. “Hajde rri tek unë” - ia ktheu tjetri. Ky person e mori Imam Hanbelin në shtëpinë e tij dhe ia ndërroi rrobat. Imam Hanbeli shikoi se ky njeri e përmendte shumë Zotin. U habit

nga kjo gjë dhe e pyeti: “O njeri, po e shoh se ti po e përmend shumë Zotin. Ç`është kjo punë”? Burri ia ktheu: “Vallahi nuk më ka dalë keq kjo punë. Me këtë përmendje që bëj, Allahu (xh.sh.), më ka dhënë një sekret. Për çdo dua` (lutje) që bëj më vjen përgjigja. Vetëm një dua nuk më është plotësuar dhe inshallah ma pranon Zoti para se të ndërroj jetë. E kam lutur Zotin të mos ma marrë shpirtin pa u takuar me dijetarin e madh Ahmed Ibn Hanbel dhe shpresoj, se Zoti do të ma pranojë këtë dua”. Atëherë Imam Ahmedi i tha: “Allahu (xh.sh.), ta ka pranuar lutjen, sepse unë jam Ahmed Ibn Hanbel”. Atëherë ky person filloi të qajë dhe ta përqafojë Imam Hanbelin. Imam Hanbeli u habit dhe pyeti: “Po ti kush je”? Ai tha: “Unë jam Is`hak Ibn Rahauej (një tjetër dijetar i madh).

Rruga e tretë për të shijuar ëmbëlsinë e besimit është: “Të urrejë njeriu kthimin në mosbesim, ashtu siç urren hedhjen në zjarr”.

Ta urresh kufrin e ta duash besimin, do të thotë të thuash gjithmonë: “O Zot! Ty të falenderoj që më udhëzove, se nëse nuk do të më udhëzoje, unë do të isha prej të humburve”.

Ta duash besimin, do të thotë të sakrifikosh për këtë gjë. Pse u hodh në zjarr Ibrahim (a.s.)?! Sepse ai e dinte se zjarri i dynjasë nuk krahasohet me zjarrin e Ahiretit dhe pranoi me kënaqësinë më të madhe, që të mbante besimin dhe të hidhej në zjarrin e kësaj dynjaje. Nuk iu lut askujt për ndihmë. Nuk kërkoi as ndihmën e Xhebrilit (a.s.), por tha: “Vetëm për Allahun (xh.sh.), kam nevojë”.

4. Muslimi.

5. Tirmidhiu.

6. Muslimi.

7. Është lindur ne vitin 164 hixhri (780) në Bagdat po ashtu ka ndër - ruar jetë ditën e xhuma në të njëjtin vend më 12 Rabiul evvel 241 (31 Korrik 855).

UJI, PRODUKTI MË I SHËNDETSHËM DHE I LIRË NË BOTË

Uji është një lëndë e rëndësishme e cila siguron shëndet të mirë. Uji është i pranishëm në më shumë se 65% në organizmin e të rriturit. Megjithatë, trupi i njeriut nuk mund ta mbajë ujin, pasi del jashtë rregullisht nëpërmjet urinës, frymëmarrjes dhe djersës.

Të gjitha proceset vitale të trupit të njeriut funksionojnë me ujë. Uji është në fakt lënda ushqyese më e rëndësishme për trupin pas oksigjenit. Ai është një lloj karburanti që kontribuon në mënyrë aktive për funksionimin e mirë të organeve.

Në praktikë, uji siguron volum të mjaftueshëm të gjakut dhe lëngjeve limfatike në trup. Kjo i lejon trurit të funksionojë mirë. Uji mban ngrohtësinë e trupit, hidraton lëkurën dhe siguron lubrifikimin e nyjeve dhe syve. Nga ana tjetër, uji ndihmon në tretje, por gjithashtu ndihmon trupin në eliminimin e mbeturinave.

Nevojat mesatare të konsumit të ujit për një të rritur janë rreth 2,5 litra ujë në ditë. Ushqimet e tjera sjellin 1 litër ujë dhe 1.5 litër konsumohet si pije. Megjithatë nevoja për ujë është e ndryshueshme. Nëse jeni të sëmurë apo praktikoni një aktivitet fizik duhet të pini më shumë ujë.

ÇAJ SHTOGU PËR LEHTËSIMIN E FTOHJES DHE GRIPIT

Shtogu është një nga pak bimët mjekuese që ndihmon jo vetëm në lehtësimin e simptomave të ftohjes dhe gripit, por që shkurton edhe kohëzgjatjen e tyre.

Studimet kanë treguar se simptomat e personave që vuajnë nga gripi ishin shkurtuar për katër ditë te pacientët të cilën kishin përdorur shtog.

Hulumtuesit besojnë se efekti i shtogut në trajtimin e simptomave të ftohjes dhe gripit i dedikohet

antioksiduesve të veçantë që përmban kjo bimë. Ato ulin inflamacionin dhe stimulojnë sistemin imun.

Shtogu mund të përdoret në formë të çajit të luleve ose shurupit të nxjerrë nga frutat e bimës. Ju mund ta përdorni atë tre deri në katër herë në ditë.

Kur është fjala te frutat e shtogut, gjithmonë duhet të keni kujdes të mblidhni ato pasi të jenë të pjekura mirë, pasi frutat e papjekur mund të jenë helmuese. Po ashtu, para përdorimit frutat duhet të gatohen ose zihen në bazë të udhëzimeve.



SHERBELA DHE LIMONI MBROJNË TRURIN



Shkencëtarët britanikë kanë analizuar efektin e ekstrakteve të ndryshme bimore të cilat shfrytëzohen në mjekësinë tradicionale dhe kanë vërejtur se ekstrakti i bimëve të sipërpërmendura ka dhënë rezultate shumë pozitive në disa studime të tyre.

Autorët thonë se janë të dyja bimët që kanë përmirësuar memorien, dhe derisa sherbela ka ndikuar edhe në vëmendjen dhe sjelljen, ekstrakti i limonit

ka ulur shqetësimin dhe ka përmirësuar kualitetin e jetës të moshuarit me Alzheimer.

Përdorimi i tyre të personat vullnetarë po ashtu ka dhënë efekte anësore minimale.

Alzheimeri është forma më e shpeshtë e demencës nga e cila vuajnë miliona njerëz. Kjo sëmundje karakterizohet me humbjen e të mbajturit mend, gjë që përkeqësohet në mënyrë progresive.



SHEQERI, MË I RREZIKSHËM SE KRIPA PËR HIPERTENSIONIN

Sheqeri i shtuar në ushqimet e përpunuara dhe në pijet me gaz përbën një rrezik më të madh për zemrën sesa kripa. Doktorët thonë se udhëzimet ushqimore duhet të përqendrohen më shumë në rrezikun nga sheqeri sesa nga kripa.

Një studim i ri paralajmëron se sheqeri ndikon më shumë në rritjen e tensionit të gjakut, si dhe nxit sëmundjet e zezës dhe goditjen në tru. Në luftën për të parandaluar sëmundjet e zezës, ekspertët paralajmërojnë rreziqet, sidomos atë të lidhura me fruktozën.

Sëmundjet e zezës janë shkaku i parë në botë për vdekjet e parakohshme. Tensioni i lartë i gjakut është faktori më i madh i rrezikut.

Këshillat e mjekëve për të ulur tensionin e lartë të gjakut janë përqendruar gjithnjë në uljen e sasisë së kripës. Por mjekët tashmë thonë se ulja e konsumit të kripës ndikon më pak sesa sheqeri në uljen e tensionit të gjakut. Disa tregues sugjerojnë se 3-6 g kripë në ditë janë mjaftueshëm për shëndetin, por në fakt, gjithçka më pak se 6 g është e dëmshme.

Shumica e kripës në ushqimin e njeriut vjen nga ushqimet e përpunuara, të cilat gjithashtu përbëjnë një burim për marrjen edhe të sheqerit.

“Sheqeri mund të jetë më i lidhur me tensionin e gjakut sesa sodiumi. Provat bindëse tregojnë se sheqeri dhe veçanërisht fruktoza monosakaride luan një rol të madh në zhvillimin e hipertensionit.

Për më tepër, studimet tregojnë se sheqeri në përgjithësi dhe fruktoza në veçanti mund të kontribuojnë në një rrezik më të madh për sëmundjet e zezës përmes mekanizmave të ndryshëm.

Kërkuesit e vënë gishtin sidomos tek ëmbëlsuesit që përdoret për ushqimet e përpunuara, veçanërisht tek lëngjet e frutave dhe pijet e gazuara.

Në studim thuhet: “Në gjithë botën ëmbëlsuesit i pijeve është i përfshirë në 180000 vdekje në vit”.



AURA E NJERIUT

Pranohet pothuaj nga të gjithë se çdo njeri ka një aura që, shumica e njerëzve, e perceptojnë si një masë drite që rrethon trupin tonë. Në esencë, është pikërisht ashtu, por kjo është ta shikosh shumë thjesht problemin sepse aura shtrihet shumë herë më tepër se ç'mund të mendojnë njerëzit dhe përbëhet nga shumë pjesë të ndryshme.

Në kuptimin më të gjerë, aura është çdo formë energjie që gjenerohet nga trupi dhe rrezatohet larg trupit. Sot, ka pajisje me të cilat mund të shohim përbërësit e auras duke na çuar drejt të kuptuarit të ndikimeve dhe përdorimeve që ka ajo. Siç do ta shihni, aura është shumë komplekse duke qënë se përbëhet nga një sërë vibrimesh elektrike dhe elektromagnetike dhe, ndoshta, edhe nga forma të tjera rrezatimesh që do të zbulohen.

Rrezatimi i auras është në fakt komunikim, ashtu si edhe valët e radios, duke mbartur informacion mbi veten tonë për në hapësirën që na rrethon. Shumë dukuri të tjera mund të lidhen ose varen nga aura, pavarësisht se në pamjen e parë nuk duket se është kështu.

SHQISAT NORMALE TË NJERIUT


Ne të gjithë kemi lindur me disa shqisa dhe pikërisht me ndihmën e tyre ne mundemi të perceptojmë botën që na rrethon. Shqisat tona janë të mjaftueshme për jetën tonë të përditshme aq sa na kanë bërë në gjendje që të mbijetojmë si specie në mënyrë shumë të suksesshme. Por rreth nesh ekzistojnë shumë më tepër gjëra se ç'mund të zbulojnë shqisat tona normale. Dy nga shqisat tona që mund të kapin ngjarje në largësi janë sytë dhe veshët. Veshët tanë kapin vibrimet në ajër kurse sytë zbulojnë vibrimet elektromagnetike që udhëtojnë në të ashtuquajturin eter. Valët e dritës që shohim ne janë valë të energjisë elektromagnetike me frekuenca të ndryshme vibrimi (ose gjatësi të ndryshme valësh), duke na dhënë ngjyrat e ndryshme. Drita thjesht e bardhë përmban vibrime të të gjitha frekuencave që mund të veçohen duke e kaluar këtë dritë nëpër një prizëm ose një pikë shiu, duke përfutur një spektër të ngjyrave ose një ylber. Ngjyrat e kuqe kanë frekuencë më të ulët se sa ngjyrat drejt vjollcës, ku frekuencat janë më të larta.

Sytë tanë mund të shohin frekuencat që ne i quajmë dritë e dukshme, por çfarë shohim ne është vetëm një pjesë e spektrit elektromagnetik. Për të parë të gjitha frekuencat e tjera, normalisht na duhen pajisje për t'i konvertuar frekuencat e padukshme në një formë që mund ta shohim ose ta dëgjojmë. Rrezatimin elektromagnetik e kemi rreth e qark nesh dhe një nga përdorimet më të zakonshme të tij janë transmetimet e sinjaleve të radios dhe të TV. Zërat dhe figura transmetohen në frekuenca shumë më të vogla se ç'mund të detektojmë ne me shqisat tona normale dhe na duhet një radio ose TV për t'i konvertuar zërat dhe figurat në një formë të detektueshme nga shqisat tona. Dihet që radio dhe TV përdorin frekuenca të ndryshme.

RREZATIMI I TRUPIT TË NJERIUT

Trupi ynë rrezaton një spektër të gjërë frekuencash elektromagnetike. Frekuencat më të dukshme janë ato të imazhit aktual të vet trupit, por ky imazh është vetëm reflektimi i dritës nga burime të tjera, si psh drita e diellit ose drita elektrike. Trupi i njeriut, në fakt, nuk rrezaton vetë frekuenca në spektrin e dukshëm dhe kjo bëhet e qartë po të mbyllim dritën elektrike natën. Për sytë tanë, trupi zhduket. Ne shohim vetëm errësirë.

Megjithatë, trupi rrezaton frekuenca të cilat ne, normalisht, nuk mund t'i shohim pa ndihmë. Disa prej frekuencave më të dobishme janë ato më poshtë ngjyrës së



kuqe, zakonisht të njohura si infra të kuqe. Frekuencat infra të kuqe mund të udhëtojnë shumë kilometra dhe sot disponohen pajisje që i kapin këto frekuenca. Pajisje të tilla përdoren nga ushtria dhe policia në helikopterë për të parë njerëzit poshtë gjatë natës. Pajisje me të njëjtin parim përdorin edhe brigadat e zjarrfikëseve për të detektuar njerëzit nën godinën e rrëzuar.

Nga kjo shohim se ky komponent i aurës sonë kalon lehtësisht mes për mes objekteve të ngurta dhe rrezatohen në një distancë të konsiderueshme. Ne rezatojmë energji edhe në shumë frekuenca dhe forma energjie të tjera që akoma nuk janë kuptuar plotësisht. Por është pothuaj e sigurt se këta komponentë të tjerë të aurës kanë disa prej këtyre karakteristikave.

Njohim, në thelb, të gjitha format elektrike dhe elektromagnetike të rrezatimit, por ama vetëm kohët e fundit janë duke përdorur njerëzit metoda moderne për të korreluar mendimet, ndjenjat dhe eksperiencat e njerëzve me aurat e tyre. Meqënëse rrezatimi zhvillohet nga proceset e trupit tonë dhe çdo individ është unik, del që aura e secilit person është e ndryshme. Por, ndryshe nga shenjat e gishtave, aura ndryshon me kohën dhe me gjendjen fizike dhe mendore të personit. Kjo teknikë krijon mundësinë e matjes së komponentëve dhe modeleve të ndryshme në aurën e një personi dhe bashkëlidhjen e tyre me gjendjen e personit. Ky shërbim ofrohet sot të paktën nga një organizatë.

ENERGJIA MAGNETIKE

Shumë njerëz pretendojnë se janë në gjendje të ndjejnë praninë ose të kenë aftësinë e perceptimit ekstrasensor (jashtndijimor). Natyra ekzakte e kësaj dukurie akoma nuk është e qartë. Një komunikim i tillë nuk është rrezatim elektromagnetik siç e njohim ne, përndryshe ne do të kishim dëgjuar brenda kokës sonë sinjalet e radios dhe të televizionit. Ka kohë që njihet fakti se qelizat e gjalla reagojnë ndaj fushave magnetike dhe ndaj rrezatimit. Shpejtësia e rritjes dhe karakteristikat e florës dhe faunës mund të influencohen nga rrezatimi bërthamor (që është një rrezatim elektromagnetik me frekuencë shumë të lartë). Dihet që qelizat e gjalla vetrreshtohen në një fushë magnetike. Zogjtë psh, kur udhëtojnë, përdorin fushën magnetike të Tokës për të përcaktuar drejtimin e tyre. Nga kjo del e qartë se krijesat e gjalla mund të reagojnë ndaj formave të stimulimit që më parë nuk mendohej se ishin të kapshme me shqisat tona normale. Nuk është larg mundësisë që disa njerëz kanë aftësinë e detektimit të disa komponentëve të caktuar të aurës së një personi tjetër.

EKSPERIMENTET

Shumë nga eksperimentet e kaluara mbi dukuritë psikike nuk janë kryer me rigozitet shkencor dhe, prandaj, rezultatet nuk para janë besuar. Një nga vështirësitë është veçimi i informacionit të dëshiruar nga sasia e pakufi e rrezatimit të padëshiruar që udhëton nëpër hapësirë. Mund ta imagjinoni vështirësinë kur kemi parasysh mijërat e burimeve të rrezatimit në Tokë që mund të ndikojnë mbi rezultatet, pa llogaritur pastaj sinjalet e gjeneruara nga proceset në hapësirë.

Meqënëse disa ngjarje psikike mund të përfshijnë forma energjie që ne akoma nuk i kuptojmë plotësisht, kjo e dyfishon vështirësinë e kryerjes së eksperimenteve objektive me këto dukuri. Për t'u besuar atyre, këto eksperimente psikike duhen kryer në një zonë plotësisht të filtruar nga të gjitha format e rrezatimit për të parandaluar rezultate të rreme që, fatkeqësisht, i bën këto eksperimente të kostueshme. Ndonëse, për momentin, dukuritë psikike qëndrojnë akoma në fazën e pranueshmërisë shkencore, kërkimet mbi aurën e njerëzve mund të çojnë në shpjegimin e perceptimit ekstrasensor dhe efekteve të tjera psikike që përfshijnë komunikimin.